

PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS



Autor e Botonjes:

C. A. CHEKREZI



WASHINGTON, D. C.

1951

All Rights Reserved



BK1
C42


ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ
ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ



026000338974



Apud. 225. 140. 856



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS



Autor e Botonjes:


C. A. CHEKREZI



WASHINGTON, D. C.

1951

All Rights Reserved



ΕΥΡΩΠΑΪΚΟΝ




Bl
C

Copyright by C. A. CHEKREZI, 1951

Printed in the United States of America





TRYEZE E LENDES

Parethenie	Faqe	1
KAPT. I 11 Vjet Krize Kombetare		3
KAPT. II Tre Plane Coptimi		15
KAPT. III Regjimi Zogist—Fasciste dhe Komuniste		19
KAPT. IV Shqiperia ne Syt e Te Medhenjve		28
KAPT. V Komiteti i Çlirimit Nacional ne Veprim		35
KAPT. VI “Pushteti” i Popullit ne Fuqi		43
KAPT. VII Trashegimet Historike te VATRES ..		51
KAPT. VIII Metamorfoza e SHQIPËRIS SE LIRE		67
KAPT. IX Bashkefjalimet me Delegatet e Tiranes		76
KAPT. X Rezoluta e Senatorit Pepper		85
KAPT. XI Vashdimi i Regjimit Komunist		92
KAPT. XII E Pritmja e Shqiperis		99



PARËTHËNIE

KUR PO DALIN ne drite keto radhe, janë mbushur plot gjashte vjet qe kur u-shtrengova te largohem nga **SHQIPËRIA** e **LIRË** dhe po-thua nga çdo perzjerje direkte ne çeshtjen shqiptare.

Me gjith ate, gjate kesaj kohe e kam mbajtur gishtin ne damarin e levizjes shqiptare qe nga zemra e kryeqytetit te Shteteve te Bashkuar—fshati ku jetonj esht vetem tri mila larg nga Shtepia e Bardhe; kam mbajtur letrekembim me nje rreth te ngushte miqsh; jam takuar dhe fjalosur me delegatet e qeveris se Tiranes prane Kombeve te Bashkuar; kam botuar disa artikuj mbi çeshtjen t'one ne gazetate amerikane; dhe ne dy raste kam botuar e perhapur dy qarkore, me date 15 Maj 1947, dhe 1 Qershor 1950.

Simbas detyres se gazetaris, ne radhet e para e te ciles kam sherbyer më se 30 vjet, artikuj inglisht dhe te dy qarkoret ua dergova per njoftim dhe komentim redaksive te **DIELLIT**—te cilin une e bera te perditeshem me 1915—dhe te **LIRIS** te cilin e rrita nga djepi qysh me 1941. Por asnjera nga keto dy gazeta nuk pati bujarin as te permende se mori ato artikuj ose qarkoret ne fjale. Dhe kejo ndofta vjen nga qe kefo dy fletore—qe thone se perfaqesojen mendimin e Shqiptareve t' Amerikes—nuk pranojen asnje botim qe munt te cenoje monopolin qe kane vendosur organizatat e tyre. Ku esht koha kur une pranonja per botim kritikate më t' ashpra dhe atakimet më t' egera kunder vetes s' ime ne shtyllat e **LIRIS!**

NDERKOHË, nje tog miq e dashamire me keshillonin qe te nxjerr nje gazete te trete ketu n' Amerike; dhe shume jane ata qe me kane shtytur te ngreh edhe



nje organizate te trete. Por eksperienca ime me ka bindur se ne kete qarkun e ketushem nuk munt te mbahet me teper se nje gazete ose nje organizate.

Nga ana tjeter, dhe si pergjigjie ne deshirat e ketyre atdhetareve, jane shtuar ne kohen e fundit edhe dy gazeta te tjera me qytetin New York si qendre botimi. Pervec ketyre, japin dhe marrin nje tog fle-tushka qe dalin pa rregull nga qendra dhe zyra te paqena, pervec nje numuri "buletinesh" qe na vijen kohe me kohe nga vende te larget si Australia, Argjentina dhe Kanadaja.

Botimi i kaq organeve me tendenca te kunderta esht nje simptome e padyshimte e lengates se rende nga e cila vuan gjith ceshtja shqiptare.

Per gjith keto aresye, arrijta ne perfundimin se ardhi tashma koha qe te çonj edhe nje here zerin t' im ne mbrojtje t' Atdheut te perbashket me botimin e keti libri. Shpresonj dhe lutem tek i madhi Zot qe ky botim t' i dale ne krye qellimit per te cilin po del ne drite: te tregojte gjendjen e vertete te ceshtjes shqiptare.

Lyon Village, Virginia,
Gusht, 1951.

C. A. Chekrezi

ACKNOWLEDGMENT OF THANKS

To the publishers of "Roosevelt and the Russians" and "The Ciano Diaries," (Doubleday & Co.), "Dinner At The White House" (Harper & Brothers), "The Greek Dilemma" (J. B. Lippincott & Co.) who have graciously permitted me to quote liberally from their publications I acknowledge publicly my gratitude.



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

KAPTINE I

Nje-Mbe-Dhjetë Vjet Krize Kombetare

PO-THUA se dhjetë vjet më parë (Tetor 1941) u-ktheva n' Amerike nga një shesh përqendrimi (Concentration Camp) të Francës, pas 17 vjet shërbimi në Shqipëri dhe mërgimi n' Europë.

Në një shesh përqendrimi njeriu ka në dispozitën e tij tërë kohën e duhur për studime dhe mendime. Kejo ishte aq e vertetë për mua sa edhe për tërë Shqiptarë të tjerë që gjeta atje: Profesor Skender Luarasi; Oficer Mehmet Shehu—paga të caktuar n' atë kohë por njëkohshërisht Major-Gjeneral dhe Ministër i Punëve të Brendshme në guvernën e Enver Hoxhës; Kapiten (i Luftës së Spanjës) Hulusi Spahi, sot Major-Gjeneral në Shqipëri. Një i katërtë, Vangjel Dhimitriadhi, nuk kishte karakter të caktuar politik. Ata të tërë të parët e shkonin kohën me studime të thella të filozofisë Marxiste-Engeliane për të qenë gati që t' i aplikojnë në sovietizimin e Shqipërisë. Sa për mua, mendja ime vinte rrotull rreth çështjes se si mund të shpëtohet Shqipëria nga zbatimi i PLANIT TË TRETË të coptimit të saj. Sepse qëysh n' atë kohë ishte peshpëritur se Anglia ia kishte premtuar Greqisë krahinat e Korçës dhe Gjinokastres, si shpërblim të qindresës së popullit grek kundër Italisë fasciste, dhe si protestim kundër qëndrimit dredhacak të Zogut kundrejt Fuqive të Perëndimit në kohën para shpalljes së Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë kohës që isha i mbyllur në Vernet de l' Ariège—kështu quhej kampi i internimit—mendja ime ishte



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

e kethyer ndaj Amerikes: ndaj shokeve te mij midis Shqiptareve t' Amerikes, dhe ndaj qeveris amerikane me anen e te ciles Shqiptaret e Amerikes e shpetuan Shqiperin nga Plani i Dyte i Coptimit me nderhyrjen dramatike te Presidentit Woodrow Wilson ne Janar 1920.

Nga informatat qe kisha n' ate kohe, dukej sheshazi se VATRA—e vetema organizate politike ne Shtetet e Bashkuar—ishte larguar krejt nga programi i saj historik. Nen drejtimin dhe influencen e Faik Konitzes, ajo ishte bere nje vegle e sundimit te tiranis zogiste. Dhe, kur Zogu u-zbua prej legjionave kemi-she-zeza te Mussolini't, Federata aq e shkelqyer dhe e madhe ne kohet e shkuara—por njetash e zvogluar dhe e demoralizuar—kishte zbritur ne shkallen e turpshme te nje agjencie te Duçes s' Italis fasciste. Kejo ishte lodra mé tragjike q' u-lojt ne kurriz te Shqiptareve t' Amerikes. Te vetemit protestime kunder politikës anti-demokratike te “Beut te Konitzes” duallen nga shtyllat e “Imigrantit” te botuar asikohe ne Worcester, Mass., dhe, pas vitit 1930, nga shtyllat e “Republikes” se Peshkop Nolit.

NGA KËTO PIKA fillimi arrijta ne perfundimin, kur isha akoma ne Vernet de l' Ariège dhe ne shoqërim te perditeshem me Skender Luarasin, Mehmet Shehun dhe Hulusi Spahin: ja VATRA te kethehej ne programin e saj origjinal demokratik, ose perndryshe, duhej ngrehur doemos n' Amerike nje organizate e re e cila te mundehej te fitonte simpthin dhe perkrahjen e qeveris amerikane ne favor te Shqiperis, si ne kohen e Presidentit Woodrow Wilson. Per çudi,



NJE-MBE-DHJET VJET KRIZE KOMBETARE

ky plan i im nuk u-pelqye nga shoket e mij t' internimit, Luarasi, Shehu dhe Spahiu, per aresye se, simbas mendimit te tyre, Presidenti Roosevelt nuk ishte me i mire se Mussolini ose Hitleri!

“Dhe ju,” u thashe shokeve te mij n' internim, “besoni me te vertete se Stalini qe mbahet ne fuqi me ane masakrash munt te barabitet me Rooseveltin q' ardhi ne fuqi me votat e lira te popullit amerikan?”

Me sy te zgurdulluar, Mehmet Shehu u-turr te me godite me grusht, tue bertitur marrezisht: “Mos e zer ne goje ne nje kohe Rooseveltin t' ent me Stalinin t' one te math!”

Se si do te kishte perfunduar kejo zenke e papritur ne mes t' one, po te mos kishte hyre ne mes Skender Luarasi, as m' a merr mendja se q' do te kishte ngjare sikur une t' ua kisha raportuar autoriteteve anti-komuniste te kampit incidentin e sulmimit te Mehmet Shehut kunder meje.

Kur u-qetesuan pak nevrat, u thashe te tre shokeve t' internimit—n' esht se munt te quheshin “shoke”:

“Presidenti Roosevelt nuk munt te jete ‘i imi’ n' asnje kuptim te fjales: sepse ay esht kryetar i Republikes se Shteteve te Bashkuar, dhe une jam thjeshtazi qytetar i Shqiperis. Ajo qe me habit esht qe ju, prej race shqiptare, te vini nje diktator te huaj me nalt se Shqiperia.”

ME GJITH KETO, kur arrijta n' Amerike e cfaqa planin t' im te hartuar ne Vernet de l' Ariège ne menyre boterishte me 16 Nentor 1941 perpara nje shumice te madhe q' u-mbloth ne Peabody Playhouse, Boston, Mass. Pas pranimit te tij me nje ze—me per-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

jashtimin e nje grupi faikistesh te cilet u-ngriten te dalin jashte nga salla e mbledhjes, si nje shenje protes-timi, ne kohen e votimit, si edhe te zerit te nje te riu qe me pyeti se kur do te vendoset 'regjimi i popullit' ne Shqiperi!—vajta te takohem, simbas porosis se mbledhjes me Imzot Nolin per te kerkuar per-krahjen e tij. Peshkopi u-tregua fort i rezervuar per aresyen se "nuk merrej me politike." Ndaj fun-dit ay me keshilloi qe te merresha vesh me Faik Ko-nitzen rreth rollit qe munt te luante VATRA ne zba-timin e planit t' im. Me te ndyerin Faik u-takova ne Washington disa dit me von n' ish-legaten shqiptare. N' ate rast Faik Konitza me tha haptazi se VATRA nuk munt t' a ndryshonte politiken e saj, q' ishte krejt fillo-italiane, dhe q' ishte lene n' ate kohe, sa per forme, ne duart e nje tjetër te ndyeri qe nuk kishte asnje zo-tesi politike: Vasil Panit. Perveç asaj, Faik Konitza nuk me la asnje dyshim se ay ishte, natyrisht, krejt kunder ides se ngrehjes se nje organizate te re n' Amerike.

Kur u-ndava nga ish-Ministri i Zogut me shkoi ne mendje nje fjale e urte qe perdoret ne Shqiperin e Veriut: "ne don te besh nonje pune te dobishme, shko dhe pyet kundreshtarin t' ent dhe bej te kunderten e asaj qe te keshillon ay."

Ishte nen keto kondita q' u-ngreh bujerisht dhe bo-terisht ne Boston me 28 Dhjeor, 1941, organizata de-mokratike e SHQIPËRIS se LIRË (Free Albania). Program i saj i caktuar ishte: bashkepunim me Aliatet, dhe VEÇANËRISHT ME QEVERIN E SHTETEVE TË BASHKUAR.



NJE-MBE-DHJET VJET KRIZE KOMBETARE

NE NDJEKJE te kesaj politike, organizata e re hyri ne bashkepunimin me te ngushte me agjencit e ndryshme te qeveris amerikane.

Me anen e Zyres s' Informatave te Luftes (OWI, Office of War Information), SHQIPERIA e LIRE u-vu shpejtazi ne radhen e kombeve te shtypur nga Nazi-Fascistet per te perfituar nga lehtesit e dhena prej qeveris se Washington'it per t' u drejtuar popujve te tyre pertej Oqeanit fjalime dhe thirrje radiofonike.

Me ane te Zyres se Sherbimeve Strategjike (OSS, Office of Strategic Services), ne te SHQIPERIS se LIRE çelem rrugen per hyrjen fshehtazi ne Shqiperi me dyzina agjentesh Shqiptare dhe Shqiptaro-Amerikane q' u-vune ne kontakt me Forcat Luftetare te Çlirimit, te cilat DIELLI i quante n' ate hohe "rebele" kunder Italis, me nenkuptimin qe qeveria e ngrehur ne Shqiperi prej Italis fasciste ishte e vetema fuqi legale e Shtetit Shqiptar.

Dhe brenda ne Departmentin e Shtetit, SHQIPERIA e LIRE krioi nje qark te gjere miqsh dhe perkrahesish t' independences se Shqiperis te cilet u-bene shkak q' ay Department te botonte ne favor te saj disa deklarata me rendesi nderkombetare, si ajo e 10 Dhjetorit 1942 dhe e 28 Nentorit 1944. Dhe ne Maj 1945, nje-me-nje pas mbarimit te luftes n' Europe, Departmenti i Shtetit dergoi ne Shqiperi nje mision diplomatik nen kryesin e Ministrit Joseph E. Jacobs (me von ambasador i Amerikes ne Çekoslovakia dhe Koré). Per te vertet, dergimi i keti misioni ishte nje çap krejt i jashtezakonshem, dhe une e kam per lavdi q' u-bera shkak per nisjen e tij per ne Shqiperi. Siç do te shpiegohet ne faqet e mëtejme, misioni deshtoi ne menyre



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

te turpeshme dhe skandaloze. Ne gjith keto munt te shtohet—gje qe nuk esht botuar gjer tani—se SHQIPËRIA e LIRË ishte ne marreveshje e siper me zyrat kompetente per t' i shiguruar qeveris shqiptare nje ndihme prej \$40,000,000 per riorganizimin e Shtetit te porsa-rilindur shqiptar, perveç ndihmave te tjera qe populli i yne do te merrte dhe ishte tue marre nga organizata UNRRA, si edhe nga ana e Kryqit te Kuq Nderkombetar.

Ajo qe duhet theksuar posaçerisht esht qe gjith keto perfitime iu shiguruan Shqiperis pa asnje kondite nderhyrjeje a trazimi Anglo-Amerikan ne punet e brendeshme te saj, nga sa di une dhe nga sa dine zyrtaret e Departmentit te Shtetit me te cilet bashkepunonja ngushtesisht n' ate kohe, çfaredo qe munt te kete botuar ne kete mes Zyra e Propagandes se qeveris se Tiranes. Perkundrazi, perpjekjet t' ona te perbashketa kishin per qellim te perjashtonin çdo nderhyrje, inglize, greke ose jugoslave.

Po ashtu keto perfitime iu shiguruan Shqiperis kur VATRA e leftonte terbimisht SHQIPËRIN e LIRË. Ne fakt, per te penguar veprimet e organizates se re demokratike, VATRA rroku edhe nje here flamurin e monarkis, tue deklaruar me ane te DIELLIT se “nuk behet Shqiperi pa Zogun”.

FATKEQËSISHT, bashkepunimi i frytshem i organizates se re me qeverin amerikane u-pre si me gershere ne Maj 1945, kur une u-detyrova te largohem nga SHQIPËRIA e LIRË—per aresye qe do te shpiegohen mé von—cak ne kohen kur ay bashkepunim pri-tej dhe duhej te jepte pemet e tij mé te çmueshme ne



NJE-MBE-DHJET VJET KRIZE KOMBETARE

dobi te Shqiperis. Ky ishte nje fatalitet krejt i papritur, i pamenduar dhe i papandehur.

Q' ahere SHQIPERIA e LIRE—sa edhe VATRA—e humben krejt vleren e tyre, tue hequr dore nga rolli i tyre si organizata Shqiptaro-Amerikane qe duhej te sherbenin si ure afrimi midis Amerikes dhe Shqiperis. Perkundrazi, qe te dyja, ndonse leftonin terbimisht njera-tjetren, u-bene agjenci propagande te qeveris s' Enver Hoxhes. Kejo ngjau, per fatkeqesin me te madhe, pikerisht ne kohen kur qeveria e Tiranes, e keshilluar dhe e shtytur nga agjentet e Mareshalit Tito te Jugoslavise, mori vendimin fatal te hape luften me t' eger propagandistike kunder Amerikes. Gjate kesaj periudhe kritike as VATRA as SHQIPERIA e LIRE nuk ngriti asnje ze protestimi kunder veprimit te nxituar te guvernes s' Enver Hoxhes, as edhe kur kejo vendosi, krejt padrejtesisht, t' u heqe qytestesin amerikane Shqiptareve q' ishin bere qytetare amerikane me deshiren e tyre te lire prej nje kohe te gjate por qe kishin mbetur brenda kufireve te Shqiperis nga shkaku i luftes. Midis gith te tjerave, qendrimi i SHQIPERIS se LIRE dhe VATRES ne ket pike i afrohej, me te vertet, tradhesis kundrejt Amerikes.

Ne kete menyre u-kriua ketu n' Amerike edhe nje here nje suate si ajo qe gjeta une kur u-ktheva ne Shtetet e Bashkuar me 1941 per te ngrehur organizaten e SHQIPERIS se LIRE. Por me nje ndryshim me tragjik se ay i kohes se shkuar. Sepse, ne kohen kur, me anen e shpalljes se Doktrines se Presidentit Truman, Amerika hyri ne lufte te hapet kunder perhapjes se Komunismit, SHQIPERIA e LIRE dhe VATRA gjeten rastin te lozin rollin e breshkes qe



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

vajti te nallbani per t' i kerkuar qe t' a mbathe edhe ate me potkonj, ashtu si ajo kishte pare qe po u behej kuajve. Si perfundim, Shqiptaret e Amerikes, pergjitherisht, arrijtin ne shkallen sa te duken ne syt e autoriteteve amerikane si shoke dhe bashkepunetore te terroristeve komuniste qe ndiqen kemba-kembes nga FBI (Federal Bureau of Investigation—Zyra Federale e Hetimeve).

Sikur ky qendrim i VATRES dhe SHQIPERIS se LIRE t' i sillte nonje dobi ceshtjes shqiptare, ndofta askush nuk do te kishte nonje kundreshtim. Por nga gjith shenjat duket sheshazi se keto dy organizata qe pandehet se perfaqesojen mendimin e pergjitheshem te Shqiptareve t' Amerikes nuk i kane dhene asnje rendesi faktit se Amerika, brenda kufireve e te ciles jetojen zyrtaret dhe anetaret e tyre qe jane 90% qytetare te keti vendi, esht njera nga te dy Fuqit e Medha qe rregullojen fatin e kombeve te vegjel, per mire ose per keq. Po ashtu, zyrtaret e SHQIPERIS se LIRE dhe VATRES nuk duket t' i kene vene nonje rendesi pyetjes se cdo t' i ngjase Shqiperis kur Amerika dhe Aliatet e saj te dalin te fituar ne te Treten Luftë Botnore ose si do te mundim te shpetojem Toskerin ne rast qe konflikti i sotem Amerikano-Sovietik mbaron ne nje marreveshje miqesore midis Shteteve te Bashkuar dhe Ruis Sovietike. Sikur t' a leme menjane rastin fatal te luftes, a thua se Rusia—per te cilen Shqiperia esht nje mije mila larg nga kufiri i saj me i aferme dhe pa asnje lidhje tokesore me 'te—do te vere si kondite te marreveshjes miqesore qe Shqiperia te mbetet nen "pushtetin" e Enver Hoxhes dhe me Korçen e Gjinokastren brenda kufireve te saj?



NJE-MBE-DHJET VJET KRIZE KOMBETARE

Kejo esht pyetja kryesore, jetike dhe e pikellueshme qe duhet te kete parasysh çdo minute te dites çdo Shqiptar qe kujdeset per te pritmen e vendit te lindjes se tij. Kete pyetje ua vura perpara edhe delegateve te qeveris se Tiranes prane Kombeve te Bashkuar. Siç do te duket më von, pergjigjiet e tyre nuk ishin aspak shiguronjese.

TUE PERFITUAR nga ky degjenerim dhe demoralizim i Shqiptareve t' Amerikes qe tundnin boten nje here e njekohe, kane ardhur ketu ne Shtetet e Bashkuar nje tog agjente dhe perfaqesonjes Komitetesh dhe shoqerirash e t' ikurve dhe te zbruarve nga Shqiperia per te zene vendin dhe per te lojtur rollin prane qeveris amerikane qe njehere e njekohe e luante VATRA dhe më von SHQIPERIA e LIRE. Midis te rishardhurve esht edhe nje peshkop i ri më iden qe nje dite te zere vendin e peshkopit te plakur. Dhe vizitori i fundit nuk esht tjetër veçse vete Zogu per te marre komanden, shigurisht, te fuqive anti-komuniste nen hijen dhe mbrojtjen e Amerikes. Ketu perfundoi politika mendje-madhe anti-amerikane e VATRES dhe SHQIPERIS se LIRE! . . .

Komitetet dhe shoqerit e t' ikurve jane tue botuar organet e tyre: gazeta, fletore dhe buletine, ne menyre qe ne kete periudhe te perçarjes më te pashembellte ne historin e Kombit Shqiptar, mendja e Shqiptareve te mergimit esht trazuar dhe prishur krejt. Ne keto botime duhet shtuar edhe zeri i zyres se propagandes se qeveris se Tiranes qe gjen jehonen e saj ne shtyllat e DIELLIT dhe te LIRIS.

Dhe ketu vjen pyetja q' esht ne maje te gjuhes se



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

çdo Shqiptari: ku qendron e verteta, dhe cili nga keta organe i afrohet se vertetes?

Asnonje prej tyre. Sepse sicili midis tyre mbron thezen e vete, nuk boton as nje gje qe nuk i jep dore, por, perkundrazi shtremberon çdo fakt dhe ngjarje per t' a pajtuar me pikepamjen e vete.

Nga kejo ngatrese e tmershme mendimesh dhe pikepamjesh nuk munt te dale asnje e mire—asnje e mire per çeshtjen e Shqiperis. Te vetemit qe munt te dalin te fituar jane armiqt e Kombit t' one dhe ata Shqiptare q' e kane bere zakon te peshkojen n' ujra te trubulla.

Ne nje gjendje te ketille, pra, duhet nje mendje fillosofi qe te kerkoje e te zbuloje fillin e se vertetes permes lemishdrave te perdredhura; dhe, me ane t' analizimit te tij gjakftohte, t' arrije ne perfundime te kethjellta.

Fort do te me pelqente t' isha fillosofi qe lypin rastet e sotme tragjike. Por nga natyra e puneve si jane sot, gjendem ne poziten e fillosofit pa gene fillosof.

Me gjith ate, ne masen e gjykimit qe me ka dhene Zoti, per hir te dashuris s' Atdheut dhe, paragjithash, me deshiren t' ime qe te gjenj nje rruge te mesme dhe te caktonj nje program te perbashket rreth te cilit te mblidhen gjith ata qe vene interesat e Kombit permbi çdo interes, ideologji, deshire a ambicje personale, po dal edhe nje here te çonj kushtrimin kunder tradhesis qe na rrethon nga te gjith anet dhe te propononj menyren e shpetimit te Shqiperis.

KËTO JANË aresyet qe me shtyjne te gatit dhe te ve ne shtyp kete liber, per t' analizuar ne faqet e tij



NJE-MBE-DHJET VJET KRIZE KOMBETARE

situaten e sotme te çeshtjes shqiptare, sidomos ne lidhje me Planin e TRETË te Coptimit qe ka kerrenuar dhe po kerrenon edhe sot teresin tokesore te Shqiperis.

Posaçerisht, kendonjesit do te gjejn ne faqet e keti libri pergjigjiet e duhura ne pyetjet me te pikellueshme qe kane mbetur ne heshtje gjer tani, si, per shembell:

Kush e keshilloi a e nxiti qeverin e Tiranes te mos njohe traktatet e vjetra midis Shqiperis dhe Amerikes, kur gjith qeverit e tjera te Ballkanit, komuniste ose jo, i kishin pranuar qe më pare?

Kush i mbolli minat ne kanalin e Korfuzit qe shkak-tuan mbytjen e dy luftanieve inglize per te cilat Shqiperia u-denua prej Gjykates Nderkombetare te Hagges te paguaje afro 900,000 lira inglize si demshperblim?

Kush kishte interes te shtyje qeverin e Tiranes qe te zboje misionin diplomatik amerikan ne menyre qe Shqiperia te mbetej krejt e izoluar nga Perendimi?

Ç' perçapje beri VATRA ose SHQIPERIA e LIRE per te nxjerre ne drite te verteten rreth akuzes qe iu be Prof. Harry T. Fultz (ish-Drejtor i Shkolles Teknikë te Tiranes) se gjoja ky organizoi nje komplot kunder qeveris s' Enver Hoxhes?

Si qendron e verteta rreth gjendjes se brendeshme te Shqiperis, dhe ç' te mira ose ç' te keqia i ka bere vendit t' one "Pushteti i Popullit"?

Ne ç' rrethana u-proponua dhe u-pranua rezolluta e Senatorit Claude Pepper me te cilen i falet Toskeria Greqis, dhe ç' perçapje beri VATRA ose SHQIPERIA e LIRE per te ndaluar votimin e saj?

Ç' plane dhe intriga fshihen prapa Komitetit "Shqi-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

peria e Lire" qe kryeson Hasan Dosti? Ç' lidhje ose marreveshje te fshehte ka me Zogun? A ka te beje ardhja e Zogut n' Amerike me kete marreveshje te fshehte?

Ç' kuptim te vertete ka ardhja n' Amerike e Peshkop Mark Lipes?

S' ka asnje dyshim se organet e Shqiptareve t' Amerikes, DIELLI dhe LIRIA, i kane ne maje te gjuhes ose te pendes pergjigjiet ne gjith keto pyetje. Po ashtu i dine keto pergjigjie dhe organet e t' ikurve dhe te mundurve nga forcat e Komitetit te Çlirimit Kombetar. Por, si duket, askujt prej ketyre nuk i jepet te kallzoje dhe te botoje te verteten. Esht lehte, sidomos, te kuptohet qendrimi i organeve e t' ikurve. Ajo qe s' munt te kuptohet dhe qe ua ka prishur mendjen Shqiptareve esht se per ç' arsye DIELLI e LIRIA, qe botohen ne nje vend ku shtypi esht më i lire se ne çdo vend tjeter te botes, vashdojen te mbajen heshtjen më te thelle kundrejt çeshtjeve q' i perkasin jetes se Shqipëris si Shtet dhe Komb.

Qe kur isha une ne krye te SHQIPËRIS se LIRË ishin bere shume perpjekje me nisjativen t' ime per te bashkuar te dy organizatat. Po ashtu, pas largimit t' im, jane bere perpjekje ne çdo Kuvend per t' i arrijtur ati qellimi, gjithnje pa asnje perfundim, me gjith qe te dy keto organizata kane mbajtur nje politike te njeshme e te perbashket si kundrejt qeveris amerikane ashtu edhe kundrejt qeveris se Tiranës. Ahere ç' i ka ndaluar qe te mos plotesojen bashkimin?

Per te vertet, bashkimi esht dukur prej kohe si i domosdoshem persa i perket SHQIPËRIS se LIRË mbasi kejo falimento i si organizate qe kurse hoqi do-



TRE PLANE COPTIMI

re nga programi i saj origjinal. Por esht fort e dyshimte nese nje bashkim i tille do t' i sjelle nonje dobi VATRES mbassi edhe kejo ka marre tatepjeten po per ate arsye: q' u-largua nga programi i saj historik per t' u-bere vegle dhe monopol i disa vetave te cilet mundohen t' a mbajen te gjalle per interesa te veta me ane thirrjesh histerike dhe me shpallje fushatash qe kane per qellim te vetem te ndjellin dollare n' arken e Federates.

KAPTINE II ΤΡΑΠΕΖΟΥ ΚΟΥΡΙΑΣ

Tre Plane Coptimi

GJATE jetes se saj shekullore, Shqiperia ka kaluar permes nje vargu periudhash kritike. Por krizat me te medha i ka kaluar, ne syt' t' one sidomos, ne keto dyzet vjetet e fundme te jetes se saj po-thua se gjysmerisht independente.

Tri kane qene keto kriza qe kane kercnuar existen- cen e saj: me 1912, 1919, 1939.

Te dy te parat u-kaperxyen me shume a pak sukses, po te marrim parasysh se nga kanosja e çdukjes se saj te krejte dolli prape-se-prapi nje fare soj Shteti, ndonse me krahina te medha e te begateshme te mbe- tura perjashta.

Keshtu, me 1912, dy ose tre muaj pas njohjes tri- umfale t' autonomis se Shqiperis me katre vilajete nga ana e Turqis, Aliatet Ballkanike (Bullgari, Greqi, Mal- i-Zi, Serbi) vendosen coptimin e saj te krejte. Te gjith e dine se qysh u-anullua ay Plan i Pare i Coptimit.



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

Por esht e rasteshme te permendet se, sado q' Austria ishte ajo qe mori nisjativen per te shpetuar gjysmen e Shqiperis nga thonjt e fqinjeve, ishte Anglia ajo qe, me anen e Ministrit te saj per Punet e Jashtme, Sir Edward Grey, gjeti dhe imponoi formullen e ngrehjes dhe njohjes se Shqiperis se Pare independente.

Por tre vjet më von (Prill 1915), po n' ate qytet ku ishte njohur nderkombetarisht independenca e Shqiperis, u-neneshkrua nje traktat i ri, i çfameshmi Traktat i Fshehte i Londres. Me anen e ati traktati coptohet per heren e dyte Shqiperia ne favor te Greqis, Italis, Malit-te-Zi dhe Serbis, me vendim te katre Fuqive te Medha (Angli, France, Itali dhe Rusi) qe kishin garantuar independencen dhe neutralitetin e Shtetit Shqiptar. Dhe me 20 Janar 1920, Konferenca e Paqes e mbledhur ne Paris mori vendimin e fundit per te vene ne veprim dispozitat e Traktatit te Fshehte te Londres.

Siç dihet, kete here shpetimi i Shqiperis ardhi nga nderhyrja e Presidentit Wilson te Shteteve te Bashkuar, i cili u kishte deklaruar lufte te pameshirte gjith traktateve dhe marreveshjeve te fshehta. Por, kur ardhi puna per te shpetuar Shqiperin nga Plani i Dyte i Coptimit, Woodrow Wilson'i nuk u-kenaq tue denoncuar Traktatin e Fshehte te Londres. Perkundrazi, ay mori persiper te mbroje Shqiperin dhe independencen e saj ne baze te Parimit te Kombeve.

Po ne kohen (Janar 1920) qe Presidenti Wilson merrte anen e Shqiperis ne te tri Notat Adriatike te fameshme, ne Lushnje ishte mbeshtjelle nje Kongres i perbere nga patriotet më te njohur t' asaj kohe. Ndonse nuk kishte asnje dijeni—per kete jam shiguruar



TRE PLANE COPTIMI

nga i ndyeri Qazim Koculi, nje nga pjesetaret me syhapet te Mbledhjes—mbi qendrimin dhe deklaratat e Presidentit Wilson, Kongresi i Lushnjes mori nje tog vendime qe pajtoheshin pike per pike me parimet e Presidentit te Shteteve te Bashkuar. Por, sa vlefte do t' u mbetej atyre vendimeve te Kongresit pa nderhyrjen dramatike te Woodrow Wilson'it, ajo esht nje çeshtje te ciles nuk i mbetet vend per bisedim ne kete vepre te shkurter. Fakti esht qe Shqiperia e kaloi me sukses edhe ate krize qe neve na dukej gadi e pakaperxyeshme ne Dhjetor 1919.

SHQIPTARET e kane per zakon—dhe ky esht nje faktor psikologjik—qe te mallkojen Fuqit e Medha per intrigat dhe pabesit e tyre, dhe te çthuren ne sharje kunder fqinjve te tyre te “panginjur” dhe “gjakpires”, sepse keta jane muduar te çdukin racen arbenore me planet e tyre “satanike”. Por Shqiptaret harrojen se çdo komb e ka brenda ne trupin e tij krimbin e lengimit dhe te vdirjes se vete. Prandaj, ndofta nuk u pelqen te shkojen ne mendje faktin se ata vete ose udheheqesit e tyre u japin shkak te huajve dhe fqinjve qe te perfitojen nga grindjet dhe mosmarreveshjet e nje kombi te perçare. Per shembell, sa ishin ata qe deshironin dhe ishin gati te leftonin per nje Shqiperi independente me 1912, dhe sa ishin qe kundersiztonin ate ide?

Po ashtu, gjate kohes qe polli krizen e 1920-es, Shqiptaret ndofta kane harruar se ishte nje udheheqes prej races se tyre, Esat Pashe Toptani, qe jo vetem shkaktoi shpartallimin dhe deshtimin e Shqipësisë se Pare, por ishte edhe ne favor t' aplikimit te Traktatit te Fsheh-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

te te Londres, me kondite q' ay te mbetej zot i Shqiperis se Mesme.

“Ah, po, ay ishte trathetor!” do te protestojen shume zera.

Por kush e beri trathetor ate bir babe dhe nene shqiptare?

E verteta esht qe nuk ka komb qe te mos kete nxjerrre trathetore ne nje kohe ose ne nje tjeter. Por, ner kombet e tjere trathetit mbulohen prej shumices se madhe besnike q' esht gjithmon gati te mbroje Shtetin dhe institutat e tij kombetare. Fatkeqesisht, duket sikur ne Shqiperi trathetoret jane te zotrit t' a bejen shumicen per vete ose se-paku te duket se e kane shumicen me vete ne menyre qe te provohet sikur shumica esht tue hapur varrin me duart e veta.

Ishte nen keto kondita qe mahisi gjate vashdimit te regjimit te Zogut dhe u-çpif kriza e trette me 1939. Ajo krize, qe vashdon edhe sot e kesaj dite, perfundoi ne formullimin e Planit te Trette te Coptimit. Per te dyten here brenda ne njezet-e-pese vjet ishte prape qeveria inglize ajo qe mori nisjativen e erret te krasitjes se trupit te Shqiperis me anen e zotimit q' i dha mbretit te Greqis se krahinat e Korçes dhe Gjinokastres do te njiheshin si pjesa te mbreteris helenike ne fund te Luftes se II Botnore qe thuhej se behej per liri e drejtesi.


Forma dhe fjalet eksakte te keti premtimi nuk dihen, mbassi e gjith marreveshja duhej mbajtur krejt e fshehte, nga frika e qertimit t' opinionit nderkombetar dhe veçanerisht t' opinionit t' Amerikes dhe te Presidentit Roosevelt. Por Grekve nuk iu durohej dhe keshtu ata i shpallen kerkimet e tyre qysh ne vitin



REGJIMI ZOGIST—FASCISTE DHE KOMUNISTE

1941, pikerisht kur Greqia ishte e okupuar prej Gjermaneve dhe Shqiperia prej Italianeve.

Çapat q' e prune punen gjer n' ate pike perbejen pjese te drames ose mé mire te tragjedis se madhe q' u-luajt ne kurriz te Shqiperis ne periudhen e fundme te regjimit zogist, siç do te shpjegohet ne kaptinen qe vijon.



KAPTINE III

Regjimi Zogist—Fasciste Dhe Komuniste

NE ÇDO tragjedi a drame perfytyrohen, zakonisht, tre aktore kryesore: nje "hero", nje "heroine" dhe nje "hor". I pari mundohet te shpetoje heroinen nga dredhit e fatit ose nga intrigat e poshtra te horit qe perpiqet te shtoje rrezikun e saj. Per shembell, ne dramen e njohur "Othello" te William Shakespeare'it, perkthyer ne shqipen prej F. S. Nolit, gjenerali i zi i Venetikut esht heroi, e bukura Desdemone heroine dhe i çfameshmi Iago lot rollin e horit.

Por ne tragjedin e gjalle te Shqiperis qe gjeti kulmin e saj ditën e se Premtes se Zeze, 7 Prill 1939, kerko sa te duash per te gjetur se cili esht hero dhe cili hor. Per nje çast u-duk sikur Zogu do te luante rollin e heroit, por, ndaj fundit edhe ay vrapoi te shpetoje koken e vete dhe arkat e arit qe mori me vete tue e lene heroinen ne meshiren e horave.

Per te kuptuar qartazi rollin qe luajti sicili, esht nevojë te shpiegohen rastet nen te cilet mori forme komploti i drejtuar kunder independences se Shqiperis.



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

Qe regjimi i Zogut do te mbaronte ne menyre violente ate e dinte i math i vogel; sepse nje regjim i bazuar ne force nuk munt te rrezohet veçse me ane te forces. Ne rastin e keti regjimi forca vinte jo aq nga brenda se sa nga jashte, d. m. th. nga Italia Fasciste te ciles i jepte dore te mbante Zogun ne fuqi me çdo miet qe kishte ne dispoziten e saj. Ne fakt, brenda ne dhjete vjetet e pare te regjimit zogist ishin bere katre levizje kryengritese. Per te perballur keto plasje te brendeshme, Zogu nuk çpiku dot nonje menyre tjeter veçse te futet thelle e më thelle nen mbrojtjen e Mussolinit, keshtu qe çdo levizje e brendeshme mbaronte me nje traktat te ri ose marreveshje te fshehte midis Tiranes dhe Romes ne nje shkalle te tille q' independence e Shqiperis arrijti te mbetet vetem si nje fjale, nje theori, nje hije, dhe jo nje realitet.

Keshtu, ne fushen e politikës se jashtme, regjimi i Zogut mori nje qendrim te tille qe nuk mundej veçse t' egersonte dhe armiqesonte Fuqit e Perendimit, te medha e te vogla. Per shembell, delegacioni shqiptar ne Lidhjen e Kombeve ishte i porositur qe te votonte radhazi ashtu siç votonte delegacioni i Duçes. dhe ne nje tog raste Italia mbeti ne pakice me voten e saj dhe me ate te delegacionit te Zogut. Edhe ne pikën kritike t' invadimit brutal t' Ethiopis prej forcave fasciste, delegacioni i Zogut hodhi voten çdo here ne favor t' Italis, fort çuditerisht, pa marre aspak parasysh se agresioni i Italis n' ate rast krijonte nje precedent te shigurt per shkeljen e arthme te Shqiperis nga ana e legjioneve kemishe-zeza, ashtu siç ngjau vetem katre vjet pas konfliktit rreth Ethiopis. Nje njeri si Zogu qe pandehet se esht i zgjuar duhet t' a kish kuptuar



REGJIMI ZOGIST—FASCISTE DHE KOMUNISTE

ate rrezik per veten e tij, nemos per Shqiperin. (Kur u-takova me 'te ne Paris ne Gusht 1939, e preka kete pike ne bisedim e siper, dhe nuk u-habita aspak kur Zogu me tha se u ishte drejtuar Fuqive te Perendimit per te kerkuar ndihmen e tyre kunder pregatitjeve ushteriake qe po bente Italia per ditën 7 Prill, por q' ato bene veshin e shurdher.)

NGA ANA TJETER, ne sheshin e politikës se brendeshme, vetem Fascistëve dhe simpathizonjesve t' Italis u degjohej zeri dhe u shkante fjala ne punet e Shtetit. Kushdo qe kuxonte te kritikoje Fascismin—qofte edhe vetem si teori—konsiderohej si armik i regjimit zogist dhe ne shume raste damkosej si "komunist", per t' i bere qefin Duçes, natyrisht, mbassi edhe Mussolini i ndiqte si Komuniste ata qe kundershonin regjimin e tij. Ne baze kallzimesh, shume here pa emer, Ministrat e Brendeshem te Zogut, sidomos i fameshmi ndjekes i çdo liberali dhe te riu, Musa Juka, urdheronin kapjen dhe burgosjen me dyzina djemsh te rinj dhe studentesh nen akuzen se ishin "Bolshevike". Ne kete menyre, kundreshtaret e regjimit pro-Fascist te Zogut arrijtin t' a kene si per lavdi te fshehte titullin K o m u n i s t.

Sikur njeriu te bazohej ne raportet e Ministris se Brendeshme do t' arrinte ne perfundimin se gadi gjith rinia e vendit adhuronte Leninin dhe Stalinin. Prova e kunderte dolli ne drite me rastin e levizjes se Fjerit, ne te cilen rollin kryesor u-thirra t' a luanj une. Ne perpjekjet e mia per te mbledhur tok dhe per t' organizuar gjith elementet kundreshtare te regjimit, hyra ne kontakt edhe me "Grupin Komunist" te Shqiperis.



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

Habitja ime dhe e shoqeve te mij ishte e madhe kur kryetaret e ati grupi na dhane listen e anetareve te tyre. Lista permbante eksakterisht 73 (shtate-dhjetë e tre) emra. Shumica e tyre ishin nenoficere (tetare, rreshtare, kaptere) dhe ay qe mbante graden me te nalte ishte vetem nentoger. Te tjeret ishin mesues te shkollave fillore, qe nuk dinin nga ç' ane zihej pushka. Por edhe ata 73 nuk ishin Komuniste te vertete, por idealiste te shkrehur qe pandehnin se çdo problem i Shqiperis do te zgjidhej automatikisht ne minuten qe te vihej ne veprim regjimi sovietik ne vendin t' one. Qe nuk ishin Komuniste te vertete provohet nga fakti qe kur ardhe ne fuqi Komunistet e vertete, te kryesuar prej Enver Hoxhes, kryetaret e ati grupi origjinal komunist u-vune ne pushke dhe ne litar, tue filluar nga themelonjesi i ati te pari "Grup Komunist" te Shqiperis, Llazar Fundo. (Mbjellesi i vertete i fares komuniste ne Shqiperi, Kostandin Boshnjaku, u-pushkatua ne Prill 1945). Dhe ne tere kete kohe kur Ministria e Brendeshme e Zogut ndiqte kemba-kembes si "Komuniste" rinin e Shqiperis, kryetari i pritme i regjimit komunist ne Shqiperi, Enver Hoxha, studionte n' Europe me burse te dhene nga regjimi zogist!

Ne kete pikepamje, pra, munt te thuhet se regjimi i Zogut ishte tue pregatitur sheshin per ardhjen ne fuqi te regjimit komunist, tue e shtyre rinin e vendit qe te kerkoje zgjedhjen e problemeve te Shqiperis ne vendosjen e Sovietismit anti-nacionalist.

POR, kurse ishte e ditur qe te rinjt qe damkoseshin si "Komuniste" nuk ishin ne gjendje te krionin nonje levizje kunder regjimit te Zogut, puna ishte krejt



REGJIMI ZOGIST—FASCISTE DHE KOMUNISTE

ndryshe persa i perkiste “paresis” se vendit ne te cilen permblidheshin bejleret, bajraktaret dhe arhondet. (Ne Korçe fjala “paresi” perdorej per te designuar familjet me me influence brenda komunitetit orthodhoks; ne Berat ajo fjale perdorej per te designuar familjen e perhapur te Vrionasve; ne Vlore me fjalen “paresi” designoheshin “agallaret” e pasur; ne Shqipërin e Veriut, “paresia” e vendit perbehej prej bajraktareve te fiseve te ndryshem.) Keto “paresi” te perbashketa kishin kohe q’ ishin penduar per perkrahjen q’ i kishin dhene Zogut kur u-kethye ne fuqi me 1924 me ndihmen e Jugoslavis dhe te Greqis per te rrezuar regjimin e gjashte-muajshem t’ Imzot Nolit. Vetem gjashte muaj pas emerimit te Zogut si “President i Republikes”, “te paret e vendit” kuptuan se ambicja e ati njeriu kalonte çdo kufi. Dhe ata vendosen qe t’ i vinin nje kufi para se te shkonte puna me tutje. Ne nje mbledhje te fshehte q’ u-mbajt ne Korçe ne Korrik 1925 me nisjativen e Mufid Bej Libohoves u-biseduan mietet dhe menytrat per te kufizuar fuqin e Zogut si President i Republikes. Por, per fat, qeveria e Tiranes mori dijeni te mbledhjes dhe te qellimeve te saj, dhe Zogu, tuë vepruar me shpejtesin e tij te zakonshme ne raste te tille, i flaku nga ofiqet qe mbanin gjith bejleret pjesetare te mbledhjes se Korçes. Q’ ahëre Bejleret muarren nje qendrim opozite te fshehte dhe te padeklaruar, per aresye qe munt te kuptohen lehte. Fakti esht se ne levizjen e Fjerit—qe u-organizua dhjetë vjet me von,—kishim ne radhet t’ ona me teper Bejlere se ushtare. Vrionasit e Beratit ishin ne vijen e pare. Dhe nje nga aresyet per te cilat Fjeri u-zgjoth si kryeqendre e levizjes ishte sepse ay qytet i vogel



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

ishte po-thua se nje çiflik i Vrionasve.

Pas deshtimit te levizjes se Fjerit—deshtim i cili u-shkaktua nga paaftesia e disa oficereve t' ane per te bere lidhjet e duhura me Bajraktaret e Veriut,—Paresia e vendit, dhe jo vetem Bejleret, arrijti ne perfundimin logjik qe, mbasi Zogu mbahej ne fuqi me anen e perkrahjes qe kishte nga Italia Fasciste, e vetema rruge per t' a hequr qafet ishte q' ata, si te paret e vendit, te benin nje marreveshje direkte me qeverin e Romes. Ndermietet per kete marreveshje ishin Shefqet Bej Verlaci i Elbasanit dhe Mustafa Merlika i Krujes.

MARREVESHJA u-plotesua ne Dhjetor 1938. Ne baze te saj, qeveria e Romes zotohej qe te pushonte se dheni nonje perkrahje Zogut, keshtu qe t' u jepej rast “te pareve te vendit” t' a rrezonin nga fuqia me mietet e tyre, dhe jo me anen e nonje nderhryrjeje ushteriake nga ana e qeveris italiane. Nga ana e tyre, “te paret e vendit” zotoheshin qe te ftonin ne fronin e Shqiperis nje kusheri te mbretit t' Italis si, per shembell, Duken D' Aosta. (“Mbret per mbret”, thoshin midis tyre, Duka d' Aosta do te bente nje figure mé te mire si mbret se sa “Maloku i Matit.”) Ne kete menyre, qeveria e Romes do te kishte nje shigurim te plote se Shqiperia do te qendronte besnike n' aliancen me Italin qe kishte lidhur Zogu me Duçen qysh ne Nentor 1926. Ne fakt, gjate periudhes 1926-1938 qeveria e Romes kishte arrijtur ne perfundimin se Zogu nuk ishte njeri qe munt t' i vihej bese; dhe ate mendim kishin gjith ata qe paten te bejin me Malokun e Matit.

Mirpo, kur ardhi koha qe te vihej ne veprim ajo



REGJIMI ZOGIST—FASCISTE DHE KOMUNISTE

marreveshje, Duçëja i pabese “ua hodhi te pareve” te vendit t’ one. Ne vend te ruajtjes se parimit t’ independences shqiptare nen nje mbret italian, Mussolini kishte patur gjithnje per qellim qe t’ a okuponte Shqiperin, tue perdorur si vegla “te paret e vendit”. Kejo provohet pertej çdo dyshimi nga shenimet e qarta te Kontit Ciano ne Ditaret e tij (The Ciano Diaries) q’ u-botuan inglisht me 1946 prej shoqeris botonjese Doubleday & Co. Konti Ciano, dhenter i Duçes dhe Minister i tij per Punet e Jashtme, nuk len asnje dyshim mbi kete pike kur shkruan se ne marreveshjet me Shqiptaret kundreshtare te Zogut qeveria e Duçes kishte nje qellim te vetem: te çduke independencen e Shqiperis ne kohen q’ i jepte shigurime te plota Shefqet Verlacit dhe Mustafa Krujes se do te respektonte independencen e saj.

Kete dredhi te poshter te Duçes e kuptuan, ndaj fundit, edhe ata qe kishin bere marreveshjen e fshehte me ‘te. Por e kuptuan teper von. Kur, pra, qeveria e Romes i dorezoi Zogut me 5 te Prillit ultimatumin me anen e te cilit kerkonte qe qeveria e Tiranes te pranoje trupa ushteriake italiane ne limanet e Vlores, Durrësit dhe Sarandes—midis konditave te tjera—Zogu ia parashtrroi Parlamentit kerkimet e qeveris se Romes. Me nje ze Parlamenti i hodhi poshte kerkimet e Italis. Midis atyre qe votuan “kunder” ishin dhe ata qe kishin pelqyer me pare marreveshjen me Duçen. Per-nje-here u-duk sikur Kombi Shqiptar ishte krejt i bashkuar ne qindresen e tij kunder Italis.

Por shih se ç’ shkruan Konti Ciano ne Ditaret e tij: gjate gjith kesaj kohe, Zogu po bente çemos per t’ ardhur ne marreveshje me qeverin e Romes. Simbas



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

shenimeve të Ciano's, Zogu ishte gati të pranonte çdo kerkim t' Italis, me kondite q' ay të mbante fronin. Mirpo, Mussolini kishte vendosur që të zaptonte Shqipërin, dhe Zogu nuk i hynte më në punë. Prandaj, Duçja refuzoi çdo marreveshje me Zogun. Perkundrazi, ay urdheroi që trupat e tij të mbledhura në Bari dhe Brindisi të zbresin në skelat e Shqipëris dhe 400 aeroplane të fluturojnë mbi Tiranën për të terrorizuar popullsin e saj. N' atë rast aq të veshtire Zogu bëri një gjest trimërie; i dha urdher ushtëris që t' u bjere Italianeve. Disa nga kundreshtarët e tij duan të thonë se Zogu e dha atë urdher për të fituar kohë për ikjen e tij në të ngrysur t' asaj dite aq tragjike për Shqipërin. Sido qofte e verteta, Italianeve u ishte mbushur mendja se Zogu nuk do t' ikte pa leftuar.

Ja se ç' shkruan Konti Ciano mbi këte pike:

31 Mars, 1939. Lajmet nga Tirana vertetojnë faktin që Zogu po bënte gjithë përgatitjet për kundreshtim. Kejo s' më pelqen aspak, mbasi mua më duket si punë e rrezikeshme që në të shkrehim pushken e parë në gjendjen e tashme të turbull dhe të ndezur t' Europës.

2 Prill, 1939. Plani i yne është të ndalojmë ikjen e Zogut për në Maqedoni, ku ay munt t' organizojë qindresën kundër fuqive t' ona.

8 Prill, 1939. Gjithë frika jonë semos Zogu qëndronte për luftë në malet e Shqipëris u-çduk kur mesuam se ay vrapoi të futet në Greqi.

KËSHTU mbaroi roli i Zogut në tragjedin më të madhe të Shqipëris në ditë t' ona. Është kohë tani që të kthehemi në qëndrimin e "të parëve të vendit" që rrane në kurthin e përgatitur prej Duçës, tue kujtuar



REGJIMI ZOGIST—FASCISTE DHE KOMUNISTE

se do te tregoheshin mé te zgjuar se Mussolini. Simbas shenimeve te bollshme te Kontit Ciano mbi kete pike, s' mbetet asnje dyshim qe pendimi dhe deshperimi i tyre ishte i singerte.

Tronditjen mé te madhe e ndjene kur degjuan nga goja e Ciano's se qeveria e Romes nuk kishte aspak ndermend te lejonte hipjen ne fronin e Shqiperis te nje princi italian; perkundrazi, Duçja kishte vendosur qe te çdukej krejt independenca e Shqiperis e cila pasketaj do te behej pjese e mbreteris italiane. Shefqet Bej Verlaci ishte nga te paret qe protestuan, por ata q' e kundreshtuan mé rreptesisht vendimin e Duçes ishin kreret Katolike te Shkodres.

Shif tani si e pershkruan Konti Ciano ceremonin e paraqitjes se kurores se Shqiperis mbretit t' Italis Viktor Emmanuel III.

“Ceremonia u-shvillua ne pallatin mbretnor (te Romes). Shqiptaret duken te deshperuar. Veçanerisht Verlaci duket mé i deshperuar se te tjeret dhe me-zi i nxjerr nga goja fjalet e paraqitjes se kurores. Shqiptaret prisnin qe mbreti ose Mussolini t' u jepte nonje zotim per respektimin e independences se vendit te tyre.” Pritja e tyre ishte e kotte.

Bejleret, Bajraktaret dhe Arhondet qe nje here ishin aq kryelarte u-bene njetash çirake te Duçes dhe te Jakomonit (ky i dyti u-emerua si zevendes ne Tirane i mbretit t' Italis). Dhe kur Italia vendosi t' i bjere Greqis per hesap te saj disa muaj mé von, Duçja e futi edhe Shqiperin ne lufte.

Ishte ky akt i fundit q' e beri qeverin inglize t' u zotohej Grekeve se Korça e Gjinokastra do te beheshin



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

te tyret ne fund te luftes. Dhe keshtu mori forme te perfundme Plani i Trete i Coptimit te Shqiperis.

Kendonjesit e paaneshem le te qendrojen tani e te mendohen thelle-thelle se kujt duhet t' i ngarkohet pergjigjesia me e madhe per serin e fatkeqesive q' u pershkruan ne kete kaptine.

Le te sqarojem tani edhe nje pike te fundit. Marreshjen e fshehte midis Duçes dhe Shefqet Verlacit per te permbysur Zogun e mesova ne Paris naten e 1 Janarit, 1939, kur ardhi ne kryeqytetin e Frances Mustafa Merlike Kruja per te bindur refugjatet shqiptare te "Bashkimit Kombetar" qe t' iknin nga Franca e te vinin n' Itali per te qene gati "te merrnin pjese ne permbysjen e Zogut."

Disa jave me von ardhi ne Paris Dr. Qemal Jusufati, Drejtor i Pergjitheshem i Kryqit te Kuq Shqiptar. Ia kallzova keti tere planin dhe iu luta qe te kethehej pa vonim ne Tirane per te lajmeruar Zogun mbi fatin q' i ishte pregatitur ne Rome, tue shtuar se shpetimi i vetem munt te vinte nga nje bashkim i pergjitheshem ne baze te nje amnistie te plote dhe te formimit te nje qeverie me te vertete kombetare. Gjer sot e kesaj dite nuk e di nese Dr. Qemali ia shpuri Zogut fjalet e mia. Fakti esht qe Zogu nuk beri asgje mbi kete pike.



KAPTINE IV

Shqiperia Ne Syt Dhe Gojen e "Te Medhenjvet"

SA RENDESI munt te kete Shqiperia ne ballancen e politikes nderkombetare?

Shkrimtari filloshqiptar Edgar Ansel Mowrer tregon



SHQIPERIA NE SYT E "TE MEDHENJVET"

nje anekdote mjaft interesante mbi kete pike. "Nje dite," shkruan ay ne librin e tij "Germany Puts the Clock Back", "gjate liqenit t' Ohris nje qiraxhi me dha nje mesim ne fushen e politikes. Shqiptaret, me tha, jane populli me i math ne bote sepse 'ne zaptuam tere dheun per Aleksandrin e Math'. Q' ahere jam munduar gjithenje te mos harronj se, ne syt e veta, çdo popull e quan veten te pashoqte".

Te keti mentaliteti duket se jane edhe megalomanet t' ane qe besojen se Shqiperia esht boshti i Ballkanit nemos i tere Europes. Dhe nga veprat dhe deklaratat e tyre, "shoket" e Tiranes lene te kuptohet se ata besojen qe Shqiperia mikroskopike esht e destinuar te luaje nje roll kryesor ne planet globale te Xha-Stalin'it. Por e verteta esht qe vendi i yne i vogel, me i vogli ne Ballkan, me i voceri n' Europe dhe me i paperfilleshmi ne bote, duhet te shekoje mire se ku shkel para se te hedhe njerem kembe perpara tjetres.

Kejo provohet nga fakti qe rall e tek Shqiperia zihet ne goje prej te Medhenjve te botes; dhe kur zihet ne goje prej tyre ndofta esht per me keq se sa per me mire. Prandaj esht pune interesante qe te gjurmohen fjalet dhe deklaratat e te Medhenjve mbi Shqiperin, sidomos ne kohen qe kejo ishte e shkelur nen thundrat e okupatoreve te huaj.

Nje nga zbulimet me te verejshem esht se te paren deklarate mbi rinjohjen e independences se Shqiperis se sakrifikuar me 7 Prill, 1939, e pat bere Iosif Stalini ne Qershor 1941. Kete informate na e jep ne forme zyrtare ish-Sekretar i Shtetit Edward R. Stettinius, libri i te cilit "Roosevelt and the Russians" (Roosevelti



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

dhe Ruset) u-botua me 1949, pak kohe pas vdekjes s' autorit.

I ndyeri Stettinius shkruan se në bashkefjalimin që pati në Moskë Ministri i Punëve të Jashtme t' Anglis, Anthony Eden, me Stalinin në Qershor 1941, d. m. th. pak më tepër se një muaj pas sulmimit të Rusisë Sovjetike nga ana e Hitler'it të qëndur, Gjeneralisimi Stalin i tha Ministrin britanik, midis shumë gjërave të tjera, se Shqipëria duhej të fitonte prapë independencën e saj. Stettinius nuk përmend se ç' përgjigjje dha Ministri britanik, as që bëri ndonjë koment nga ana e tij.

Pas asaj deklarate të qëkoqur të gjeneralisimit rus, deklarate që u-mbajtë krejt e fshehtë, se ndofta nuk i jepte dorë as qeverisë së Moskës as asaj së Londrës që të botohej në atë kohë, çështja e Shqipërisë u-zu në gojë në mënyrë të terthortë në një darkë që u-dha në Shtëpinë e Bardhë më 9 Janar 1942. Mysafiri i nderit në atë gosti ishte Kryeministri i Anglis Winston Churchill.

Se si ardhni në bisedim çështja shqiptare atë e përshkruan me shumë gusto shkrimtari i çkuar Amerikan-Jugosllav Louis Adamiç,—i cili ishte ftuar prej Zonjës Eleanor Roosevelt,—në librin e tij "Dinner At The White House" (Darkë në Shtëpinë e Bardhë).

—Në vashdim të muhabetit pas darkës, kur servirej shampanja, u-zune në gojë një tog personalitete, si ish-mbreti Karol i Rumanisë, ish-mbreti Pjetër i Jugosllavisë e të tjerë, një nga të ftuarit përmendi emrin e Zogut tue pyetur se ku gjendej ai njeri.

—“Zogu!” thirri Presidenti Roosevelt me shumë interes, dhe, tue iu drejtuar me gisht Kryeministrit Churchill tha:

—“Winston, e harruam Zogun!”



SHQIPERIA NE SYT E "TE MEDHENJVET"

—Kryeministri i Anglis i mblodhi buzet sikur desh te thonte: dhe si e harruam ç' u-be?

Ne te tjeret—shkruan Louis Adamiç—filluam te kuptojem se si qendronte puna dhe me-zi mbaheshim qe te mos qeshnim.

—“Shqiperia esht me anen t' one ne luften”, tha Presidenti dhe krojti kryet. “Mua me duket se gjendet ketu ne Washington nje Minister a perfaqesues i Shqiperis—duhet t' a thresim qe te nenshkuaje deklaraten e Kombeve te Bashkuar.”

—Ahere te gjithë ia thirre te qeshurit perveç Churchill'it dhe Zonjes Roosevelt. Disa prej nesh, dhe midis tyre edhe Presidenti, s' mbaheshin dot se qeshuri. Zonja Roosevelt e kishte buzen ne gaz, por dukej e çqetesuar. Fytyra e Kryeministrit t' Anglis—buze te puthitura, faqe te fryra, ishte e kuqur: edhe ay donte te qeshte, por e mbante veten.

—Tek po qeshnja, mejtohesha:

—Keta dy njerës kane teper shume gjera ne dore . . . Jane si dy Perandore! Shtetet e tyre munt te quhen se jane demokratike, por gjerat qe nuk dine popujt e Amerikes dhe t' Anglis munt te mbushin vellime te tere—dhe ndofta nuk kane per t' i mesuar kurre . . . Ajo pune e deklarates se Kombeve te Bashkuar esht fort per te qeshur, por edhe fort e tmershme . . . I thote njeri Perandor tjetrit rreth tryezes se bukes: ‘Pa sheko, paskemi harruar Zogun!’ Shaka e madhe! Ç' gje tjeter kane harruar? . . .—

(Per shkak te disa shenimeve te pahieshme qe permbahen n' ate liber rreth personit te Kryeministrit t' Anglis, Churchill'i e hoqi ne gjyq autorin Adamiç dhe e fitoi.)



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

KEJO ISHTE fryma qe mbreteronte ne Washington rreth nje faze te çeshtjes shqiptare, kur une u-paraqita ne Departmentin e Shtetit brenda ati muaji te Janarit per te perfaqesuar organizaten SHQIPËRIA e LIRË q' ishte formuar nje jave më pare.

Pas nje viti punimi te papushuar, nje tjeter kenge filloi te degjohej rreth Shqiperis ne Hall'et e Departmentit si edhe ne zyrat e tjera. Prova gjendet ne deklaraten e bujeshme qe leshoi Sekretari i Shtetit, Mr. Cordell Hull, me 10 Dhjetor 1942.

Siç dihet pergjithërisht, me ate deklarate qeveria amerikane i jepte popullit shqiptar shigurimin me solemn se te drejtat e tij per liri dhe independence njiheshin teresisht nga ana e Amerikes e cila, nga ana tjeter, nuk e kishte njohur n' asnje menyre aneksimin e Shqiperis prej Italis.

Tue i dhene rendesin e duhur kesaj deklarate te qeveris amerikane, qeverit e Anglis dhe Rusis Sovitike shpejtuan te bejen deklarata analoge ne favor t' independences se Shqiperis. Vetem se Ministri i Puneve te Jashtme t' Anglis, Mr. Anthony Eden, shtoi, ndaj fundit, nje paragraf q' u-interpretua si vertetim i qenies se Planit te Trete te Coptimit te Shqiperis. Teksti i paragrafit ne fjale ishte ky:

“Qeveria e Madhestis se Tij e veshtron çeshtjen e kufireve te Shtetit Shqiptar, ne mbarim te luftes, si nje problem qe ka per t' u-konsideruar ne Konferencen e Pages.”

Sa here q' u-pyeten me insistim prej delegateve te SHQIPËRIS se LIRË ne Washington dhe Londre, nese deklarata e z. Anthony Eden kishte kuptimin se çeshtja e Korçes dhe Gjinokastres mbetej e hapur per bise-



SHQIPERIA NE SYT E "TE MËDHENJVET"

dim, zyrtaret inglize refuzuan vashduarazi qe te pergjigjen "po" ose "jo".

Pergjigjia e zyrtareve te Departmentit te Shtetit, nga ana tjeter, ishte q' Amerika nuk esht pjesetare kurrsesi ne nonje marreveshje te fshehte ose te hapet qe perket kufiret e Shqiperis.

Sa per zyrtaret e Ambasades Sovietike ne Washington ne çdo pyetje q' u ishte parashtruar nga ana jone, pergjigjia ishte gjithmone e njeshte: kejo ambasade nuk merret me çeshtjen e Shqiperis.

Shkuan dy vjet pas ketyre deklarave—dy vjet te mbushur me polemika t' ashpra midis LIRIS dhe DIE-LLIT rreth çeshtjes se pozites se Zogut ne mergim. Ne baze te nje letre te Komitetit Ballkanik te Londres, te cilen e kishte falsifikuar pjeserisht Sotir Martini, Minister i Oborit (sic) te Zogut, organi i VATRËS bertiste me insistim se Beu i Matit ishte akoma "mbret i Shqiperis" dhe se "Shqiperia s' munt te behet pa Zogun".

Keto polemika do te kishin marre fund, shigurisht, sikur Departmenti i Shtetit te sqaronte çeshtjen nese Amerika vashdonte t' a njohe Zogun si kryetar te Shtetit Shqiptar. Per fat te keq, Departmenti refuzoi te beje nje deklarate te tille te prere.

Keshtu, pra, kur me rastin e festimit t' independences shqiptare ne Nentor 1944 Departmenti i Shtetit leshoj nje deklarate te re te mbushur me fjale entusiastike per Shqiperin, çeshtja e regjimit t' arthme mbeti prape e varrur, si-me-thene, n' ere.

NGA SA munt te dihet ne baze te dokumentave pak a shume zyrtare, çeshtja e Shqiperis u-zu ne goje per



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

KEJO ISHTE fryma qe mbreteronte ne Washington rreth nje faze te çeshtjes shqiptare, kur une u-paraqita ne Departmentin e Shtetit brenda ati muaji te Janarit per te perfaqesuar organizaten SHQIPËRIA e LIRË q' ishte formuar nje jave më pare.

Pas nje viti punimi te papushuar, nje tjeter kenge filloi te degjohej rreth Shqiperis ne Hall'et e Departmentit si edhe ne zyrat e tjera. Prova gjendet ne deklaraten e bujeshme qe leshoi Sekretari i Shtetit, Mr. Cordell Hull, me 10 Dhjetor 1942.

Siç dihet pergjithërisht, me ate deklarate qeveria amerikane i jepte popullit shqiptar shigurimin me solemn se te drejtat e tij per liri dhe independence njiheshin teresisht nga ana e Amerikes e cila, nga ana tjeter, nuk e kishte njohur n' asnje menyre aneksimin e Shqiperis prej Italis.

Tue i dhene rendesin e duhur kesaj deklarate te qeveris amerikane, qeverit e Anglis dhe Ruis Sovitike shpejtuan te bejen deklarata analoge ne favor t' independences se Shqiperis. Vetem se Ministri i Puneve te Jashtme t' Anglis, Mr. Anthony Eden, shtoi, ndaj fundit, nje paragraf q' u-interpretua si vertetim i qenies se Planit te Trete te Coptimit te Shqiperis. Teksti i paragrafit ne fjale ishte ky:

“Qeveria e Madhestis se Tij e veshtron çeshtjen e kufireve te Shtetit Shqiptar, ne mbarim te luftes, si nje problem qe ka per t' u-konsideruar ne Konferencen e Pages.”

Sa here q' u-pyeten me insistim prej delegateve te SHQIPËRIS se LIRË ne Washington dhe Londre, nese deklarata e z. Anthony Eden kishte kuptimin se çeshtja e Korçes dhe Gjinokastres mbetej e hapur per bise-



SHQIPERIA NE SYT E "TE MEDHENJVET"

dim, zyrtaret inglize refuzuan vashduarazi qe te pergjigjen "po" ose "jo".

Pergjigjia e zyrtareve te Departmentit te Shtetit, nga ana tjeter, ishte q' Amerika nuk esht pjesetare kurrsesi ne nonje marreveshje te fshehte ose te hapet qe perket kufiret e Shqiperis.

Sa per zyrtaret e Ambasades Sovietike ne Washington ne çdo pyetje q' u ishte parashtruar nga ana jone, pergjigjia ishte gjithmone e njeshte: kejo ambasade nuk merret me çeshtjen e Shqiperis.

Shkuan dy vjet pas ketyre deklarave—dy vjet te mbushur me polemika t' ashpra midis LIRIS dhe DIE-LLIT rreth çeshtjes se pozites se Zogut ne mergim. Ne baze te nje letre te Komitetit Ballkanik te Londres, te cilen e kishte falsifikuar pjeserisht Sotir Martini, Minister i Oborit (sic) te Zogut, organi i VATRES bertiste me insistim se Beu i Matit ishte akoma "mbret i Shqiperis" dhe se "Shqiperia s' munt te behet pa Zogun".

Keto polemika do te kishin marre fund, shigurisht, sikur Departmenti i Shtetit te sqaronte çeshtjen nese Amerika vashdonte t' a njohe Zogun si kryetar te Shtetit Shqiptar. Per fat te keq, Departmenti refuzoi te beje nje deklarate te tille te prere.

Keshtu, pra, kur me rastin e festimit t' independences shqiptare ne Nentor 1944 Departmenti i Shtetit leshoj nje deklarate te re te mbushur me fjale entusiastike per Shqiperin, çeshtja e regjimit t' arthme mbeti prape e varrur, si-me-thene, n' ere.

NGA SA munt te dihet ne baze te dokumentave pak a shume zyrtare, çeshtja e Shqiperis u-zu ne goje per



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

te fundit here, para se te mbaronte lufta, ne Konferencen e Jalltes (Shkurt, 1945). Ne nje bisedim te triçipte (Stalin, Roosevelt, Churchill), me 4 t' ati muaji, rreth çeshtjes se cilat nga Fuqit kryesore duhej te varrej pergjigjesia e ruajtjes se paqes, Mareshali Stalin mbrojti thezen se vetem Fuqit e Medha mbi te cilat rra barra më e madhe e luftes duhet te merren me detyren e ruajtjes se paqes ne bote.

“Do te jete qesharake,” tha Mareshali Stalin, “qe te besohet se nje vend i vogel si Shqiperia te vihet ne nje radhe me “tre te Medhenjt’ ”. Dhe pak me von e sqaroi më hapet mendimin e tij tue shtuar:

“Jugoslavia, Shqiperia, dhe kombe te vegjel si keto nuk meritojen te rrine ne nje tryeze me ne te tjeret. A jini te mendjes qe Shqiperia te perfillet ne nje shkalle me Shtetet e Bashkuar? Ç’ ka bere Shqiperia ne kete lufte qe te meritoje nje pozite te tille?

Ne keto deklarata-pyetje te Mareshalit Stalin, Presidenti Roosevelt dhe Kryeministri Churchill u-pergjegjen se, me gjith qe te “Tre te Medhenjt’ ” do te merrnin persiper natyrisht pergjigjesin më te madhe per paqe, prape-se-prapi te drejtat e kombeve më te vegjel duhen respektuar.


(Bisedimet e sipërme midis Tre te Medhenjve jane marre nga libri i ish-Sekretarit te Shtetit Stettinius Roosevelt and the Russians pa nonje koment nga ana e autorit).

Ajo q’ esht per te vene re ne keto shkembime mendimesh e Tre te Medhenjve mbi Shqiperin esht pika qe gjer n’ ate kohe nuk dihet te jete marre nonje vendim i prere mbi te pritmen e Shqiperis. Dhe çudia esht se ne Konferencen e Teheranit, q’ u-mbajt ne muajt



KOMITETI NACIONAL I ÇLIRIMIT NË VEPRIM

Nentor-Dhjetor 1943, ne te cilen u-caktuan zonat ushteriake ne Ballkan (Greqia ne zonen inglize, Jugosllavia ne zonen e perbashket anglo-sovietike), Shqipëria nuk u-zu ne goje. Nga ky mungim i pashpieguarshem rrodhi më von konflikti midis Fuqive te Perendimit dhe Ruis Sovietike rreth çeshtjes se ne cilen ane do te mbetej Shqipëria, pas mbarimit te luftes. Dhe perseri, munt te thuhet se po nga shkaku i ati mungimi vete Fuqit e Perendimit e lehtesuan ardhjen ne fuqi te Komitetit te Çlirimit Nacional me Enver Hoxhen ne krye.



KAPTINE V

Komiteti Nacional i Çlirimit ne Veprim

NË BARANGËN Nr. 48 te sheshit te perqendrimit te Frances Jugore, Vernet de l' Ariège, ku mbliidheshin Komunistet e Luftes se Spanjes, kenget jepnin e merrnin po-thua-se çdo dite, shume here dy here ne dite. Dhe çdo here qe kalonja andej i mbanja veshet te ngrehur per te kapur tingujt e "Internacionales", e hymnit nderkombetar te mirenjohur. Asnje here te vetem nuk kapa nonje tingull qe t' i afrohej.

Me ne fund, pyeta nje nga te tre "shoket" Shqiptare qe mbeshtilleshin n' ate barange bashku me shoket e tyre te Spanjes:

"Perse nuk ia thirrni nonje here 'Internacionales'?"

"Sepse tingujt e saj," m'u-pegjegj ay, "jane te njohur edhe ner 'gomaret e Frances', ner keto mushkat qe ruajen kete kamp. . . Por kemi ujdishur kenge te reja me kuptim te fshehur, si kenga e Gjeneralit Dum-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

browski, dhe veçanerisht 'La Carmela' qe tingellon si kenge dashurie, kurse ndjenjat qe çfaqen ne 'te jane ato t' idealit t' one. . ."

"T' idealit komunist?"

"Sh-sh. . . mos e zer ne goje ate fjale, te lutem," me peshperiti bashkefolesi i im, tue hedhur syt me te djathte e me te mengjer.

"Si?" i thashe me çudi. "Nuk jini Komuniste? Por autoritetet e kampit ju kane vene ne baranga te veçanta si Komuniste! . . ."

"Se ç' bejne autoritetet e kampit, ajo esht puna e tyre. "Por, pas Luftes se Spanjes ardhi urdher nga qendra qe pasketaj te quhemi dhe te mbahemi si 'demokrate' te thjeshte. . ."

Kejo ka qene, me te vertet, nje nga dredhit e afta me anen e te cilave Komunistet e fshehur nen roben e "demokratis" munden te terheqin n' anen e tyre nje tog elemente t' etuar per demokrati.

Ne ndjekje t' asaj rruge dredharake, organizatat komuniste te çdo vendi muarren emrin "Komitet Nacional i Çlirimit". Termat "nacional" dhe "i çlirimit" te lidhura me termen komplotiste "Komitet" ishin fjale magjike per çdo popull q' enderonte per nje "komb te lire" qe do te gezonte pasketaj nje regjim "thjesht demokratik"; keto perbenin thirrjen me terheqese shpirterore per gjith njerzit e shtypur nga diktaturat fasciste a naziste ose nga regjimet brutale dhe te korruptuar q' ishin asikohe ne fuqi ne pjesen mé te madhe t' Europes.

Per mé teper, Komitetet Nacionale Çlirimtare te vendeve te ndryshem ishin te lidhur ngushte midis tyre dhe vepronin nen direktivat e nje qendre te vetem



KOMITETI NACIONAL I ÇLIRIMIT NË VEPRIM

qe gjendej ne Moske. Krejt e kunderta ngjante me partit e tjera te cilat, tue qene esencialisht "nacionaliste", punonin vetem per interesin e vendit te tyre; dhe jo vetem qe nuk kishin nonje lidhje me partit analoge te vendeve te tjere, por ishin shpesh here ne kundreshtim te rrepte me ato.

KY ISHTE nje nga faktoret qe ndihmuan pa hesap veprimet e Komitetit Nacional te Çlirimit ne Shqiperi, me nje ndryshim fort te rendesishem: qe ne Shqiperi nuk gjendej asnje parti tjetër e organizuar, ashtu si gjendeshin parti t' organizuara ne vendet e tjere te Ballkanit. Aresya e kesaj mungese esenciale gjendej n' urrejtjen q' ushqente regjimi i Zogut kundrejt çdo partie. Dhe çudia esht qe Zogu nuk lejoi kurre qe te formohej as edhe nonje parti e tij. Per kete ka dy shpiegime. I pari qe Zogu kishte frike semos partia munt t' i kerkonte nonje dite hesap per veprimet e tij te parregullshem; dhe i dyti qe Zogu nuk kishte ndermend te mbahej ne fuqi me ane te forcave konstitucionale te vendit, por me anen e ndihmes dhe perkrahjes se Fuqive te jashtme (te Jugoslavis qe me 1924 gjer me 1926 dhe t' Italis Fasciste qe me 1926 gjer me 1939).

Keshtu, pra, kur mori fund regjimi i tij, ne Shqiperi nuk eksistonte asnje parti ose grup i organizuar—me perjashtimin e çelave te fshehta te Komitetit Nacional te Çlirimit. As ata qe muarre qeverin ne dore ne Prill 1939 nen mbrojtjen e Fascismit nuk kishin nonje lidhje ne mes te tyre. Kejo u-provua nga kundreshtimi i rrepte qe plasi pak me von midis grupit te Shefqet Verlacit dhe ati te Mustafa Merlike Krujes. Ndaj fundit, u-formua edhe nje fare "Partie Fasciste",



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

por ajo ishte më tepër sa për sy e faqe se sa për veprim të vashduar.

Tuë përfituar nga kejo situatë, ata që nuk ishin as me Shefqet Verlacin as me Mustafa Krujen, organizuan një grup të ri me emrin "Balli Kombëtar", në të cilin hynte mbeturinat e "Bashkimit Kombëtar" të formuar në mërgim si edhe të disa grupeve lokale. Por, ashtu siç tregon edhe vetë fjala "ball", kejo organizatë e re nuk ishte një parti homogjene, por një grup më i math i përbërë nga grupe më të vegjël, në radhë të cilëve gjendeshin bejlerë, agallarë, arhondë, klerikë dhe fshatarë. E vetë pikëlidhje midis këtyre grupeve ishte: të lëftonin grupin pro-Fascist Verlaci-Kruja. Dhe kejo shpiegon, gjë në një masë, se si disa nga krerët e "Ballit" pranuan të marrin pjesë në kabinetet e formuar gjatë okupimit italian. Qëllimi i tyre ishte të mbanin larg nga qeveria Verlacin dhe Krujen që akuzoheshin si kryeshkaktarë të shkeljes tradhësore të Shqipërisë nga ana e Italisë dhe, në këtë mënyrë, të pakësonin efektet fatkeqe të okupimit.

Në fakt, Balli ndiqte në këtë kohë një politikë me dy faqe: bente sikur bashkëpunonte me Italianët, por, nga ana tjetër, sabotonte, atje ku i mundej, veprimet e autoriteteve italiane me anë të etash të armatosura.

Fatkeqësisht për Ballin—dhe për popullin shqiptar—në këtë çetë ishin futur ose pranuar edhe një tog elemente të pandershëm. Këto e vertetën, mjaft naivisht, vetë organi zyrtar i qendrës së Ballit në Romë. Në një kryeartikull inglisht të botuar në numurin Korrik-Gusht 1951 të gazetës "Flamuri", përmbahen keto vija të verejshme:

Ishin disa (nga të Ballit) që keshillonin një vep-



KOMITETI NACIONAL I ÇLIRIMIT NË VEPRIM

rim te perbashket me gjith elementet pa nonje dallim, me njers te mire dhe njers te keqij, me aventuriere dhe trathetore. . . Ngjarjet dhe klithmat hysterike te njerësve (te Ballit) qe kishin deshtuar per faqe te zeze u-bene shkak qe te dalin perpara nje tog aventuriere dhe te marrin pjese ne luften kunder Komunisteve. . . Keta aventuriere punonin per interesat dhe ambiciet e veta dhe ne dem te çeshtjes kombetare.

Incidenterisht, ata aventuriere vodhen, doqen, vrane dhe çnderuan emrin e Ballit ne syt e popullit shqiptar.

Nga ana tjeter, gjith elementet e tjera—dhe keto perbenin shumicen e madhe te popullit—qe nuk ia donin shendetin as Verlacit as Mustafa Krujes, qe nuk pelqenin aspak politiken me dy faqe te Ballit dhe q' urrenin emrin e Zogut, u-terhoqen dal-nga-dal ndaj Komitetit Nacional te Çlirimit i cili premtonte se, me ardhjen e tij ne fuqi, Shqiperia do te behej me-nje-herc lulja e Ballkanit ku do te mbreteronte liria, drejtesia, barasia, vellazerimi dhe do te shigurohej "buke per te gjithë". Per te vertet, keto ishin gjerat q' enderonte çdo popull i shtypur prej nje kohe te gjate nga regjimet e korruptuar qe punonin vetem per interesin e tyre ose per interes te disa klasave te caktuara.

Me gjith ate, ne fillim te veprimit te tyre, çetat e armatosura te Ballit ishin ne bashkepunim te ngushte dhe leftonin bri-per-bri me çetat e Komitetit Nacional te Çlirimit. Veç asaj, kreret e dy paleve mbajten nje tog mbledhje te fshehta per te caktuar nje program te perbashket.

KEJO SITUATE vashdoi gjer ne fillim te vitit 1943



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

kur muarre vend dy ngjarje me rendesi te jashteza-konshme; Konferenca e Teheranit dhe njohja e qeveris se Mareshalit Tito nga ana e Amerikes, Anglis dhe Ruis, mbi insistimin e kesaj se fundit.

Konferenca e Teheranit caktoi, sic dihet, zonat e veprimeve ushteriake ne Ballkan. Me vendimin te saj, u-njoh si zone ruse: Bullgaria, Rumania dhe Hungaria; Greqia mbeti ne zonen inglize, dhe Jugoslavia do te perfillej si zone e perbashket anglo-ruse. Por Shqiperia nuk u-zu ne goje aspak, dhe keshtu mbeti si nje shesh i lire per intriga aq nga ana e Anglis sa edhe nga ana e Ruis per t' a bere ate vend per vete.

Njohja e qeveris se Mareshalit Tito, nga ana tjetere, i vu vulen fatit te Shqiperis. Tue qene se qeveria e Tito's ishte e para dhe me e forta qeveri komuniste ne Ballkan dhe Shqiperia ishte kufi me Jugoslavin, Mareshali mori persiper te terheqe Shqiperin nga ana e bllokut komunist, me ane te bashkepunimit te ngushte midis Komitetit Nacional (lirimtar te Jugoslavis me Komitetin Nacional (lirimtar te Shqiperis. Me kete qellim parasysh, Mareshali Tito ishte tue mbajtur qe prej kohe ne Shqiperi agjentet e tij, midis te cileve ishin dy figura misterioze qe njihen vetem nen emrat Miladin dhe Dushan. Disa duan te thone se keta te dy nuk ishin vetem keshilltare t' Enver Hoxhes, i cili ne kete kohe kishte marre komanden e pergjitheshme te forcave te Komitetit Nacional te Shqiperis qe pasketaj do te njiheshin si "Partizane", por qe, ne fakt, ishin drejtonjesit e vertete te levizjes partizane ne Shqiperi.

Po ashtu, Komiteti Nacional i Shqiperis kishte lidhje te ngushta edhe me Partizanet e Greqis dhe Bullgaris,



KOMITETI NACIONAL I ÇLIRIMIT NË VEPRIM

por jo aq te ngushta sa ato qe munden te farkojen Miladini dhe Dushani.

Ne kete menyre, Balli Kombetar qe priste te ndihmohej prej Inglizeve dhe Amerikanëve, mbeti ne poziten më te keqe, veçanerisht sepse perkundrejt ketyre shpresave te Ballit, Partizanet perdore dy argumenta te forta propagande:

1) Q' Anglia, dhe indirekterisht Amerika, ishin ne favor te kethimit te Zogut ne Shqiperi, dhe populli e dinte se ç' priste nga nje kethim i atille;

2) Q' Anglia, dhe indirekterisht Amerika, ishin ne favor t' aneksimit te Toskeris nga ana e Greqis.

Keto dy argumenta paten nje force bindese te posaçme per popullin nga qe, as qeveria e Londres as ajo e Washington'it, nuk e gjeten t' aresyeshme gjate gjith asaj kohe te sqarojen, pertej çdo dyshimi, pozitën e tyre kundrejt atyre dy pikave qe perkisnin fatin e pritem te Shqiperis.

Nga kejo pikepamje munt te thuhet, pa frike pergenjeshtrimi, se vete Anglo-Amerikanet e shtyne Shqiperin ne krahet e bllokut komunist, gje per te cilen do te pendoheshin, por kur ishte teper von.

Per keto aresye, s'mbetej asnje dyshim se nga ç'ane do te rendonte shumica e madhe e popullit shqiptar ne konfliktin midis Ballit dhe Komitetit Nacional te Çlirimit, veçanerisht kur ky i fundit zotohej t' a zbrese Parajsin nga qielli per t' a vendosur ne tokat e mjeruara te Shqiperis.

Sa per Ballin, edhe ay u-mundua nga ana e tij te lidhej, sidomos, me forcat e rezistences anti-komuniste te Greqis. Per kete qellim po dergohej ne Greqi Dimitri Faloja, nje gazetar Korçar. Por ata te Komi-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

tetit Nacional u-treguan se kishin nje sherbim spiunazhi shume me t' afte. Para se Dhimitri Faloja te dilte nga toka shqiptare per te marre udhen e Greqis, Partizanet i vune pusi dhe e lane te vrare ne vend.

Q' AHERE filloi seria e vrasjeve midis anetareve e te dy grupeve, vrasje vellavrasese qe si ajo s' ishte pare gjer n' ate kohe ne Shqiperi.

Nga ana tjeter, porsa q' e ndjeu veten e tij te shiguruar nga pikepamja nderkombtare, Komiteti Nacional i Çlirimit u hapi lufte te rrepte e te pameshirte si Ballistevë ashtu edhe okupatoreve te huaj, Italiane dhe Gjermane. Ndaj fundit te vitit 1944, forcat e Komitetit Nacional, te udhehequra njetash haptazi prej Gjeneralit Enver Hoxha, e spastruan Shqiperin nga Italianet, Gjermanet dhe Ballistet.

Ky ishte, per te vertet, nje triumf i pashembellte per forcat popullore. Ne fjalet e korrespondentit Peter Furst te gazetes "Stars and Stripes", organ i Fuqive Armate (Armed Forces) t' Amerikes, i cili vizitoi Tiranen ne fund te vitit 1945:

"Perkundrazi t' asaj qe ngjau per çdo komb tjeter t' okupuar, Shqiperia e liroi krejt veten e saj nga okupata armike pa nonje ndihme ose nderhyrje ushteriake nga ana e Fuqive Aliate."

Kejo duhet t' i jape fund çdo akuze, ankimi a renkimi te Ballistevë se gjoja keta e humben luften nga shkak i nderhyrjes se fuqive te jashtme. Fakti i pamohuarshem esht se ne Shqiperi nuk vu kembe asnje ushtar i huaj, Amerikan, Ingiliz, Rus ose Jugoslav per te ndihmuar forcat e Çlirimit.

Shkurte, Balli e humbi luften se nuk mundi ose nuk diji t' a beje popullin per vete.



“PUSHTETI” I POPULLIT NE FUQI

KAPTINE VI

“Pushteti” i Popullit ne Fuqi

POR, triumfi i shkelqyer i forcave te Çlirimit esht vetem njera ane e medaljes. Esht kohe qe te hedhim nje sy n' anen tjeter.

Ne mbremje te dites 27 Nentor 1944, d. m. th. ne vengjillin e mevitjes se 33-te t' independences shqiptare, muarren fund brenda ne Tirane perpjekjet me te tmershme dhe me te gjakshme midis forcave çlirimtare dhe mbeturinave t' ushteris se dermuar gjermane q' ishte prapsur nga Greqia dhe po kerkonte shpetim tue u-hequr permes tokave te Shqiperis.

N' ate dite te paharrueshme per popullsin e kryeqytetit, Tirana jepte pamjen e nje kasapane te mner-shme, ne te cilen gjaku i ushtareve gjermane u-trazua me gjakun e kundreshtareve shqiptare te Komitetit Nacional te Çlirimit, Balliste, Zogiste, liberale, fajtor ose te pafajshem. Te ndezur nga lufta dhe t' etuar per ahmarrje, Partizanet u-versule neper kafeana dhe vende te tjere publike dhe private per te vrare çdo njeri q' ishte shenuar qe me pare si “armik i popullit” dhe per t' arrestuar nje tog te tjere per te cilet ishte vendosur po ashtu qe me pare qe te shkonin neper formalitetet e “Gjykates se Popullit” per t' u-bere shembell per gjith kundreshtaret e regjimit te ri. Shume nga keta fatzes qe nuk iken siç kishin bere shoket e tyre do te kishin thene ne zemren e tyre: “Pa ç' ka! edhe keta qe po vijen tani jane Shqiptare si ne te tjeret. Fundi i fundit do te na burgosin per disa dit dhe pastaj do te na lirojne! . . .”



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

Ay ishte gabimi i tyre tragjik. Sepse ata nuk kishin kuptuar se forcat e Komitetit Nacional ishin organe te nje revolucioni permbyses e gjith systemit te vjeter, politik, shoqnor, ekonomik, per te vene ne vend te tij nje system krejt te ri.

Çdo njeri qe ka mesuar diçka nga historia e shkuar esht i shtrenguar te pranoje se ne kohe revolucioni politik, shoqnor dhe ekonomik, denimet dhe ekzekutimet, si edhe masakrat ketu-atje, jane çfaqje te pandareshme te permbysjes se krejte te systemit te vjeter. Ne revolucionin e Frances, qe filloi ne vitin 1789 dhe vashdoi per nja dhjete vjet, u-denuan, u-eksekutuan dhe u-masakruan me qindra mije njers, te fajshem e te pafajshem; dhe ne permbysjen edhe më te madhe qe shkaktoi Lenini me Trotsky'n ne Rusi, me 1917, viktimat e revolucionit numerohen me milione. Te vetemit vende qe kane shpetuar nga tmeret e revolucionit jane Shtetet e Bashkuar, Anglia dhe Shtetet e Skandinavis, ku ndryshimet nga nje system ne nje tjeter jane bere me ane te votes dhe jo te pushkes ose te litarit.

Kur vjen puna pastaj ne Ballkan, munt te thuhet se asnje ndryshim, politik ose shoqnor, sado i vogel, nuk ka ndodhur pa gjakderdhje, shpesh here krejt te panevojshme. Nje nga fjalet e urta popullore te Ballkanit esht se "nuk behet dasme pa therrur mish"; aq më fort nuk munt te shkulet nje system i vjeter pa u-çfarosur ata q' e mbanin ne fuqi dhe ne veprim.

Ishte gje per t' u-pritur, pra, se tue ardhur ne fuqi pas nje sere luftash te rrepta kunder regjimeve te shkuar, kunder atyre q' ishin bere shkak per shkel-



“PUSHTETI” I POPULLIT NË FUQI

jen e Shqiperis nga Italia Fasciste, kunder atyre qe kishin bashkepunuar me Italianet dhe Gjermanet, kunder bejlereve dhe arhondeve q' e kishin perdorur Shqiperin si çiflig te tyre, Komiteti ç'irimtar nuk munt te bente ndryshe veçse te çduke shkatetaret e mjerimeve shekullore te popullit. Çdo veprim tjeter do t' ishte engjellor. Per fat te keq, popujt e Ballkanit gjenden më larg se çdo komb tjeter nga sera e kerubimeve dhe serafimeve.

Ne driten e keti interpretimi historik, nje numur i math, nemos shumica e madhe e denimeve, burgimeve dhe eksekutimeve te kryer nga qeveria e Enver Hoxhes munt te gjeje nje fare justifikimi. Pyetja esht se sa larg ka te drejte te veje qeveria dhe sa kohe duhet te vashdoje sundimin me ane te terrorismit.

PER TË parashtruar nje shembell se ç' pergjigjie i duhet dhene asaj pyetjeje, ndofta mjafton te kujtojem fundin tragjik e tre djemve te rinj: Kol Berishes, Katolik nga Shkodra; Mustafa Gjinishit, Mysliman nga Peqini i Elbasanit; Loni Adam, Orthodhoks nga Proçori i Korçes.

Gjate kohes qe vashdonte botimin e saj ne Tirane gazeta ime e perditeshme “ORA” (1929-1932), keta tre graduate te Shkolles Teknike te Tiranës, hyne ne sherbim te gazetës si ndihmes reportere. Qe te tre hiqeshin si Komuniste dhe kete nuk e fshihnin nga mua. Por, ne fakt, ishin Komuniste idealiste, nga ata qe besonin se çdo problem i Shqiperis do te zgjidhej automatikisht me triumfin e Komunizmit ne Ballkan.

Nje dite i mbertheva qe te tre ne zyren e gazetës per t' i pyetur se ç' prisnin nga Komunizmi.



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

“Nen regjimin e Zogut,” u-pergjegj Gjinishi, më i shkatheti ner shoket, “s’ ka asnje shprese per ne te rinjt, sepse regjimi i tij mbahet me kembe me perkrahjen e Italis Fasciste, dhe keshtu ay s’ ka nevoje per sherbimet t’ ona. Perkundrazi Komunismi ka per program te çduke diktaturat si kejo e Zogut. . . Prandaj nuk shekojme shpetim tjeter veç triumfit te Komunistit. . .”

Ne ndjekje te keti ideali—ideal i gabuar mbassi baza e Komunistit esht diktatura—qe te tre hyne ne radhet e Komitetit Nacional Çlirimtar per t’ arrijtur ne shkalla mjaft te nalta. Mustafa Gjinishi sherbente si Komisar Politik prane Fuqive Çlirimtare kur u-vra me te pabese. Kol Berisha ishte pjesetar i delegacionit te Qeveris s’ Enver Hoxhes prane Aliateve ne Bari t’ Italis me 1944. Per Loni Adamin s’ kam nonje shenim te veçante.

Por, me 1946, kur qeveria e Enver Hoxhes e hodhi masken e demokratis tue dale perpara gjith botes si diktature komuniste, Kol Berisha dhe Loni Adam u-arrestuan dhe u-plasen ne burg ku vdiqen brenda vitit nga mundimet, vajtjet dhe keqperdorimet.

Ç’ krim kishin bere keta te tre filiza te rinj e plot shprese qe te meritojen nje fund aq te tmershem? Asnje krim ose faj veç shprehjes se mendimit te tyre qe regjimi i ri duhet te kete parasysh kryepari interesat e Shqiperis dhe jo ato te Jugoslavis ose te Ruisis. (N’ ate kohe qeveria e Hoxhes s’ kishte asnje lidhje me Mosken, por vepronte simbas direktivave qe merrte nga Belgradi).

Q’ ahere me qindra—ne mos me mijra—njers jane



ΕΠΙΣΤΗΜΟΝΙΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ
ΕΛΛΗΝΙΚΗΣ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑΣ

"PUSHTETI" I POPULLIT NE FUQI

eksekutuar dhe me mijra te tjere jane burgosur po per ate arsye per te cilen gjeten vdekje tragjike Gjiniishi, Berisha dhe Adami; per dashurin e tyre me te madhe kundrejt Shqiperis qe nuk i lejonte t' ishin besnike te verber te politikës se Jugoslavis ose Ruis Sovietike.

Kete forme ka marre, pra, diktatura komuniste e Enver Hoxhes q' e quan veten, mjaft aftesisht, "Pushtet i Popullit", mbassi fjala "pushtet" ka kuptimin e "forces" dhe te "shtrengates".

Me perjashtimin e diktaturave per nje kohe te shkurter t' imponuara nga raste te jashtezakonshe, gjith diktaturat qe vendosin te perjetesojen vete e tyre ne fuqi me ane te forces dalin nga nje kanal i ndyte dhe i felliqur; me ndryshimin qe diktaturat ideologjike, qofshin fasciste, naziste ose komuniste, veshin robot e idealismit per t' ia arrijtur qellimit te tyre me efektivisht.

Sa per regjimin komunist, baza e tij themelore esht parimi i forces, i shtrengates, i mos-pranimit t' ansnje kritike—qofte edhe per shaka—dhe i spastrimit te çdo kritikonjesi te veprimeve te qeveris ne fuqi. Ne fakt, regjimet komuniste nuk jane tjeter veçse kopje besnike te njeri-jatrit, dhe veprojen ne nje menyre te njeshme. Kete m' a kishte shpieguar, pa lene ansnje pike dyshimi, Ministri i tashem i Puneve te Brendeshme, Mehmet Shehu.

"Per te rrenjosur Komunismen ne çdo vend qofte dhe, sidomos, ne Shqiperi," tha Shehu ne muhabet e siper ne sheshin e perqendrimit te Frances (1941), "do te jete nevoje qe te çfarosen gjith elementet kundre-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

shtare, ne menyre qe te mbeten vetem ata qe besojne pa asnje reserve ne dogmen komuniste.”

“Dhe ne qofte se shumica e popullit esht kunder?” e pyeta.

“Ahere shumica duhet çfarosur,” u-pergjegj Shehu, dhe asnje nga shoket e tjere te tij nuk e kundreshtoi.

Simbas lajmeve qe na vijen kohe me kohe nga Shqiperia, duket se ate esht tue bere ne kete kohe Ministri i Brendeshem i “Pushtetit te Popullit” per lavdin me te madhe te Marx’it, Lenin’it dhe Stalin’it.

POR AHERE ç’ mbeti nga predikimet e Komitetit Nacional te Çlirimit para se te vinte ne fuqi, se Shqiperia do te behej lulja e Ballkanit ku do te mbreteronte liria, barasia, vellazerimi—dhe buke per te gjithe?

Detyra historike e lyp q’ ay qe merret me pershkrimin dhe komentimin e ngjarjeve te nje periudhe te mbushe, me sa t’ i mundet, te dy anet e defterit.

N’ ane te kredis shenuam aty me pare çlirimin triumfal te tokave shqiptare me ane te forcave popullore, pa nonje ndihme ose nderhyrje ushteriake nga ana e Aliateve. Nga te gjith kombet e shkelur, te medhenj e te vegjel, vetem Shqiperia i arrijti ati kulmi lavdie. Esht krejt çeshtje tjeter qe vendi i yne u-lirua nga okupata e huaj per te hyre nen zgjedhen e nje ideologjie te huaj.

Ne radhen e dyte te shtylles se kredis vjen çdukja e gjurmave te fundme te feudalismit dhe te jetes primitive patriarkale. Fshirja nga faqja e tokes shqiptare e klases se bejlereve, arhondeve dhe bajraktareve qe kishin sunduar vendin prej shekujsh ne nje menyre ose nje tjeter, u-krye aq efektivisht sa qe, edhe me



“PUSHTETI” I POPULLIT NE FUQI

çdukjen e regjimit te ri, te mos mbetet mundesi q' ajo klase te fitoje nonje dite poziten qe kishte gezuar me pare, se-paku jo ne shkallen e kohes se shkuar.

Po ajo ngjau edhe me mbeturinat e influences se klerit mysliman, katolik, bektashian ose orthodoxks. Ne kete pike, qeveria e Komitetit Nacional shkoi me tej se Kodi Civil, monumenti me i gjalle i regjimit zogist, mbassi ajo mori masat e fundit per te shlyer çdo influence q' i kishte mbetur klerit permbe shumicen ignorante te popullit.

Tue perdorur nje shembellim, munt te thuhet se regjimi i ri e kapi popullin prej supesh— disa duan te thone prej gryke—e tundi dhe e shkundi gjersa i kerccyen syt perjashta, tue i thene: “Be-u burre ne te drejten t' ende; pusho te jesh bujk dhe skllav i bejlereve, agallareve, bajraktareve dhe arhondeve, dhe mos e sheko me veten si mysliman ose i krishtere por si nje popull i njeshte.”

Ne radhen e trete vjen nje riforme fort e vonuar: emancipimi i gruas. Per te paren here ne historin e Shqiperis, ndofta qe ne kohën e mbretërimit te Teutes, seksit femnor iu njoh e drejta e barasis me seksin mashkull, me ane te dhenies se votes ne nje shkalle me burrat, me ane te çeljes se zyrave dhe ofiqeve te Shtetit per femrat qe kane zotesin e duhur per ato sherbime, me ane te formimit te batalonave te vajzave ku, natyrisht, u-bene shume abuzime te shemtuar.

Nje tjeter ndryshim radikal esht reforma agrare, te cilen çdo regjim e vinte ne krye te programit te tij dhe pastaj harronte t' a vinte ne veprim. Nen regjimin e Zogut, per shembell, u-hartua ne Seksionin e Financave te Keshillit te Shtetit, qe kryesonja une n' ate kohe,



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

nje Ligj i Riformes Agrare ne baza mjaft liberale sa te munt te zgjidheshin problemet me kryesore te bujkut. Por Zogu e perdori ate ligj vetem pjeserisht tue e zbatuar kunder disa kundreshtareve te tij. Regjimi i "Pushtetit te Popullit" e zgjidhi radikalisht problemin: i liroi gjith bujqit tue ndare midis tyre tokat e Shtetit sa edhe te bejlereve. Por, siç munt te pritej nga dogmat komuniste, kete here marresit e tokave, se bashku me pronaret e tokave te lira, u-bene bujq te Shtetit.

Ka edhe reforma te tjera qe meritojen te permenden, por munt te thuhet me nje fjale se regjimi i ri kryejti gjith rformat e premtuara, dhe shpesh te harruara, prej gjith regjimeve te kohes se shkuar, me ndryshimin qe çdo reforme u-vu ne veprim jo aq per te miren e popullit se sa per t' u-konformuar pike-per-pike me dogmen socialiste-komuniste. Simbas asaj dogme, Shteti esht zot i gjith pasuris se vendit, dhe Shteti rregullon çdo veprim dhe sjellje te qytetareve te tij ne çdo pikepamje: politike, shoqnore, ekonomike, fetare dhe familjare. Nga ana e tij, Shteti vepron me ane te nje partie te vetem qe munt te marre emra te ndryshme—ne Shqiperi quhet "Parti e Punes"—por qe ne çdo rast nuk esht tjetër veçse Partia Komuniste.

Ne nje regjim te tille, pra, nuk munt te behet fjale as per liri, as per lumteri, as per vellazerim, as per barasi. Sa per "buke per te gjithë", do te kemi rast te bejem fjale me tutje.

Kur shumica e madhe e popullit shqiptar i rra pas Komitetit Nacional te Çlirimit dhe brohoriti ardhjen e tij ne fuqi dhe pastaj e legalizoi me votat e tij ne



TRASHËGIMET HISTORIKE TË VATRËS

zgjedhjet e Dhjetorit 1945, as 1 ne 10,000 veta nuk kishte as iden me te pakte se Shqiperia do te futej ne kallepin komunist. Ate e dinte vetem qarku me i ngushte i Enver Hoxhes dhe Mehmet Shehut. Mbi ate pike nuk kishin dijeni as, ndofta, shumica e pjesetareve te qeveris q' u-formua ne Permet, Maj 1944.

KAPTINE VII

Trashegimet Historike te VATRËS

GJITH sa u-thane me siper mbi transformimin e Komitetit te Çlirimit nga nje grup demokratik—siç e shpallte veten perpara syve te popullit gjate luftes—ne nje qeveri thjesht komuniste, kane gene ne dijeni te plotte te zyrtareve te VATRËS dhe DIELLIT. Po ajo munt te thuhet edhe per zyrtaret e SHQIPËRIS se LIRË dhe te LIRIS, ndonse ne nje shkalle me te kufizuar.

Tue i lene per me tutje komentet mbi qendrimin e kesaj organizate te dores se dyte te Shqiptareve t' Amerikes, del perpara vetvetiu pyetja se c' e beri DIELLIN te deklaroje here pas here se guverna e Enver Hoxhes duhet perkrahur 100 per 100, dhe pa asnje rezerve ose kritike? Kete politike vashdoi DIELLI edhe pas deklarimit te guvernes se Tiranes si nje diktature komuniste. Ne fakt ishte organi i VATRËS ay qe botoi nje biografi te gjate t' Enver Hoxhes, te derguar nga Tirana, ku provohet se Hoxha ishte Komunist edhe ne kohen kur studionte n' Europe me burse te qeveris se Zogut.

Dhe ironia, pak si e trashe dhe e pagelltiteshme, e



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

qendrimin që mori **DIELLI** qysh në formimin e qeverisjes së Komitetit Nacional është që, kurse organi i **VATRES** e vu guvernën e Hoxhës përmbi dhe përtej çdo kritike, editori i saj **Panariti** e ketheu tërë mjeshterin e tij kritikonjëse kundër qeverisë amerikane. Në fakt, **Panariti** nuk i ka kursyer kritikën e tij as kundrejt Presidentit të Shteteve të Bashkuar të cilin e ka akuzuar herë pas herë se është tërë grabitur dhe marrë nëpër kembë të drejtat dhe lirin e popullit amerikan. Si munt të mbahet mend, **Panariti** vajti aq larg sa të deklarohet në favor të Progressistit Henry A. Wallace në zgjedhjet presidenciale të vitit 1948 dhe të keshillojë Shqiptarët të votojnë për atë kandidat të cilin të dy partit kryesore, Demokratë dhe Republikanë, e akuzonin se ishte bërë vegjë e padashur e partis komuniste të Amerikës. Këtë e kuptoi më vonë edhe vetë Henry A. Wallace kur u-hoq krejt nga Partia Progressiste pas nderhijrjes së Shteteve dhe Kombeve të Bashkuar në luftën e Korës, dhe që atëherë e ka mbyllur gojën. Por jo **Panariti**, i cili është tërë vashduar atakimet e tij kundër Presidentit Truman dhe qeverisë së tij.

Në lidhje me këtë qëndrim të **DIELLIT** vlen të përmenden fjalët e një zyrtari të natës amerikan, i cili më tha një ditë:

“Aq na ben nëse **DIELLI**—ose edhe **LIRIA**—përkrahin tërësisht qeverinë e Hoxhës. Ajo që na duket krejt pa vend (utterly absurd) është që asnjëra as tjetra gazete nuk ka gjetur rastin që të thotë një fjale të mirë për Amerikën rreth konfliktit të një me Rusin Sovietike.”

Për të vertet, ky është një nga misteret e thellë të



TRASHËGIMET HISTORIKE TE VATRES

rruges qe ndjek VATRA dhe DIELLI, rruge q' as vete zyrtaret pergjigjes nuk dine se ku do t' i shpjere ato dy instituta me te moçme te ngrehura prej Shqiptareve t' Amerikes. Sepse, si munt te shpiegohet qe DIELLI te kritikoje ashperisht ne çdo numur te tij veprimet e qeveris amerikane dhe te mos hape gojen per t' i gjetur nonje te mete diktatures komuniste te Shqiperis? Dhe kejo ngjet kur 95 per 100 e anetareve te VATRES jane qytetare amerikane.

Ne gjuhen kishetare t' Imzot Nolit, kejo esht nje shituatë e shtangeshme dhe e mahniteshme.

NJE NGA SHPIEGIMET munt te gjendet, ndofta, ne faktin qe VATRA esht akoma nen influencen e dy trashegimeve qe kundreshtojen njeri-jatrin: trashëgimi demokratik dhe trashëgimi autokratik.

Nen te parin, qe vashdoi qysh nga fillimi i saj edhe gjer me 1925, Federata u-rrit, u-madhua dhe u-lulezua sa qe t' arrije numurin e 5000 anetareve. Nen te dytin u-prapesua, u-zvogelua dhe u-fik sa te mos i mbeten me teper se 500 anetare.

Ne driten e shvillimit te saj historik, krimbi i vdirjes hyri dhe zu vend ne trupin e VATRES me ardhjen e Faik Konitzes ne kryesin e saj.

Tue gene autokrat prej temperamenti dhe jo aq prej gjaku—vellezerit e tij ne Shqiperi ishin shembella sjelljeje demokratike—Beu i Konitzes suprimoi shtyllen kryesore te systemit demokratik, o p o z i t e n. Kejo ngjau kur me 1925 me vendim te vete, per arsye te veta dhe pa marre parasysh deshiren e shumices s' anetareve, e lidhi fatin e Federates me ate te Zogut, te "malokut gjenial" siç e quajti n' ate rast,



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

te cilin e kishte leftuar dhe feliqur gjer ahere ne menyren e njohur faikiane. Kur, pra, dualle kundreshtime nga deget e ndryshme, Faik Beu mori kalemin e kuq ne dore dhe i fshiu nje-nga-nje nga radhoi i Federates. Qysh ahere, dhe per 15 vjet me radhe, DIELLI u-be nje organ publiciteti i regjimit te Zogut, me Faik Konitzen si Minister ne Washington.

Dhe ne Prill, 1939, kur Mussolini ia dha kepuçet ne dore Zogut, DIELLI u-kethye si pa te keq ne favor te mbretit te ri te Shqiperis, Viktor Emanuel t' Italis, se ashtu urdheroi Beu. Me doren e vete te Faik Konitzes DIELLI denoi si trathetor djaloshin Dardhar, Vasil Latsin, sepse qelloi me revole Madheshtin e tij shkurtabike Viktorin e Italis.

Kur, perseri, u-formua SHQIPËRIA e LIRË me program qe te leftoje pretendimet e Zogut, DIELLI, i frymezuar kete here nga ortakeria e re Konitza-Noli, ngriti prape flamurin e Zogut tue deklaruar se "nuk behet Shqiperi pa Zogun".

Per te tretien here brenda ne tre vjet, DIELLI naltesoit tre regjime per t' i flakur njerin pas tjetrit ne gjirizin nga i cili i kishte futur dhe nxjerre.

Federata e hodhi menjane Zogun ne mergim si kepuçe te vjeter me gojen e Peshkopit, kryetarit te saj te nderit, ne nje mbledhje historike q' u-mbajt me 23 te Qershorit 1944 ne Hotel Statler te Boston'it. Ne kete mbledhje merrnin pjese: nje delegacion zyrtarësh amerikane t' ardhur nga Washington'i, Imzot Noli, kryezyrtaret e SHQIPËRIS se LIRË, Dr. Nicholas Prift dhe S. Theodore Kotelly nga Detroit. Misioni i delegacionit amerikan ishte: te deklaroje zyrtarisht se çdo bisedim



TRASHËGIMET HISTORIKE TË VATRËS

per te njohur Zogun edhe nje here si "mbret" duhej lene krejt menjane.

Ate deklarate e kundreshtoi Peshkopi me argumentin se "po te heqim dore nga Zogu, ahere heqim dore edhe nga kufiret e Shqiperis", dhe ne nje çast bisedimi te nxehte, Peshkopi u-ngrit t' ikte ne shenje protestimi.

Por, n' ate çast nje nga zyrtaret amerikane shpalli lajmin se ne Shqiperi ishte formuar nje qeveri e re nen kryesin e Enver Hoxhes. (Kete infomate m' a kishin dhene zyrtaret amerikane dy dit me pare ne forme konfidenciale).

Peshkopit iu çel fytyra me nje here dhe sikur t' a kishte pergjigjien ne maje te gjuhes tha, pa u-menduar fare:

"Ahere ne heqim dore nga Zogu per te perkrahur qeverin e re."

"Jo," tha zyrtari amerikan, "nuk do t' a perkrahni sepse, mbas informatave t' ona, ajo duket si nje qeveri pro-komuniste, nemos komuniste."

"Pa ç' ka," u-hoth Peshkopi perseri, "ata jane djemt t' ane (they are our boys)". Dhe keshtu, brenda nje minute, Zogu u-flak menjane ne favor t' Enver Hoxhes. Por s' ka asnje dyshim se zyrtaret amerikane muarre shenim mbi deklaraten e Peshkopit; dhe ndofta ne bazen e ati shenimi Hiresia e tij arrijti te perfillej si pro-Komunist.

ME GJITH ATE, mundet q' ay incident te mos kishte nonje pasoje, sikur akuzimi si Komunist (dhe jo si pro-Komunist) te mos i ishte bere Peshkopit nja dhjete



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

vjet më parë prej anës së një zyrtari të natës të qeverisë së Zogut.

Aj zyrtar i natës nuk ishte tjetër veçse shoku dhe mik i vjetër i Peshkopit, Ministri i Shqipërisë në Washington: Faik Konitza. Si munt të mbahet mend, kur u-kethye nga Europa në Amerikë më 1930, Peshkopi u-mbajt në Ellis Island. Aresya e atë ndalimi ishte kallzimi që bëri pranë qeverisë amerikane Faik Konitza se Peshkopi ishte Komunist, ndofta sepse Hiresia e Tij kishte kaluar një kohë të gjatë në Moskë ku ishte, siç thuhet, në kontakt të ngushtë me zyrtarët e Kominternit (Communist International, organizata Komuniste Nderkombëtare).

Por edhe kallzimet të Faik Konitzës, të cilin autoritetet e emigracionit nuk e muarë parasysh, ndofta nuk do t' i mbetë asnjë rëndësi, sikur **DIELLI**, organi i Federatës së të cilës Peshkopi ka qenë vjetë më radhe si kryetar nderi dhe mendor i afër, të mos kishte marrë qendrimit e perkrahjes 100 për 100 dhe moskritikimit të regjimit të Enver Hoxhës.

Qendrimit e heshtjes së plotë e mbajti **DIELLI** jo vetëm kundrejt veprimeve të qeverisë së Enver Hoxhës që i perkisnin jetës dhe së pritmes së Shqipërisë, por e vashdoi edhe në kohën kur Tirana i shpalli luftën më të eger propagandistike Amerikës.

Siç u-shënuar në Kapitullin I, **DIELLI** nuk nxori asnjë zë për kur guvernatori Hoxhës ua hoqi qytetësin amerikane atyre Shqiptarëve të Amerikës që mbeten në Shqipëri nga shkak i luftës por që ishin bërë qytetarë të Shteteve të Bashkuar prej një kohe të gjatë, regullisht, dhe me dëshirën e tyre të lire.

Po ashtu, organi i **VATRES** nuk nxori asnjë pipetim



TRASHËGIMET HISTORIKE TË VATRËS

kur guvernata e Tiranës refuzoi të njohë traktatet e vjetra midis Shqipërisë dhe Amerikës, kurse gjithë Shtetet e tjera i kishin pranuar si kondite të njohjes së tyre nga Amerika. Në këtë rast DIELLI dinte, ose duhej të dinte, që ishte Jugosllavia ajo që e keshilloi Enver Hoxhën të mos pranojë traktatet e vjetra—që ajo vete i kishte pranuar—me qëllim që t'ia izolonte krejt Shqipërinë për t'ia lënë në meshirë të Belgradit.

Nga ana tjetër, një keshillë e urtë e dhënë në këto dy raste qeverisë së Tiranës nga ana e një burri Shteti të moshës dhe të provuar, si Peshkopi, ndofta do t'ia kishte ndaluar ato dy fatkeqësi që e bënte të pamundshme njohjen e qeverisë së Tiranës nga ana e Shteteve të Bashkuara dhe pranimit të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara.

Përsëri, VATRA e kishte për detyrë që të kërkonte shpjegime nga guvernata e Tiranës rreth komplotit që gjoja kishte përgatitur në Shqipëri ish-Drejtori i Shkolles Teknike të Tiranës, Prof. Harry T. Fultz. Peshkopi duhej t'ia dinte se Profesori Fultz, një edukator i thjeshtë dhe pa asnjë zotësi ose pretendencë politike, s'është t'ia hynte kurrë një intrige të tillë. Veç asaj, t'ia akuzuar si komplotist një pjesëtar të misionit diplomatik amerikan në Shqipëri—dhe Prof. Fultz ishte pjesëtar i atij misioni—kërkoi komuniste të Enxer Hoxhës kishte për qëllim të diskreditonte qeverinë amerikane. Po ashtu VATRA dhe DIELLI duhet të kishin kuptuar se të veteqojturin komplot e ngrehu vete guvernata e Hoxhës për të ndezur popullin shqiptar kundër Amerikës.

Heshtja në raste të këtyre nuk është neutralitet ose



PLANI I TRETË I ÇOPTIMIT TE SHQIPERIS

paanesi, siç duan te thone disa; perkundrazi esht pel-qim dhe aprovim i plotte.

Po ashtu ne rastin e minave q' u-mbolle ne Kanal in e Korfuzit dhe shkaktuan mbytjen e dy luftanieve inglize ne Tetor 1947, DIELLI duhet te kishte botuar nje fakt te vetem: qe mbjellja e minave esht nje pune teknike mjaft e komplikuar dhe qeveris se Tiranes i mungojen tekniket sa edhe mietet per nje vepre te tille. Sepse e verteta esht qe minat u-mbollen prej teknikesh jugoslave, perseri me qellim qe te pritej filli i fundit i shpreses se njohjes se Shqiperis nga ana e Anglis. Mirpo, po te botonte nje gje te tille, DIELLI do t' aku-zonte mikun dhe mbrojtesin e Enver Hoxhes n' ate kohe: Mareshal Titon. Natyrisht, mbjellja e minave u-be me dijeni dhe leje te guvernes se Tiranes te ciles nuk i shkoi nga mendja, siç duket, se do t' a paguante shtrenjt ate aventure te paligjeshme per te cilen Shqiperia u-denua prej Gjykates Nderkombetare te Hages t' i paguaje Anglis afro \$2,500,000.

Ne rasjen e zbimit te misionit diplomatik amerikan nga Shqiperia—Departmenti i Shtetit thote se e hoqi vete ate mision, kurse ata te Tiranes mburren se e zbuane—VATRA, tue vepruar me ane te Peshkopit, e kishte per detyre te keshillonte guvernen e Tiranes te mos merrte nje mase te tille nga e cila do te perfitonte vetem Jugoslavia, mbassi qeveria e Belgradit ishte ajo qe po mundohej t' a bente te pamundeshem çdo afrim midis Shqiperis dhe Amerikes.

Le t' a mbyllim kete liste te mungimeve ne detyre me çeshtjen e 17 krereve me te njohur te regjimeve te kaluar q' u-denuan me vdekje ne Prill 1946. Midis



TRASHCGIMET HISTORIKE TE VATRES

ketyre ishin: Kol Tromara, ish-kryetar i VATRES; Bahri Omari, ish-editor i DIELLIT, dhe Aqif Permeti, ish-komandant i vulnetareve q' organizoi dhe dergoi ne Shqiperi me 1920 Federata e gjalle dhe e shkelqyer e asaj kohe. Porsa mora lajmin e denimit te tyre—dhe n' ate kohe kisha prere qdo lidhje me SHQIPERIN E LIRE—vajta pastafat ne New York, thirra dy nga Vatrane, z. z. Qemal Veisel dhe Shefqet Benca. Atyre u thashe qe t' i luten Peshkopit te nderhyje per shpetimin nga vdekja e atyre tre Vatraneve te shenuar qe kishin qene edhe shoke te Peshkopit. Pergjigjia qe me prune nga ana e Imzot Nolit ishte se "Peshkopi s' munt te prishej me guvernin e Tiranës per tre politikane te falimentuar."

DIKUSH do te thote ne kete pike se q' vlefte do te munt te kishte nderhyrja e VATRES, ose e Peshkopit, ne sicilin prej rasteve te radhitur me siper, kurse ata te Tiranës kishin vendosur te kryejen programin e tyre pa marre parasysht protestimet, nga qdo ane qe t' u vinin.

Nuk esht ashtu aspak. Fakti esht qe tue mos degjuar asnje ze protestimi nga ana e dy organizatave t' Amerikes, atyre te Tiranës u mbush mendja se GJITH Shqiptaret e Amerikes aprovin me brohori veprimet e tyre. Ajo qe nuk duhet harruar ne ket pike esht se propaganda e Moskes dhe e Jugoslavis, (para se Mareshali Tito te prishej me Mosken) u tingellonte vashdimisht ne vesh atyre te Tiranës se populli amerikan pergjithesisht esht kunder politikës anti-komuniste te Presidentit Truman, qeveria e te cilit u mbajtka ne fuqi vetem me perkrahjen e reaksionareve



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

imperialiste dhe lufte-farkonjesve (warmongers) të Wall Street'it. Ky është një tip propagande që qarkullohet ditë mbas ditë, në formë të ndryshme, nga gazetatat, radiot dhe deklaratat e udhëheqësve të Komunistit Internacional. Kur, pra, ata të Tiranës panë se veprimet e tyre gjenin një përkrahje "100 për 100" nga ana e DIELLIT dhe e LIRIS, arritën të besojnë se puna ishte, me të vertet, ashtu siç e paraqitte propaganda e qendres komuniste; ndryshe, thoshin në mendjen e tyre, si do të kishte kuxim minoriteti i vogël shqiptar i Amerikës t' i japë një përkrahje aq të hapet guvernës së Tiranës. Mbasi ata vetë nuk lejojnë asnjë demonstratë të kundërtë në vendin që sundojnë, nuk u ka shkuar nga mendja se ka vende të lire, si Amerika, ku çdo minoritet, dhe çdo qytetar fill i vetëm, ka të drejtë të ngrihet dhe të protestojë me terma të rrepta kundër veprimeve të qeverisë së vendit.

Tue i mbështetur mendimet e tyre mbi këto baza të rrema, ata të Tiranës iu këthyen popullit shqiptar për t' i thënë me anë të radios dhe të shtypit të tyre të palire; "Pa shekoni pak! Edhe Shqiptaret e Amerikës janë me një 100 për 100!" Për të vertet, këto ishte mënyra më efektive për të mbyllur gojën e popullit shqiptar që ka qenë tradicionalisht pro-Amerikan.

Ky, pra, është demoralizimi, aq tragjikisht i math, që i bëjnë Shqipërisë dhe popullit të saj—munt të thuhet edhe regjimit të Enver Hoxhës—VATRA dhe SHQIPËRIA E LIRË tue mos nxjerre asnjë zë protestimi kundër gabimeve dhe veprimeve të paudhë të guvernës



TRASHËGIMET HISTORIKE TË VATRËS

se Tiranes. Per te vertet, ky munt te jete nje nga shkaket kryesore q' ajo qeveri mbeti pa u-njohur nga Amerika dhe Shqiperia pa u-pranuar ne Kombet e Bashkuar. Ishte detyra e te dy organizatave shqiptaro-amerikane qe t' u tregonin urtesisht se si munt te fitohej njohja e Amerikes dhe pranimi i Shqiperis ne U. N. dhe jo te perpjekin duart si me u thene atyre te Tiranes: "E kini mire, djem! Vashdoni ne rrugen qe kini marre!" Sepse s' duhet harruar se diktaturave u duhet mbajtur dora dhe, mbassi popullit shqiptar i esht mbyllur krejt goja, u binte Shqiptareve t' Amerikes detyra t' i thoshin Hoxhes: "Ndal-u pak, se-paku sepse do te na vesh. gjith ne t' Amerikes, ne poziten me te keqe!"

MBI KËTË PIKË, e vlen qe te sjell perpara dy shembella konkrete. Ne Maj 1928, kur po beheshin pre-gatitjet per te shpallur monarkin dhe, per ate arsye, duhej terrorizuar populli q' ashtu te mos kishte askush kuxim per te protestuar kunder hipjes se "Malokut te Matit" ne fronin e Skenderbeut, u-arrestuan ne Tirane dhe u-derguan perpara Gjyqit Politik katre njers t' akuzuar si komplotiste per te vrare Zogun: Anastas Pandeli, ish-kryetar i VATRËS, dy Bullgare dhe nje Shqiptar tjeter. Si drejtor i gazetes "TELEGRAF" t' asaj kohe botova nje kryeartikull rreth arrestimit t' Anastas Pandelit, per te deklaruar me force se nje ish-kryetar i Federates se madhe t' Amerikes nuk munt t' ishte komplotist dhe se do t' ishte nje njolle per regjimin te denoje ish-kryetarin e nje organizate q' i kishte sjelle aq sherbime te çquara çeshtjes kombetare.

Te dy Bullgaret dhe ay Shqiptari tjeter u-gjykuan



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

shpejt-e-shpejt, u-denuan me vdekje pa nonje prove bindese te fajesis se tyre, dhe u-eksekutuan tue u-vene ne litar ne sheshin perpara Parlamentit, per t' u permendur pjesetareve t' ati trupi se ç' fat i priste po te çelnin gojen kunder shpalljes se monarkis. Anastas Pandeli u-lirua, pa shkuar neper gjyq, me kondite qe te largohej nga Shqiperia. Legata amerikane i dha nje viza dhe e percolli per n' Amerike. Me t' arrijtur ne Boston, Pandeli u-mburr—ndofta per t' i dhene rendesi vetes—se edhe ay ishte aq fajtor sa edhe ata q' u-eksekutuan. Disa muaj mé von, nje nga pjesetarët e Gjqit Politik, i tmershmi Shefqet Bej Frasheri, me tha tue ckermitur dhembet: “Na e rrembeve nga duart ate trathetor. Ne e kishim denuar me vdekje para se te fillonte gjyqi.”

Pak kohe pas “Gjqit te Bullgareve” u-arrestuan po per ate aresye dy patriote te njohur: Ismail Haki Deveja dhe Hysen Nikolica, tue u-akuzuar se kishin ngrehur nje tjeter komplot per te vrare Zogun kur ky te vizitonte Korçen! . . . Akuza ishte sheshazi qesharake, mbassi nuk eksistonte nonje plan vizite te Zogut ne Korçe. Kete ia thashe Ministrit te Brendshem t' asaj kohe, Koço Kottes, i cili me tha me fytyre t' egersuar: “Nese eksiston ose jo nonje plan i tille ate e di une, dhe une e kam per detyre qe t' i varr ata te dy. A merr vesh, do t' i varr!”

Ato dit ndodheshin ne Tirane dy nga njerzit me te shenuar te Shqiperis: Lef Nosi i Elbasanit, ish-pjesetar i Keshillit te Nalte te vendosur prej Kuvendit te Lushnjes, dhe Fazli Frasheri, nje nga bejleret mé liberale dhe mé demokrate te vendit. Ketyre te dyve u kallzova se ç' me tha Koco Kotta. Pas nje bisedimi



ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ
ΕΛΛΗΝΙΚΟΥ ΚΟΥΡΙΑΑ

TRASHËGIMET HISTORIKE TË VATRES

te gjate, u-vendos qe Fazliu te vizitonte Zogun si edhe kryekeshiltarin e tij Abdurahman Krosin per te mesuar nese ishte caktuar fati i dy t' arrestuarve para se te dergoheshin ne gjyq. Pergjigjia qe me pruri Fazliu ishte se nuk ishte marre akoma nonje vendim i tille.

Mbi kete, une e mora parasysh perseri te botonj ne gazeten "TELEGRAF" nje korrespondence qe dukej sikur kishte ardhur nga Korça. N' ate thuhej se ne dokumentat e zena prej Prefektures se Korçes nuk gjendeshin prova te mjafta per te derguar ne gjyq dy veterane patriote si Ismail Haki Deveja dhe Hysen Nikolica. Dy dit më von te dy t' arrestuarit u-liruan pa u-derguar ne gjyq, por kur u-takova perseri me Koço Kotten ky me foli më eger se heren e pare: "Kete do t' a paguash ti. . . Do te shohesh se q' ka per te ngjare! . . ."

Tre-mbe-dhjete dit pas shpalljes se monarkis, u-arrestova me urdher te Koço Kottes si kundreshtar i regjimit dhe u-denova me nje vit burgim prej Gjyqit Politik. Me nderhyrjen e Legates Amerikane u-lirova pas 28 dit burgimi. Por gazeta "TELEGRAF" u-pushua per gjithmone.

Nga pjesetaret e drames se nalt-pershkruar, Lef Nosin dhe Fazli Frasherin i eksekutoi guverna e Hoxhes, dhe Koço Kotta vdiq ne burgun e Tiranës i cili, per ironi te fatit, u-ngreh prej vete Kottes kur ky ishte Minister i Puneve Botore.

Sido qofte, nga keto dy shembella konkrete te dobis se kritikave nga ana e shtypit, kritika te shprehura per hir te drejtesis, duket sheshazi se sa fuqi kane protestimet kur behen me urtesi dhe aresye. Valle sa më teper fuqi do te kishin kritikate dhe protestimet



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

kundrejt guvernës s' Enver Hoxhës sikur të beheshin nga të dy organet e Shqiptarëve t' Amerikës dhe, veçanërisht, nga ana e një burri Shteti dhe kryefetari si Peshkop Noli!

POR, sikur të mos mjaftonte heshtja kur e kishte për detyrë morale që të fliste, fatkeqesisht Peshkopi u dha vetë rast autoriteteve amerikane që t' a konsiderojnë si Komunist. Prova e çilte për këtë gjendet në *Congressional Record*.

Në dy numura të kësaj gazete zyrtare të Kongresit të Shteteve të Bashkuar, me datë 31 Korrik dhe 1 Gusht 1951, Kongresmani Harold H. Velde i Shtetit Illinois botoi një raport të përgatitur prej Dr. Glenn A. McLain, 45 Chase Street, Quincy, Mass. N' atë raport **DIELLI** përmendet si një gazete jo veten pro-komuniste, por edhe egërsisht anti-amerikane, dhe Peshkop Noli akuzohet se përdor Kishën shqiptare "për të denoncuar Amerikën, formën e qeverimit të saj, zyrtarët e saj dhe politikën e saj të jashtme."

Po ashtu, në një vend të dukur të raportit botohet tekstualisht telegrami që Peshkopi i drejtoi synodhit të Shqipërisë rreth pranimit të Kishës Ortodhokse t' Amerikës në gjirin e Kishës së Shqipërisë.

Raporti i Dr. Glenn A. McLain është shkrojtur mjaft keq dhe plot gabime, por akuzat që bën janë të qarta dhe të shkruara. Ajo që çëllon i jepet më shumë rëndësi është hyrja e Kishës Ortodhokse t' Amerikës në Kishën e Shqipërisë të cilën guverna e Tiranës e riorganizoi në mënyrë që të pajtohet me programin dhe dogmat e Komunizmit.

Për të vertet, kejo punë e Kishës është një problem i math dhe i rëndësishëm që prek interesat me të gjalla



TRASHËGIMET HISTORIKE TË VATRËS

te Shqiptareve t' Amerikes. Sepse, po te jete se autoritetet amerikane te marrin nonje mase ne baze te raportit te Dr. McLain dhe te perkrahesit te tij, Kongresmanit Velde, Peshkopata e Amerikes qe drejtohet prej Peshkop Nolit do te konsiderohet si nje organizate fetare komuniste, ne menyre qe gjith besniket e saj te perfillen si Komuniste. Dhe ironia e madhe esht qe ne programin e tyre themelor, Komunistet, si atheiste qe jane, kane per qellim te çdukin çdo organizate fetare, mbassi vete profeti i math i tyre Nikolai Lenin e ka theksuar se "feja esht afjoni i popullit". Qe nuk i çdukin fete me-nje-here, ate e bejen vetem per arsye oportuniteti, mbassi nuk e ndjejen veten e tyre sot per sot aq te forte sa te shkulin nje institute shekullore si feja. Perndryshe, nuk do te kishin lene as kembe prifti, hoxhe ose hahami. Kejo esht tue u-provuar ne Shqiperi me Kishen Katolike. Mbassi ay sekt esht me i vogli, por edhe me i gjalle dhe i organizuar me mire se te tjeret, guverna e Tiranes e ka paralizuar krejt tue ekzekutuar nje pjese dhe tue burgosur pjesen tjeter te klerit katolik.

Q' autoritetet amerikane jane tue marre masa kundrejt Peshkopates se Nolit, prova gjendet n' ardhjen n' Amerike te Peshkopit te ri, Mark Lipes. Esht afermentsh qe pa vizen dhe pa pelqimin e autoriteteve te Shteteve te Bashkuar, Peshkop Lipa nuk do te kishte rast te vinte n' Amerike per te kryesuar nje peshkopate qe nuk eksistonte. Nje prove tjeter esht se ne raportin e Dr. McLain çeshtjes s' Imzot Lipes i jepet nje vend mjaft i gjere dhe nje perkrahje e plote.

Qe Peshkop Lipa u-dergua prej Patrikanes se Stambollit per te perçare Shqiptaret e Amerikes, ay esht nje



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

argument i mire per t' a leftuar, por mjaft i çale per t' i dale ne krye asaj lufte. Sepse, nga ç' ane tjetër munt te vinte nje peshkop i ri veçse nga Patrikana e cila, per mé keq dhe jo per mé mire, vashdon te jete krye dhe burimi spiritual i gjith kishave orthodoxkse. Ay qe do te ngrihet te thote 'perse te mos vije nga Shqiperia' harron qe ne flasim per kohen e tashme kur marrëdhëniet midis Shqiperis dhe Amerikes jane krejt te prera. Nga ana tjetër, kur te plotesohet jeta mbi dhé e Peshkop Nolit, nga pritet te vije zevendesi i tij? Simbas ligjit kanonik, duhen dy peshkope per te dorëzuar nje te trete; ku do te gjenden ata dy peshkope ketu n' Amerike? Veç asaj, ne tere gjerësin dhe gjatësin e Shteteve te Bashkuar nuk gjendet asnje kandidat shqiptar qe te kete gjith cilsit e duhura per peshkop.

Sa per ata qe kerkuan nga Patrikana te dergoje Imzot Lipen, dhe te cilet DIELLI i ka denoncuar padrejtesisht si Epirote dhe andarte, e verteta esht q' ata vepruan n' ate menyre kryesisht per te larguar nga vetja e tyre dyshimin se jane pro-Komuniste. Esht nje fatkeqesi e madhe kejo, por gje qe nuk munt te mohohet se e tere bota esht e ndare sot me-dysh: ne Komuniste dhe anti-Komuniste.

Veç asaj, ata qe ftuan Peshkop Lipen te vije n' Amerike ishin çkeputur nga Peshkopata e Nolit prej nje kohe te gjate. N' esht se atyre u mbush mendja te sjellin nje peshkop te dyte dhe te ngrehin nje peshkopate te re, ajo esht barra dhe pergjigjesia e tyre.

Ndaj e mramja, e vetema gje qe mbetet ne dyshim esht nese Imzot Lipa do te veproje si agjent perçares i Patrikanes apo thjesht si klerik shqiptar. Qe Patri-



METAMORFOZA E SHQIPËRIS SË LIRË

kana, nga e cila s' i ka ardhur Shqipëris nonje e mire gjer sot e kesaj dite, e priti me gezim rastin qe te fute ne zjar komunitetin shqiptar t' Amerikes, ate s' munt t' a mohoje askush. Por, nga ana tjeter, s' munt te mohohet, po ashtu, se vete Peshkop Noli i çeli shtegun Athinagores se Stambollit, tue mbajtur larg nga Peshkopata e tij nje pjese te klerit dhe te komunitetit orthodox, dhe tue vene Kishen e Amerikes nen jurisdiksonin fetar te Kishes komuniste te Pashko Vodices. Dhe, tue qene se, nga sa u-tha me siper, dihet njetash nga anojen simpathit e autoriteteve amerikane, perçarja q' u-mbuall ne mes te Shqiptareve t' Amerikes munt te kete pasoja te papareshekueshme per gjith çeshtjen shqiptare.

Esht nje situatë per t' ardhur fort keq, nje situatë qe po mahiset teper e më teper dita ditën nga polemikat e ashpra, te vrazheta dhe te pamejtuara.

KAPTINE VIII

Metamorfoza e SHQIPËRIS SË LIRË

NGA GJITH sa u-thane ne kaptinen e pareshkuar, nje pjese e madhe e mungimeve ne detyren morale te VATRES kundrejt guvernes s' Enver Hoxhes i aplikohet edhe SHQIPËRIS SË LIRË, ndonse ne nje mase te kufizuar. Kufizimi rrjeth nga qe, pas largimit t' im nga kejo organizate q' u-formua me nisjativen t' ime, zyrtaret qe muarren persiper administraten e saj nuk kishin aftesin dhe eksperiencen e atyre te Federates. S' munt te behej, per shembell, asnje krahasim midis eksperiencës, ne fushen politike, t' Imzot



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

Nolit dhe të Dr. John T. Nasse. Nga këta të dy, i pari ishte ish-Kryeminister i Shqipërisë dhe i rrahur, siç thote fjala popullore, me vaj e uthull në çdo fazë të çështjes shqiptare, kurse i dyti ishte një mjek i mbaruar në degën e tij por që s' mund të kishte veçse një ide të muget mbi shvillimet e nderkoheshme të çështjes shqiptare. Veç asaj, profesioni dhe klientela e tij e gjere si pediatër i çmuar dhe popullor nuk i linte kohë që të merrej me administrimin e organizatës.

Nga ana tjetër, Dr. Nasse ishte një nga të rinjtë idealiste të gatitur për çdo sakrificë, por që nuk ishin në pozite të vleftesonin sakrificat e tyre pa një udhëheqje eksperte.

Po-thua-se t' asaj kategorie ishte shumica e madhe e anetareve të SHQIPËRISË SË LIRË, idealiste të rinj e të mëçem që ishin hequr nga Federata qysh në kohën e administratës autokratike të Faik Konitzes. Prej natyrës së tyre, këta ishin liberale demokrate, opozitare të regjimit zogist që mbronte Beu i Konitzes në atë kohë, armiq të papajtuarshëm të kurverimit të Shqipërisë në duart e Italisë Fasciste dhe kundreshtarë të repte të rinjohjes së Zogut si "mbret" në mërgim.

Nga një brumë e tillë, e gjallë dhe e shëndetëshme, mund të pritëshin vepra të mrekullëshme. Ato vepra nuk mundin të realizohen qysh në fillim të formimit të organizatës së re. Mund të thuhet, pa frikë përgenjshtrimi, se kejo organizatë liberale demokratike fitoi simpatinë, miredashjen dhe përkrahjen e qeverisë amerikane me urren e saj të parë. Në fakt, SHQIPËRIA E LIRË s' kishte mbushur asnjë javë të ekzistencës së saj formale (29 Dhjetor, 1941) kur Departamenti i Shtetit deklaroi në një buletin të po-



METAMORFOZA E SHQIPËRIS SË LIRË

saçem, me date 4 Jenar 1942, se Shqipëria do të pranohej si pjesëtare e Kombeve të Bashkuar në një shkallë me Danemarken me anë të një "organizate të pershtateshme"—në mungesë të një qeverie në mërgim. (Shih *The New York Times* me të njëjtën datë). Buletini në fjalë u-leshua pas një takimi t' im të mëparshëm me zyrtarët e Departmentit të Shtetit të cilet e kishin aprovuar formimin e një organizate si SHQIPËRIA E LIRË që në Nëntor 1941 "për të mos lene Shqipërinë pa përfaqësim" në Shtetet e Bashkuar:

Sikunder dihet, ajo njohje zyrtare e Shqipërisë nuk u-realizua për dy arsye:

1) Që Zogu, me të mesuar se ç' po gatitej në Washington, vrapoi të kerkojë pranimin e Shqipërisë në Kombe të Bashkuar në emrin e tij si "sovrani" i Shqipërisë.

2) Që Peshkop Noli dhe Faik Konitza vrapuan, nga ana e tyre, të pajtohen në mes të tyre të bashkuar me Zogun, vetëm e vetëm për të prerë kryshin e SHQIPËRIS SË LIRË.

Se në ç' baza të çuditëshme u-formua ajo ortakëria Noli-Konitza provohet për bukuri nga paragrafi i postem, i nxjerre nga një letër që i shkroi Faik Konitza një mikut të tij në Londër. Ky paragraf u-botua bashkë me një intervistë dhe fotografi të Faikut, në të përjavëshmen "Time" të New York'ut me datë 18 Maj, 1942. (Fjalet në parentheze janë shpjegime t' autorit të këtij libri):

Ju e dini mendimin t' im rreth pompozitetit të paqëndrueshëm të Zogut dhe t' epshimit të tij ndaj tradhësisë. Zogu më është dukur si një trazyre kurioze e dy karakteresh Shakesperiane: Dogberry (palaço) dhe Jago (tradhësor). Por Peshkop Noli të



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

cilin e vizitova tash se fundi ne Boston, mundi te m' a heqe dyshimin. Noli beson se Zogu munt te kete marre mjaft mesime ne shkollen e fatkeqesis dhe, po te jete se ka perkrahjen e qeveris inglize, munt te loze prape nje roll te rendesishem si simbol i independences se Shqiperis. Shume anetare te VATRES besojen se nje grup i formuar nga Peshkop Noli, Zogu dhe une do te munde te terheqe pelqimin e popullit.

Se ç' ngjau masandaj, ate e dine gjith Shqiptaret e Amerikes. Me gjith ate, SHQIPERIA E LIRE vashdoi te jete e vetema organizate qe gezonte besimin dhe perkrahjen e qeveris amerikane gjate kohes se vashdimit te luftes. Me anen e saj, Departmentit te Shtetit iu mbush mendja qe te beje deklaraten e 10 Dhjetorit 1942 me termat e te ciles iu be e njohur gjith botes se Shtetet e Bashkuar e njihnin perseri Shqiperin si Shtet independent. Ajo deklarate u-be shkak qe qeverit e Moskes dhe Londres te dalin e te bejen deklarata analoge. Po ashtu, Departmenti i Shtetit leshoi edhe deklaraten e dyte te 27 Nentorit 1944, ne te cilen lihej te nenkuptohet se Shqiperia ishte po-thua pjesetare e Kombeve te Bashkuar. Perse-treti, me anen e asaj u-derguan fshehtazi ne Shqiperi nje tog agjente Shqiptare dhe Shqiptaro-Amerikane per te hyre ne kontakt dhe per te ndihmuar çetat shqiptare q' u kishin hapur lufte Italianeve dhe me von Gjermaneve.

GJITH KETO jane te ditura e te njohura pergjithesisht. Ajo qe nuk dihet esht se kur dhe per ç' aresye ardhi prishja dhe largimi i im nga SHQIPERI E LIRE.



METAMORFOZA E SHQIPËRIS SË LIRË

Ne forme te permbledhur, konflikti i im me shoket e SHQIPËRIS SË LIRË vertitet rreth qeshtjes nese qeveria e Enver Hoxhes kishte mundesi te njihej nga ana e Shteteve te Bashkuar, ne formen qe kishte marrë ne Kongresin e Permetit. Ne kete pike, kendonjesit duhet te sjellin prape ne mendje deklaraten e zyrtarit amerikan ne mbledhjen e 23 Qershorit 1944 ne Hotel Statler te Boston'it: "Nuk do t' a perkrahi qeverin e Hoxhes sepse, simbas informatave t' ona, ajo duket si nje qeveri pro-komuniste, nemos komuniste". Asaj deklarate iu pergjegj Peshkop Noli me fjalet: "Pa ç' ka, ata jane djemt t' ane (they are our boys)".

S' duhet harruar, po ashtu, se ay bisedim mori vend ne kohen kur vashdonte lufta dhe qeveria amerikane gezonte te drejten te jepte urdhra t' asaj natyre.

Pa i dhene asnje rendesi ati paralajmerimi, **DIELLI** pasi e flaku Zogun, "pa te cilin nuk behej Shqiperia", u-hoth n' ekstremin tjeter me deklaraten se "guverna e Enver Hoxhes duhet perkrahur 100 per 100 pa rezerve dhe pa kritika". Me kete menyre, organi i Federates u-kethye perseri ne trashegimin autokratik te Faik Konitzes, me ndryshimin qe po te rronte n' ate kohe Beu aristokrat do t' i kapte per jake Nolin, Qerimin dhe gjith çeten e tyre dhe do t' i flakte jashte Federates, sepse askujt nuk munt t' i besohet qe Faik Konitza do t' i dilte perkrahes nje qeverie "te popullit".

Sido qofte, qendrimi ekstremist i **DIELLIT** pati jehonen e tij ne keshillet e SHQIPËRIS SË LIRË. Keshtu, ne nje mbledhje te perbashket te Komitetit dhe Keshillit t' asaj organizate q' u-mbajt ne Nentor 1944, shumica e pjesetareve u-deklarua ne favor te perkrahjes se qeveris s' Enver Hoxhes 100 per 100 pa rezerve



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPËRIS

dhe pa kritika. Aresyetimi per kete qendrim ishte se, mbassi VATRA mori me pare ate qendrim, SHQIPËRIA E LIRË do te binte poshte ne syt e qeveris se Tiranes dhe do te humbiste favorin e saj po te mos merrte nje qendrim si ate te Federates.

Keti aresyetimi, mjaft te çuditshem, iu pergjegjja me keto fjale:

“Per te lare suratin e saj te ndotur nga perkrahja q’ i kishte dhene Zogut gjer ne mbledhjen e 23 Qershorit ne Hotel Statler, VATRA, nje shoqeri autokratike dhe varangjeliste, e pa te nevojeshme qe te deklaroje 100 per 100 perkrahje per qeverin e Enver Hoxhes. Por, neve te SHQIPËRIS SE LIRË qe kemi leftuar çdo diktature, nuk ka hije qe te themi ‘amen’ per çdo veprim te qeveris se re te Shqiperis ne qofte se ajo merr forme diktature, qofte edhe diktature popullore. Tue qene esencialisht demokratike, organizata jone duhet te ruaje te drejten e kritikës kundrejt çdo veprimi te qeveris s’ Enver Hoxhes. Sa per argumentin se VATRA do te fitoje favorin e qeveris se re shqiptare ne dem t’ organizates s’ one, une po ju them se ay argument esht i çale, mbassi une jam i bindur, nga ekperieca ime e gjate ne fushen e politikës shqiptare, se po t’ a lavderojem qeverin per veprat e saj te mira dhe t’ a kritikojme per gabimet e saj, qeveria e re do te bindet per sinqeritetin t’ one dhe do t’ a shekoje me sy te shtrember VATREN per qendrimin e saj servil, qendrim te cilin Federata e ka mbajtur kundrejt gjith regjimeve te kohës se shkuar. Veç asaj, po te jete se ne te SHQIPËRIS SE LIRË nuk do t’ i tregojme qeveris se qysh munt te fitoje njohjen e saj nga ana e Amerikes, ne baze te kontakteve direkte qe kemi me



METAMORFOZA E SHQIPERIS SE LIRE

Departmentin e Shtetit, qeveria e re e Shqiperis qe nuk ka kontakte me boten e jashtme, do te bjere ne gabim pas gabimi."

Me gjith qe keto deklarata te mia nuk munguan te bejen neshtypjen e duhur ner pjestaret e mbledhjes se perbashket te Komitetit dhe Keshillit te SHQIPERIS SE LIRE, çeshtja nuk ardhi ne votim, tue pritur shvillime me te rishta.

Por, nderkohe, kur une po mundohesha ne Washington te gjenj nje formulle per njohjen e qeveris se re te Shqiperis, vura re se korrespondencat e mia nga kryeqyteti i Shteteve te Bashkuar nuk botoheshin ne LIRIN ose botoheshin me ndryshime.

Kejo me shtrengoi te kethehem ne Boston ne muajin e Shkurtit 1945 dhe te thres perseri nje mbledhje te perbashket te Komitetit dhe Keshillit t' Organizates. N' ate mbledhje, konflikti midis meje dhe shumices mori nje forme t' ashper e te shemtuar. N' ankimin t' im per mosbotimin e korrespondencave te mia nga Washington'i, kundreshtaret u-pergjegjen tue m' akuzuar se une isha shkaketai per mosnjohjen e qeveris se re te popullit, tue lene te nenkuptohet se une e kisha ne dore njohjen e saj nga ana e Shteteve te Bashkuar, porse e pengonja njohjen me ane te kritikave te mia, tue e cilesuar qeverin e re si Komuniste.

Pergjigjia ime ishte se nuk isha une ay q' e cilesonja qeverin e re si komuniste, por ishte qeveria amerikane e cila, ne baza t' informatave te saj, kishte arrijtur ne perfundimin se qeveria e formuar ne Permet ishte pro-sovietike dhe anti-amerikane. Prandaj, i thashe mbledhjes, esht nevojte e domosdoshme qe t' ia bejem te njohur qeveris se re pikepamjen t' one per t' i ka-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

llezuar se cilet jane pengimet te njohjes se saj nga ana e Amerikes.

Mbi kete pike bisedimet u-bene mjaft te nxehte dhe, tue mos pare rruge tjeter, kerkova nga mbeldhja qe te threse Kuvendin e organizates.

Kuvendi u-mbloth me 20 te Majit 1945. Ne fjalimin t' im me te cilin e qela mbledhjen, e paralajmerova Kuvendin se po te gjente nonje mungim ne perpjekjet e mia per njohjen e qeveris, une nuk do t' isha me kandidat per asnje ofiq t' organizates. Po ashtu, e paralajmerova se po te vendoste qe gazeta e organizates nuk do te kishte te drejte te kritikoje veprimet e qeveris se re, tue e qdukur ne kete menyre lirin e shtypit, une do t' a quanja veten jashte organizates.

Nga votimet e para q' u-bene mbi ceshtje te ndryshme u-duk sheshazi se kundreshtaret e kishin formuar shumicen para se te mblidhej Kuvendi. Me gjith ate qendrova ne mbledhjen gjer ne kohen e zgjedhjeve, kur dolla jashte per te mos u-kethyer me. Per kete, jam kritikuar ashperisht nga nje pjese e anetareve t' organizates si edhe nga nje tog miq amerikane, zyrtare ose jo, te cilet jane te mendjes se duhet te leftonja gjer ne fund, edhe gjer ne piken sa t' a perqanja dhe t' a paralizonja kuvendin. Pergjigjia ime kundrejt ketyre ka qene: si demokrat duhet t' i bindesha shumices, dhe porsa pashe se shumica ishte kunder meje, nuk me mbetej veqese te qendronja ne parimet e mia demokratike. Me ate menyre, desha te jap nje shembell demokratismi te vertete tue u lene fushe te lire kundreshtareve qe te shiguronin njohjen e qeveris se Tiranes me mietet dhe zotesin e tyre.

Pas largimit t' im nga mbledhja, Kuvendi permbysi



METAMORFOZA E SHQIPËRIS SË LIRË

dhe hodhi poshte vendimet themelore te Kongresit te 28-29 Dhjetorit 1941. Midis ketyre ishte edhe pika kryesore q' organizata do te bashkepunonte me qeverin e Amerikes per te miren e Shqiperis. Ne vend t' ati parimi, Kuvendi vendosi, ndonse indirekterisht, se SHQIPËRIA E LIRË do te ndiqte pasketaj politiken e Ruis Sovietike t' interpretuar nga qeveria e Enver Hoxhes te cilen Kuvendi e deklaroi te palajthiteshme dhe te pakritikueshme ne gjith veprimet e saj.

Kejo iste nje metamorfoze e plotte, nje ndryshim i krejte nga forma demokratike ne formen autokratike, si ajo e VATRES. Se ç' miresi i pruri kejo metamorfoze SHQIPËRIS SË LIRË, qeveris s' Enver Hoxhes dhe çeshtjes shqiptare pergjitherisht, ate e dine nje-tash gjith Shqiptaret e Amerikes. Fakti esht qe nje pjese e madhe e anetareve u-larguan pak me von nga organizata.

Sa per akuzen qe m' ishte bere se une e pengonja njohjen e qeveris se re nga ana e Shteteve te Bashkuar, po paraqit nje te vetem prove te kunderte:

Ne Shtator t' ati viti (1945) d. m. th. pese muaj pas largimit t' im nga SHQIPËRIA E LIRË, rastisa te ndodhem ne nje mbledhje ne zyren e Seksionit te Ballkanit te Departamentit te Shtetit, ne te cilen merrte pjese dhe Mr. Joseph E. Jacobs, kryetar i delegacionit zyrtar te qeveris amerikane ne Shqiperi.

Çeshtja e bisedimit ishte ne duhej njohur ose jo qeveria e Enver Hoxhes.

Mr. Jacobs dhe une ishim ne favor te njohjes, dhe kur nje zyrtar i Departmentit tha: "Si munt t' a njohim ate qeveri kurse esht komuniste?" (N' ate kohe qeveria e Hoxhes nuk ishte deklaruar edhe si komu-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

niste, tue vashduar t' a mbaje veten si qeveri "demokratike").

"Le t' a pranojme," nderhyra une, "se ajo qeveri esht komuniste. A nuk i kini njohur qeverit e tjera komuniste te Jugoslavis, Bullgaris, Rumanis dhe Pollonis? A esht e drejte qe t' i mohoni Shqiperis njohjen sepse ajo esht me e vogel dhe me e pafuqishme se fqinjet e saj?"

Mr. Jacobs e perkrahu me force argumentin t' im. Permbi ate, u-vendos qe misioni diplomatik i kryesuar prej tij te kethehej ne Shqiperi per te hyre ne marreveshje me guvernën e Enver Hoxhes mbi konditat e njohjes.

Me largimin e tij nga Shqiperia me 1946, kur u-zbulua gjoja komploti i pregatitur prej Profesorit Harry T. Fultz per te rrezuar qeverin e Hoxhes, kejo qeveri humbi perkrahesin e saj me te singerte, per aresyen e vetem se ashtu i leverdiste Mareshalit Tito.

KAPTINE IX

Bashkefjalimet me Delegatet e Tiranes

NE SHTATOR 1946 arrijti ne New York i pari delegacion i qeveris se Tiranes prane Kombeve te Bashkuar. Delegacioni kryesohej prej Kolonel Tuk Jakoves, nje ish-strukthar nga Shkodra. Se qysh nje marangoz pa mesime dhe pa eksperience ne degen e diplomatike, si edhe pa dijeni te nonje gjuhe nderkombetare munt te dergohet perjashta dhe, sidomos, ne nje mbledhje te perbere nga njerezit me te shkelqyer ne fushen e dituris botnore, kejo esht nje faze e posaqme e "Push-



BASHKËFJALIMET ME DELEGATËT E TIRANËS

tetit te Popullit". Natyrisht, edhe kejo ka shpiegimin e saj, dhe shpiegimi esht se regjimi i Enver Hoxhes ka besim vetem ne njerzit e qarkut te tij te ngushte dhe qendron larg nga çdo perdorim i intelektualleve te vendit te cilet i ka flakur ne burgje dhe budrume ose i ka perjashtuar thjesht nga çdo sherbim te Shtetit. Per te vertet, nje nga dogmat e Komunismit esht çdukja e krejte e intelektualleve te kohes se shkuar, mbassi ata konsiderohen si "fara e keqe" e mbjelle nga regjimet nacionaliste dhe kapitaliste. Ne vend te tyre, çdo regjim komunist po mundohet te kriroje nje klase te re intelektuale t' ushqyer menderisht vetem me doktrinat e Karl Marx'it, t' interpretuara prej Lenin'it dhe Stalin'it.

Me Tuk Jakoven pata nje bisedim te gjate ne Hotel New Yorker. Kur, ne fjalim e siper, u-prek çeshtja e marrredhenieve te qeveris s' Enver Hoxhes me Marshalin Tito te Jugoslavis, i thashe bashkefolesit t' im se isha ne frike se qeveria e Tiranes po binte thelle e më thelle nen influencen, nemos nen kontrollin, e Belgradit.

"Shpesh kini me mbarue," i thashe Kolonelit, "tue e zbritun Shqipnin ne shkallen e nje krahine te Jugoslavis; ose, perndryshe, kini me u-prish krejt me Titon."

"Marrezi!" u-pergjegj me nje fare rreptesie oratorike. "Te dy qeverit t' ona jane tue punue mbi bazen e barasis. Na kena qendruet me Titon dhe ay me na deri sa te realizohet programi i yne i perbashket."

Nuk e pyeta Kolonelin se cili ishte programi i perbashket i te dy qeverive, se tani ishte nje gje e njohur prej kohe. Posacerisht, n' ate periudhe, Tirana dhe



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

Belgradi ishin lidhur fort ngushte, si edhe me Sofjen, ne luften—njetash te deshtuar—q' i kishin hapur Greqis ne Maqedhoni me çetat partizane.

“Ashtu ju duket juve ne kete kohe,” shtova une, “por jam krejt i bindur se ajo q' i ndodhi Zogut, ka per te ndodhe edhe per ju. Si ju, edhe ay filloi te luaje loja me Jugoslavin me 1924 per me u-hudh ne krahet e Italis Fasciste me 1926.”

I kallzova ahere Tukut se ne pjekjen t' ime te pare me Ahmet Zogun ne Korrik 1925—pas kethimit t' im ne Shqiperi nga Amerika—i thashe keti se marreveshja e ngushte e tij me Belgradin e kishte bere Shqiperin gadi si nje province te Jugoslavis, tue u-shtuar kerkimet e qeveris se Belgradit dita me ditën.

‘Ajo s’ esht e vertete,’ protestoi Ahmet Beu, ‘marreveshja ime me Belgradin mbeshtetet ne baza bashkepunimi te sinqerte. . . .’

‘Se sa te shendosha jane ato baza ajo do te provohet shpejt’, i thashe Zogut, i cili e ndroi me-nje-here themen e bisedimit.

“Ajo q' i ndodhi Zogut, nuk mundet me ndodhe tek na,” me deklaroi Tuk Jakova me nje te qeshur sardonike. “Zogu ishte Fascist dhe tradhetor qe kujdesohej vetem per interesat e veta, kurse na dhe qeveria e shokut Tito, jemi tue veprue se-bashku per interesat ma te mira te popujve t' ane. Nje çartje, pra, si ajo qe pareshekoni ju esht e pamundeshme, krejt e pamundeshme.”

Siç dihet, ajo q' i dukej Tuk Jakoves si krejt e pamundeshme ne Shtator 1946 u-be fakt tamam ne dy vjet—aq kohe saç i kishte marre edhe Zogut per t' u-prishur me Jugoslavin. Ne fund te Qershorit 1948



BASHKËFJALIMET ME DELEGATËT E TIRANËS

Kominformi (Communist Information) që zu vendin e Kominternit të shpërndare, e fshiu Titon dhe partinë komuniste të Jugosllavis nga lista e pjesëtarëve të tij. Pa humbur fare kohë, dhe ndofta pa u-menduar mirë, qeveria e Tiranës preu çdo marrëdhënie me "shokun" Tito, të cilin e akuzoi se ishte tue munduar t' a bente Shqipërin një krahinë të Jugosllavis.

BISEDIMI me Tjukan kaloi nga ajo pikë në çështjen më të rëndësishme dhe më të ngutëshme të njohjes së qeverisë së Tiranës nga ana e Amerikës, dhe të pranimit të Shqipërisë në Kombet e Bashkuar.

Në formë të prërë, i thashe Kolonelit se çdo përpjekje për realizimin e atyre dy dëshirave të përgjithëshme ishte krejt e kotë dhe pa asnjë dobi sa kohë që qeveria e Tiranës ngulte këmbë në vendimin e saj të mos-pranimit të traktatëve të vjetra me Amerikën.

"Por ato traktate i kanë lidhur regjimet e kaluëm," u-thotë Koloneli, "perse t' i pranojmë na tani?"

"Se ashtu e lypin rregullat e të Drejtës Nderkombëtare, simbas të cilave një qeveri s' munt të hedhë poshtë një traktat pa pelqimin e anës tjetër. A e dini se shoku juaj Tito i ka pranuar gjithë traktatet e kohës së shkuar?"

"Gjithë të tjeret me sa jam fjalosun," komentoi Tjukan, pa u-përgjegjur në pyetjen t' ime të fundit, "me kanë thanë se na kemi të drejtë dhe jo qeveria amerikane."

"Nuk e di se cilet janë ata të tjeret," i thashe, "por, shigurisht, nuk munt të jeni njers të stërvitur në Ligjin e Kombeve dhe në rregullat diplomatike. Po të them, Koloneli," shtova unë, "se këto çështje e kam biseduar herë pas herë me miqt t' ane amerikane, zyr-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

tare ose jo. Dhe pasi e rrahem çdo pike nga të gjitha anet, unë arrijta në një përfundim të cilin ia bera të njohur Gjeneral Enver Hoxhës me radiogram. Përfundimi është ky: që qeveria juaj të deklarojë se i pranohet traktatet në parim, por rezervon të drejtën që të kërkojë ndryshimin ose zëvendësimin e tyre me traktate të rinj. Jam në pozitë, pra, që të të them konfidencialisht, se kjo është formula e fundit që munt të pranohet qeveria amerikane, si konditë të njohjes së qeverisë s' uaj. Nga ana tjetër, pranimi i traktatëve në formën e sipërme është edhe konditë për pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuar, në Kartën (Charter) e të cilëve thuhet qiltazi se do të pranohen si pjesëtarë të asaj organizate ata kombe që respektojnë detyrimet e tyre ndërkombëtare. Kallzoja këtu sende Enverit kur të kethehesh në Tiranë, dhe mos e lini veten që të jenë nga të tjerët që ju paskan keshilluar se e keni mirë punën."

Tuk Jakova, të cilin nuk e pashe më, qëndroi në mendim disa minuta dhe më në fund vendosi të mos e çele gojen.

PAS TUKUT ardhë edhe një sërë delegatësh të tjerë, dhe në çdo rast që pata të takohem me 'ta ua tingellova në vesh ato argumenta si edhe të tjera që i përkisnin politikës së jashtme të Shqipërisë, ndonjë ishë bindur në këtë mes se çdo bisedim ishte i kotë, mbasi dukej sheshazi se qeveria e Tiranës kishte vendosur të mos luajë nga pozita e saj ekstremiste, të pelqyer "100 për 100" nga VATRA dhe SHQIPËRIA E LIRË.

Por bashkëfjalimet e mij më të nxehtë u-bënë me delegacionin e kryesuar prej Mihal Priftit, Ndihames



BASHKËFJALIMET ME DELEGATËT E TIRANËS

Minister i Puneve te Jashtme dhe, nga gjith shenjat, njeriu më i besuar i Enver Hoxhes per politiken e jashtme.

Me ate Lap te zgjuar for fanatik ne besimet e tij komuniste, u-takova ne Hotelin Governor Clinton (Vjeshte 1950), heren e pare ne prezencen e te dy shokeve te tij, Behar Shtylla dhe Wilson Progri, dhe heren e dyte vetem ne te dy.

Ne takimin e pare i shkuam nen veshtrim gjith fazat dhe incidentet e ngjare rreth marredhenieve ose më mire mosmarreshjeve midis qeveris se Tiranes dhe asaj te Washington'it.

"Si e kini hallin," i pyeta, "qe po leftoni aq terbimisht Ameriken?"

"Se Amerika na hapi luften me pare," u-pergjegj nje prej tyre, "tue mos njohur qeverin t' one dhe tue mos na pranuar ne Kombet e Bashkuar. . ."

"Si edhe kur ju paska hapur Amerika lufte?" pyeta me habitje.

"Pse, nuk ke degjuar, Zotrote, per komplotin qe kishte gatitur Profesori Harry T. Fultz per te permbysur qeverin e popullit?"

I shekova te tre ne sy para se te them;

"Shekoni ketu. Fultz'in une e kam njohur qe me 1925 dhe e di q' ay esht krejt i pazoti per komplete. Çdo njeri tjeter mundet, por Fultz'i kurre. Por juve u jepte dore qe te zbulonit nje komplot te tille qe t' a beni popullin t' urreje Ameriken."

"A duani te thoni me kete se nuk njihni vendimin e 'Gjykates se Popullit' q' e gjeti Fultz'in fajtor?" u-hoth nje tjeter.

"Ato qe ju i quani 'Gjykata te Popullit' nuk jane



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

veçse nje forme tjeter e Gjyqit per Faje Politike te regjimit te Zogut. Pjesetaret e ketyre gjykatave jane njers qe nuk kane as iden me te muget se q' esht ligji dhe drejtesia, dhe vendimet e tyre i formullon qeveria para se te hapet gjyqi. Veçan, gjykatat t' uaja nuk jane veçse kopje te gjykatave te çdo Shteti Komunist."

I shekova edhe nje here ne sy qe te tre, tue pritur nonje pergjigjje ose koment.

"Po mire," u-hoth me ne fund nje prej tyre, "per q' aresye nuk na njeh Amerika dhe perse pengon hyrjen t' one ne UN'in?"

Vije pas vije ua shpiegova edhe ketyre situaten ashtu sic ia kisha pershkruar Tuk Jakoves katre vjet me pare dhe delegateve te tjere, per te mbaruar me keto fjale:

"Gabimi juaj esht qe vini ideologjin t' uaj perpara interesave me jetike te Shqiperis. Sa kohe q' ishit te lidhur me Tito'n, ndiqnit politiken e tij aq verberisht sa qe nuk kuptuat kallepet ne te cilet ju futi ay, jo per hir t' ideologjis, por per interesat thjesht nacionale te Jugoslavis. Ay ju beri qe te prishi krejt me Ameriken dhe Anglin, ay ju futi n' aventuren dizastrose te Kanalit te Korfuzit, ay ju beri qe te mbeti krejt t' izoluar nga bota e jashtme. Dhe passi u-prishte me 'te, perseri per aresye ideologjike, hyte ne nje kallep me te math. . . Por, ajo qe me çudit me teper esht qe si nuk qendruat nje here te mendoji se Amerika, te cilen ju mundoji t' a perçmoni, esht njera nga te dy Fuqit me t' medha te botes, dhe se pa voten e saj nuk munt te dilni te fituar n' asgje, krejt n' asgje. Per shembell, si prisni qe te zgjidhet çeshtja e kufireve te juges



BASHKEFJALIMET ME DELEGATËT E TIRANËS

pa voten e favoreshme t' Amerikes? Me thuani pak, ju lutem, si do t' ia dilni ne krye kesaj pune?"

Kete here u-hoth vete Mihal Prifti per te deklaruar: "Ne jemi kur-do-here gati dhe ne pozite qe te mbrojm independencen dhe teresin tokesore te Shqiperis."

"Me ane t' armeve? e pyeta.

"Me ane t' armeve ose me qdo miet tjeter," u-pergjegj ndihmesi i Enver Hoxhes.

"Dua t' ju besonj," thashe une, "por nuk me jepet, mbassi Rusia esht nje mije mila larg nga Shqiperia e rrethuar prej armiqsh nga qdo ane dhe kend te saj."

"Mirpo," u-hoth nje nga te tjeret, "q' munt te presim nga Amerika kur ajo ia ka njohur Greqis Korqen dhe Gjirokastren?"

"Kush ia ka njohur Greqis, qeveria amerikane apo Senati i Amerikes?" pyeta une.

"A nuk esht nje faresoji?"

"Aspak. Ne systemin politik t' Amerikes, Senati esht nje trup krejt i veqante dhe i ndare." Dhe ne kete pike u shpiegova delegateve se n' Amerike qeveria perbehet nga tre departmente te veqante: eksekutiv, legjislativ dhe gjyqesor. Mbarova tue u dhene informata dhe qkoqitje te plota mbi rezoluten e Senatorit Pepper, ashtu sic shpiegohet ne kaptinen e posaqme qe pason.

NE TAKIMIN E DYTE me Mihal Priftin m' u-dha rast te flas me haptazi mbi disa pika qe nuk u-preken ne bashkefjalimin e pare.

Pika kryesore ishte, natyrisht, se si do t' i veje filli Shqiperis se rrethuar an' e mb' ane nga shtete anti-sovietike. Ndhmesit t' Enver Hoxhes per punet e



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

jashtme i çfaqja lakuriq mendimin t' im. I thashe se nje qeveri si ajo q' esht sot ne fuqi ne Tirane, esht fatalisht e ekspozuar ne komplete te jashtem, vecanerisht sepse nuk esht e njohur nga disa nga fuqit me te medha te botes. Shtova se, ne menyren me te cilen esht tue vepruar, ajo qeveri po e ndjell vete rrezikun e rrezimit te saj.

“Ç' lloi veprimi rekomandoni ju?” pyeti bashkefolesi i im.

“Nuk e di,” i thashe “n' esht teper von njemendi, por une mendoj se qeveria juaj duhet te gjeje medemos nje menyre afrimi me Fupit e Perendimit dhe, sidomos, me Ameriken.”

“Mendimi juaj me çudit fort,” tha Nenministri i Puneve te Jashtme, “sepse ju jini i vetemi qe po na çfaqni nje mendim te tille. Por, sido qofte, une po ju them se qeveria jone ka politiken e saj te caktuar dhe nuk do te largohet nga ajo per asnje arsye ose per shkak te nonje influence te jashtme. Ne jemi kunder Fascistëve dhe imperialistëve qe po pregatitin nje lufte te trete botnore. . .”

Pas kesaj deklarate çdo bisedim tjeter ishte i kotte.

Si nje pas-shenim, me duhet te shtonj se keto bashkefjalime me delegatet ndofta do te pergenjeshtrohen nga ana e tyre. Ajo esht e drejta e tyre. Por detyra historike me beri qe t' i raportoj ne keto faqe, jo tekstualisht, mbassi nuk kishte menyre qe te mbahej nje rekord, por ne permbajtjen e tyre te pergjitheshme,



REZOLUTA E SENATORIT PEPPER

KAPTINE X

Rezoluta e Senatorit Pepper

NJE nga qeshtjet me kontroversiale q' esht lene ne deren e Shqipateve t' Amerikes esht rezoluta rreth Shqiperis se Juges e proponuar prej Senatorit Claude Pepper dhe e pranuar pa kundreshtime nga Senati i Shteteve te Bashkuar ne Qershor 1946. Pyetja esht nese Shqiptaret e Amerikes e kishin ne dore te ndaloni ate votim aq te demshem per Shqiperin.

Faktet jane keto: Me 19 te Shkurtit 1946—dhjete muaj pas largimit t' im nga SHQIPERIA E LIRE—u-ndodha ne New York, ku u-ftova te marre pjese ne nje festim te Kishes se Shen Kollit. Ne defrim e siper dikush pruri nje gazete te mbremjes ne te cilen botohej lajmi se Senatori Claude Pepper i Shtetit Florida kishite paraqitur nje rezolute me anen e te ciles kerkohej pelqimi i Senatit Amerikan per aneksimin e Korces dhe Gjirokastrës (Epir i Veriut) nga ana e Greqis.

Ne mes te festimit i mblodha ish-bashkepunetoret e mij ne SHQIPERIN E LIRE si edhe disa nga anetaret e VATRES qe ndodheshin atje dhe i keshillova me ngutesi qe te benin tri gjera:

1) T' organizonin nje meeting te perbashket—Vatrane dhe 'Liriane'—per te protestuar prane Senatit Amerikan kunder votimit te rezolutes;

2) Te formonin nje delegacion, perseri te perbashket, i cili te vinte ne Washington per t' u-paraqitur perpara Komisionit te Puneve te Jashtme te Senatit ku kishte mbetur rezoluta n' ate kohe;

3) Te pregatitnin nje memorande te shkurter por



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

te ngjeshur me data, fakte dhe numura mbi gjendjen demografike te krahinave te Korçes dhe Gjirokastrës.

Mbledhja e pare e perbashket u- mbajt ne fakt te nesermen ne sallën e Kishes se Shen Kollit dhe, per te kryer te tri keshillat e mia, u-hap nje fushate per fondet qe do te lipseshin. Keshtu, u-duk sikur puna hyri n' udhe te mire, tue u-afruar anetaret e te dy organizatave q' ishin ne lufte t' eger midis tyre.

Mirpo, prishja ardhi po-thua se qe ne fillim, per nje gabim qe thuhej se ishte bere ne raportin e mbledhjes. Ne raportin thuhej se fondi do t' i dorezohej Imzot Nolit qe t' a perdorte per shpetimin e Toskeris. Por, ata te SHQIPËRIS SE LIRE insistonin se raporterit i mbledhjes nuk kishte degjuar mire: ne vend qe te shkruaje se fondi do t' i dorezohej nje Komisioni te perbashket te kryesuar prej Imzot Nolit, permendi Peshkopin si depozitar te fondit. Kejo shkaktoi nje perçarje me te madhe nga ajo q' eksistonte n' ate kohe midis dy organizatave, mbassi ata te SHQIPËRIS SE LIRE, qe thoshin se kishin dhene pjesen me te madhe te fondit, nuk pranonin n' asnje menyre qe te hollat t' i binin ne dore Peshkopit.

Ndaj fundit, fondi i tere iu dorezua Imzot Nolit i cili u-porosit te vinte ne Washington per t' u-takuar me Senatorin Pepper si edhe me do pjesetare te tjere te Kongresit. Senatori Pepper e priti Peshkopin, por e mbajti me kembe dhe e degjoi vetem per disa minuta. I hidheruar nga ajo pritje jo fisnike, Noli e la Washington'in pa u-takuar me njeri tjeter.

TANI vijen dy pyetje: 1) Ç' e beri Senatorin Pepper qe te nxjerre perpara Senatit nje rezolute te tille,



REZOLUTA E SENATORIT PEPPER

kurse gjith bota amerikane e dinte q' ay ishte nje liberal i vertete, perkrahes i politikës s' afrimit t' Amerikes me Rusin Sovietike dhe i bashkuar ne mendime, nemos ne veprime, me ish-Nenepresidentin e Shteteve te Bashkuar, Henry A. Wallace? Fakti esht se, per shkak t' atyre mendimeve, Claude Pepper humbi ne votimet e vitit 1948;

2) Ç' e beri Senatorin Pepper i cili esht, prej natyres se vete, bujar dhe demokrat qe t' a prese aq keq Imzot Nolin?

Pergjigjia ne pyetjen e pare esht kejo. Ne Shtetin Florida jetojen me mijra Greke qe merren me peshkimin e rrezikshem te sfengjerit. Po ashtu gjenden n' ate Shtet disa nga deget me te forta te shoqeris greke te perhapur AHEPA. Me anen e kryetareve te ketyre degeve, shoqeria Epirotike mundi t' i mbushe mendjen Senatorit, sic do te shihet me tutje, se per te miren e paqes ne Ballkan "Epiri i Veriut" duhej t'i kethehej Greqis!

Pergjigjia ne pyetjen e dyte esht se agjentet e Ahepa's dhe te Shoqeris Epirotike e kishin paralajmeruar Senatorin, sic u-kuptua me von, se Imzot Noli ishte pro-Komunist, nemos Komunist, dhe se nuk esht as Shqiptar, mbassi leu ne Thrake. Mjafton te shtohet ne kete pike se, per aresyet e siperme, vajtja e Peshkopit ne Washington nuk munt te sillte asnje perfundim te mire.

TAKIMIN e Imzot Nolit me Claude Pepper e mesova disa dit me von dhe me-nje-here u-drejtova tek zyrtaret e Departmentit te Shtetit te cileve u thashe se kejo pune e rezolutes esht tue marre nje forme te



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

shemtuar dhe, prandaj, duhej ndaluar me nje menyre ose me nje tjeter. Nje prej tyre me tha fjalet e poshtme te cilat ia perserita Ndhimesit Minister te Jashtme, Mihal Priftit, ne takimin t' im me 'te ne Hotel Governor Clinton, Nentor 1950.

"Te tjeret mundet te mos e dine, por juve duhet te dini, shigurisht, se Departmenti i Shtetit nuk munt t' i jape urdhra Senatit i cili, perkundrazi, gezon te drejte konstitucionale te shqyrtoje, te kritikoje, dhe te pengoje veprimet e Departmentit. Ne fakt, sikur te nderhyjem né ne veprimet e Senatit, sidomos ne kete çeshtje te Shqiperis, puna munt te marre nje rruge mé te keqe se sa per mé mire."

"Ate e di," i thashe, "por mua me duket se Departmenti e ka ne dore t' i thote Senatit, se-paku, se kejo nuk esht koha per te biseduar nje rezolute te tille, dhe sidomos pa na dhene ne Shqiptareve te drejten qe te çfaqim pikepamjen t' one."

"Per ate munt te kini te drejte," tha zyrtari. "Por, pa ndal-u pak: perse te mos vini ju vete te Senatori Pepper per t' i paraqitur situaten e vertete te Shqiperis se Juges?"

"Qe te me mbaje edhe mua me kembe dhe te mos me lere te mbaronj ç' kam per t' i thene?" e pyeta.

Zyrtari me tha tue qeshur: "Ajo munt t' i ngjante vetem Peshkop Nolit. Por, edhe sikur te ngjase edhe per ju, nje njeri qe lefton per te drejtat e vendit te tij duhet te jete i gatitur per çdo suate."

Ne masdreken e dites se neserme u-prita ne sallën e takimeve te Senatit prej Senatorit Peper i cili me dha mé teper se nje gjysme ore per t' i shpieguar pikepamjen demografike te Toskeris.



REZOLUTA E SENATORIT PEPPER

“Senator,” i thashe, “ne Korrik 1944, kur isha kryetar i SHQIPERIS SE LIRE, Departmenti i Shtetit me kerkoi nje memorande mbi ceshtjen e kufireve te Shqiperis, vecanerisht persa u perkiste kufireve te Juges. Memoranden ia dorezova Departmentit brenda javes. N’ ate tregova se Shqiperia u-nda per gjysme kur iu caktuan kufiret me 1913. Pjesa me e madhe e saj, me nje popullsi prej afro nje miliuni frymesh mbeti ne Jugoslavi, dhe nja 100,000 Shqiptare te tjere ne Greqi.

“Pervec keti minoriteti qe na grabiti, Greqia kerkon tani—ashtu si proponi ju—Korçen e Gjirokastrin, popullsia e te cilave perbehet, simbas statistikave, prej nja 250,000 fryme, ne numura te rrumbullakta. Nga keto 140,000 jane Myslimane te cilet nuk munt te pan-dehet se duan Greqin, n’ asnje menyre, 80,000 jane Orthodhokse—nje nga te cilet jam une—dhe 30,000 jane Greke, te njohur si te tille nga ana e Shqiperis dhe te regjistruar si te tille prane Lidhjes se Kombeve. Nga te 80,000 Orthdhokse munt te gjenden disa—tho-sha ne memoranden—qe te duan Greqin, por, sic shihet nga keto figura, shumica e madhe e populsis se Korçes dhe Gjirokastrin jo vetem q’ esht shqiptare por edhe nuk pranon kurrsesi qe te shkeputet nga Shqiperia . . .

“Pas nje jave, Senator, kryetari i zyres se Ballkanit ne Departmentin e Shtetit me ftoi t’ a vizitonj per te me thene se ekspertetet e Departmentit e pelqyen teresisht memoranden t’ ime. Ay dokument, Senator, gjendet n’ arkivat e Departmentit dhe, po te deshironi, munt t’ a shqyrtoni dhe t’ analizoni nga ana juaj.”

Senatori Pepper qendroi ne mendim per disa minuta.

“Per nder” (honestly), me tha me ne fund, “Nuk e



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

dinja gjer tani se si qendronte puna. Kur ia paraqita Senatit rezoluten t' ime, mua me dukej—nga sa me kishin thene—se isha tue i bere nje sherbim shigurimit te paqes ne Ballkan.”

“Mirpo,” i thashe une, “si do t' i behet punes tani. A do te vashdoni n' insistencen t' uaj qe rezoluta te pranohet prej Senatit?”

“Pen nder, po ju them perseri,” u-pergjegj Senatori liberal me sinqeritet, “nuk di me se ç' te them.”

“A ka menyre,” e pyeta, “qe t' a hiqni rezoluten?”

Passi u-mendua pak, Claude Pepper tha, “Jo, ate s' munt t' benj.”

“Ajo munt te kuptohet lehte,” i thashe, “por, a do te na jepni rast dhe kohe, ne Shqiptareve, qe te dalim perpara Komisionit te Puneve te Jashtme te Senatit per te kundreshtuar rezoluten t' uaj?”

“Oh,” tha Senatori, “ajo esht e drejta juaj. Sa kohe duani? Nje muaj? Dy muaj?”

“Dy muaj besonj te jene mjaft,” i thashe. “Por, dua te shigurohem nga ju, Senator, se brenda ne keta dy muaj do t' a lini rezoluten te flere ne Komisionin e Puneve te Jashtme te Senatit.”

“Per ate kini fjalen t' ime.”

“Thank you, Senator, thank you,” i thashe tue zene dore.

QË NGA salla e Senatit vajta drejt ne Departmentin e Shtetit, ku u kallzova zyrtareve perfundimet e takimit t' im me Senatorin Pepper.

“Por edhe ne,” m' informoi ay qe me kishte keshilluar te takohem me Senatorin, “nuk kemi qendruar me duar kryq. Me telefon i thame Senatorit Connally,



REZOLUTA E SENATORIT PEPPER

chairman i Komisionit te Puneve te Jashtme te Senatit, qe nuk esht aspak e drejte qe te dale rezoluta nga ay Komision para se te paraqiten Shqiptaret per te cfaqur pikepamjen e tyre. Dhe Senatori Connally na dha fjalen se do te prese cdo delegacion shqiptar.

"Dhe tani," shtoi zyrtari me nenqeshje, "shko i mblith Shqiptaret e tu, ne qofsh i zoti, dhe shpjeri perpara Senatorit Connally. Do te jete shume me mire sikur te vije ne Washington nje delegacion i perbashket i SHQIPERIS SE LIRE dhe VATRES."

Me gezim ne zemer te nesermen mora trenin per New York. Pa humbur kohe i mblodha bashkpuntoret e mij te vjeter te SHQIPERIS SE LIRE, midis te cilave ishin me emer Z. Z. James Viso, Asllan Dragoti dhe i ndyeri Shaqo Duka. Ketyre u kallzova drejtimin e ri qe mori ceshtja e rezolutes dhe iu luta qe te lajmeronin VATREN me ane te miqve te tyre Vatrane qe te formohej sa me shpejt delegacioni qe do te vinte ne Washington. Njekohesisht, e lajmerova me letre te vecante edhe kryetarin e SHQIPERIS SE LIRE, Dr. John T. Nasse, mbi nevojën e nje veprimi sa me te shpejte.

Por shkoi nje muaj, shkuan dy muaj, dhe asnje delegacion nuk ardhi ne Washington nga organizatat e paralizuara, nemos te vdekura, nga polemikat dhe ngreniet ne mes te tyre. Ne Qershor, rezoluta doli perpara Senatit dhe u-pranua pa kundreshtim.

Gabimi qe bera une ishte qe nuk dolla vete perpara Komisionit te Puneve te Jashtme te Senatit per te mbrojtur thezen e Shqiperis s' one te Juges. Por ate gabim e bera nga frika se mos ata te VATRES ose te SHQIPERIS SE LIRE, ose te dyja se bashku, do te dil-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

nin të m' akuzojen se iu grabita të drejtat e tyre si organe përfaqësues të Shqiptarëve t' Amerikës.

Ndofta u-zgjata tepër mbi këtë çështje, por ishte nevojë e domosdoshme që të dilnin gjith faktet në dritë, mbasi delegatet e qeverisë së Tiranës si edhe një pjesë e madhe e Shqiptarëve t' Amerikës ia hedhin fajin e votimit të rezolutës qeverisë amerikane. Por e verteta është se Departmenti i Shtetit ishte aq kundër votimit të rezolutës sa edhe gjith në të tjeret, porse na lanë krejt në balte të dy organizatat t' ona.

KAPTINË XI

Vashdimi i Regjimit Komunist

NE NJË KORRESPONDENCË të dërguar në Prill 1951 nga Athina në gazetën e shënuar të Paris'it "Le Monde," shkrimtari frenk Marc Marceau bente disa vërejtje mjaft të rëndësishme mbi situatën nderkombetare të Shqipërisë.

Simbas mendimit të tij, e vetma gjë që e mban në fuqi regjimin e Enver Hoxhës është mosmarreveshja e fqinjëve të Shqipërisë rreth qëndrimit që duhet të mbajen kundrejt këtij Shteti më të vogël në mes të tyre. Sa kohë, thotë M. Marceau, që Jugosllavia mendohet të vërë në fuqi Titoistet e Shqipërisë, që Italia kujton se munt të shtjërë prapë atë vend nën kontrollin e saj dhe Greqia vashdon të kerkojë krahinat e Korçës dhe Gji-nokastres, Enver Hoxha është i shigurt të qëndrojë në fuqi për një kohë të pacaktuar. Kejo mosmarreveshje midis fqinjëve, shton shkrimtari frenk, ia ka prishur mendjen popullit shqiptar sa që nuk sheh rrugë tjetër



VASHDIMI I REGJIMIT KOMUNIST

veçse t' i jape tere perkrahen e tij regjimit t' Enver Hoxhes i cili gjen rast, ne kete menyre, qe te çduke gjith kundreshtaret e tij.

Edhe me rishtazi, nje gazetar i njohur amerikan, Mr. Ferdinand Kuhn, i cili beri nje shetitje te gjate ne veren e shkuar (1951) gjate Perdes se Hekurte, shkruante sa vashdon me poshte ne nje nga artikujt e tij:

Nje togu Grekesh u ha pellemba per te shtene ne dore ate pjese te Shqiperis q' ata e quajen Epir te Veriut. Sikur regjimi komunist te permbysej nese ne Shqiperi, Greket e shohin si pune te lehte qe te marshojen e te grabitin tokat e lakmuara brenda ne 24 ore, sa do qe te mundohen t' ua mbajen doren Aliatet e Perendimit.

Nga ky shkak, Fuqit e Perendimit nuk kuxojen t' organizojen nje kryengritje anti-komuniste per brenda Shqiperis. Se po te jete qe Greket hyjen ne Shqiperi, ahere Jugoslavet dhe Bullgaret do te bejen kundremarshime dhe zjari i ka per te rrene gjith Ballkanit.

Mendimet e çfaqur me siper nga keta korrespondente te huaj jane pjeserisht te bazuara ne logjiken e fakteve.

Nga ana tjeter, nje shkrimtar i ri amerikan, Richard Mowrer—bir i mikut te moçem te Shqiperis Edgar Ansell Mowrer—bente disa verejtje po-thua te kunderta ne nje korrespondence qe dergonte nga Trieshti. Passi shpiegonte se Shqiperia mbahet me ushqimet qe lundrat shqiptare ngarkojen ne Triesht tue i shkëmbyer me produkte shqiptare, Richard Mowrer shtonte se Aliatet qe kontrollojen Trieshtin jane ne pozite t' a fikin jeten e Shqiperis si nje drite kandili. Mjafton,



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

thote ay, qe te mos i lene lundrat shqiptare te sjellin ose te heqin mall nga Trieshti. Por, shton ay, Aliatet nuk kane ndermend qe te bejen nje gje te tille sot per sot, se nuk u jep dore te krijen nje situatë te re ne Shqiperi ne mes te konfliktit me te math qe kane me Rusin Sovietike. Me fjale te tjera, Aliatet—dhe me termen “aliate” kuptohet Anglia dhe Amerika, te vetemat fuqi qe mbajen forca ushteriake ne Triesht—nuk duan te hapin nje plage te re ne konfliktin e tyre me Sovietet.

NDERKOHË, tue perfituar nga kejo situatë, si duket, Rusia po e forcon dita me ditën pozitën e qeveris s' Enver Hoxhes.

Simbas informatave te fundme dhe te konfirmuara, per te paren here ne historin e saj te re Shqiperia esht pajosur me nje flote prej njezet e ca luftanesh, ne mes te cilave 10 destroyers,—te dhena prej Ruis nga pjesa e flotes italiane qe iu dorezua pas luftes—me 25 tanke dhe me nje skuadre aeroplanesh, te gjitha keto dhurata nga ana e Moskes. Tanket dhe aeroplanet jane arme te pazmueshme per te shtypur çdo levizje te brendeshme, kurse flota hyn ne pune per te mbrojtur anedetin ne menyre qe te ndaloht çdo çbar-kim armesh ose njerzish nga jashte.

Se sa i kane kushtuar popullit shqiptar keto armatime te pazakonta, ajo nuk dihet me shiguri, mbassi disa thone qe jane dhurata te thjeshta nga an' e Ruis, kurse te tjere insistojen se u-blene me mall te derguar ne Rusi ose ne satelitet e saj.

Por sado te vlefshme qe munt te jene keto arme per te forcuar perkohesisht pozitën e qeveris se Tiranës,



VASHDIMI I REGJIMIT KOMUNIST

fakti esht qe Shqiperia gjendet e izoluar nga Rusia, tue gene rrethuar nga fqinje qe jane armiq te Sovieteve.

Per t' i derguar ndihma Shqiperis, Moska ka vetem dy rruge: me ane te detit, me vapore qe nisen nga Odesa q' esht 1000 mila larg nga Vlora ose Durrresi; me ane t' aeroplaneve. Por aeroplanet duhet te fluturojen permby toka greke ose jugoslave, dhe, ne rastin e duhur, qeverit e Athines dhe Belgradit munt te ndalojen kalimin e tyre. Gjer sot aeroplanet ruse vene ne Shqiperi tue fluturuar permby token jugoslave. Por, ne marreveshje me qeverin e Belgradit, aeroplanet duhet te qendrojen me pare ne nje aerodrom te caktuar per kontroll nga ana e autoriteteve jugoslave. Nga ana tjeter, ne rast ashperimi te konfliktit midis Lindjes dhe Perendimit, Alietet jane ne pozite te ndalojen cdo levizje vaporesh ruse, mbassi flotat e tyre, te bazuara ne Triesht dhe ne limanet e Italis, e kane Adriatikun nen kontrollin e tyre. Me fjale te tjera, ne rast afrimi te shpalljes se luftes, dhe para se te fillojen hostilitetet, Shqiperia esht e destinuar te shkeputet automatikisht nga blloku sovietik dhe qeveria komuniste e Tiranes te marre fund me-nje-here. N' esht se forcat sovietike do te mundin te shtypin Jugoslavin ose Greqin per t' arrijtur ne kufiret e Shqipris dhe per te dale n' Adriatik, ay esht nje shvillim qe nuk munt te parashkohet qysh tash. Por edhe n' ate rast, anedeti i Shqiperis do te jete gjithnje nen topat e flotave aliata dhe, ndofta, nen okupaten e ketyre.

POR, sikur t' a leme menjane rastin e luftes, sa kohe do te munt te mbahet ne fuqi regjimi i sotme pro-sovietik i Shqiperis?



PLANI I TRETË I COPTIMIT TE SHQIPERIS

Siç u-shpiegua me siper, vashdimi i regjimit komunist varret krejt nga vendimet dhe dispozitat qe do te marrin Aliatet. Po te jete se, si munt te ndodhe, merr fund nonje dite lufta e ftohte midis Aliateve dhe Ruis Sovietike, regjimi pro-sovietik i Shqiperis ka per te marre fund ne ditet e para te mbarimit te konfliktit, tue qene se kejo gjendet e rrethuar nga fqinje qe jane te lidhur me Aliatet, si Italia, Jugosllavia dhe Greqia. Nuk esht nevoje qe njeriu te jete profet ose diplomat i çquar per te pareshekuar se Aliatet nuk munt te pranojen te lene nje folé komuniste ne mes te kampit pro-Aliat. Fundi i fundit, as Stalini, as Molotofi, as Vishinski, as nonje tjeter diplomat sovietik nuk ka hapur gojen nonje here ne nonje nga konferencat nderkombetare per te kerkuar ose insistuar qe Shqiperia esht pjese e pandare e bllokut sovietik. Ne fakt, Rusia nuk ka asnje traktat aliance ose perkrahjeje mutuale me Shqiperin, ashtu sic ka me gjith satelitet e saj te tjere. Kejo esht prove qe vete qeveria e Moskes pareshekon se munt te vije dita kur te paraqitet nevoja qe Rusia te heqe dore krejt nga Shqiperia.

“Por, ahere,” do te pyese dikush, “per ç’ aresye po e forcon Rusia poziten e qeveris se Tiranës?”

Per aresye prestigji dhe per inat t’ Aliateve. Prestigji sovietik nuk e lejon Mosken qe te lere te shkeputet nga blloku sovietik nje toke qe hyri nje here ne qarkun e tij. Fakti esht qe Shqiperia munt t’ i hynte ne pune Ruis sa kohe qe Jugosllavia bente pjese te bllokut sovietik; dhe fakti tjeter esht, sic u-shpiegua me pare, qe ne kohën e bashkepunimit ruso-jugoslav ishte qeveria e Belgradit ajo qe kishte nen kontroll qeverin e Tiranës dhe jo Moska.



VASHDIMI I REGJIMIT KOMUNIST

Me fjale te tjera, kyçi i zgjidhjes se problemit te Shqiperis duhet kerkuar kryesisht ne Belgrad. Per te vertet, prapa çdo ndrimi me force te regjimit ne Shqiperi ka qene gjithenje qeveria e Belgradit. Edhe kur Mussolini vendosi t' invadoje Shqiperin ne Prill 1939, Ministri i tij i Puneve te Jashtme Kont Ciano e pa te nevojeshme qe te genjeje qeverin e Belgradit ashtu si pati genjyer Bejleret. Vete Konti Ciano shkruan ne Ditaret e tij se kur u-takua me Ministrin e Jugoslavis ne Rome, Kristiq, dhentri i Duçes e shiguroi perfaqesonjesin e Jugoslavis se Italia s' kish ndermend te cenoje independencen e Shqipris, porse qellimi i saj i vetem ishte qe te flakte jashte Zogun. Nga ana tjeter, qeveria e Romes nuk e perfilli aspak ne kete rast Greqin, fqinjen tjeter tokesore te Shqiperis.

Nga rrieth kejo rendesi e posaçme e Jugoslavis ne punet e Shqiperis?

Nga dy aresye: e para qe Jugoslavia esht fqinja me e forte kufizore e Shqiperis; dhe e dyta nga qe Jugoslavia ka ne tokat e saj dhe gjate kufirit te Shqiperis afro nje miliun Kosovare dhe Dibrane qe jane luftetare te klases se pare. Nen komanden e Isa Boletinit, Kosovaret u-maten dy here me ushterin turke, me 1911 dhe 1912, dhe heren e dyte dermuan turperisht hordhit e Sulltanit. Prandaj, kur-do-here qe t' i jape dore qeveris se Belgradit per te rrezuar regjimin ne fuqi te Shqiperis, mjafton t' u jape leje Kosovareve dhe Dibraneve per t' a kryer ate mision. Kejo ngjau, pikerisht, me 1924, kur me mobilizimin e Dibraneve vetem—Kosovaret nen Bajram Curin ishin kunder—Ahmet Zogu mundi te kethehet ne Tirane brenda dhjete ditve per



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

te rrezuar guvernën e Imzot Nolit. Është e vërtetë se në atë rast qeveria e Belgradit i dha Beut të Matit edhe ndihma e lehtësira të tjera, por punën më të madhe e kryen Dibranet e të dy anëve të kufirit. Dhe në çdo rast është fare lehtë që nderhyrjeve jugoslave t' u jepet ngjyra e kryegritjeve të brendshme, mbassi nuk ka mënyrë që të çqohen Kosovaret dhe Dibranet e Shqipërisë së lirë nga Dibranet dhe Kosovaret e mbetur në Jugosllavi.

Qënia, pra, e atij milioni Kosovaresh gjatë kufirit Jugo-Shqiptar është shkaku kryesor i dobësisë së Shqipërisë independente; dhe kanë plot të drejtë ata që thonë se Shqipëria e sotme është si një trup i sakat, pa Dibrën dhe Kosovën.

Sa për të dy fqinjët e tjerë, d. m. th. Italin dhe Grekin, këto nuk gëzojnë një pozitë të tillë. Italia është munduar gjithnjë të vërë dorën mbi Shqipërinë vetëm me intriga dhe mashtrime. Edhe në rastin e Zogut munt të thuhet me shiguri, dhe për hir të së vërtetës, se ai nuk kishte për qëllim që të lejonte Italin të shtjere në dorë Shqipërinë. Qëllimi i Zogut ishte që të përfitonte nga pozita e fortë e regjimit fascist të Duçes për të qëndruar në fuqi gjërë ditën kur do të hapëj shtegu për shkeputjen e tij të krejtë nga Italia. Gabimi i tij ishte besimi se ai ishte më i zoti dhe më i zgjuar se Mussolini. Këto mentalitete të Zogut e dinin fare mirë ata të Romës dhe prandaj e ruanin gjithnjë si macja miun, të pritën rastin që t' a zëvendësonin ose t' a flaknin krejt jashtë.

Në përfundim munt të thuhet me bindësi se regjimi i Enver Hoxhës do të marrë fund, përse i përket nderhyrjes së jashtme, kur Aliatët e Perëndimit t' i japin



E PRITMJA E SHQIPËRIS

leje Tito's qe te rrezoje qeverin e Tiranes me ane te Kosovareve dhe Dibraneve, por jo qe t' a shtjere Shqiperin nen kontrollin e tij. Anglia dhe Italia nuk munt te lejojen nje gje te tille.

Ne rastin e kunderte, d. m. th. po te jete se regjimi i Tito's do te rrezohet me mietet dhe menytrat qe ka Moska ne dispoziten e saj, ahere Enver Hoxha ka per te dale shume me i forte nga sa ka qene gjer tani.

KAPTINE XII

E Pritmja e Shqiperis

PERVEÇ dy hipotezave q' u-shpieguan ne faqen e pashkuar dhe qe kane te bejen me nderhyrjen e forcave te jashtme per te rrezuar qeverin e Enver Hoxhes, gjendet edhe nje e trete: qe ndrimi i regjimit munt te behet me anen e popullit shqiptar pa u-perzjere forcat e jashtme.

Natyrisht, kejo esht rruga e drejte dhe e vertete. Ne qofte se populli nuk e don regjimin e vendosur prej Komitetit te Çlirimit Nacional, esht e drejta e popullit, dhe askujt tjeter, qe te ngrihet per t' a permbysur.

Kejo esht zgjidhja ideale. Por, mjerisht, ideali dhe realiteti jane dy gjera te ndryshme. Realiteti esht qe i ashtu-qojturi "Pushtet i Popullit" mbahet ne fuqi me ane te forces dhe te terrorit. (E kunderta, d. m. th. qe qeveria e Hoxhes gezon besimin dhe perkrahjen e shumices se madhe te popullit, s' munt te provohet kurr-sesi, mbassi autoritetet e saj i kane mbyllur kufiret per vizitore dhe investigatore te paaneshem. Vetem vizitore Komuniste ose pro-Komuniste pranohen ne kete



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

kohe brenda kufireve të Shqipërisë.) Në forcen dhe terrorin duhet shtuar edhe mungesa e bukes së përditshme. Premtimi i kohës së kaluar "Buke për të gjithë!" u-provua një fjale krejt e zbrazet. Ka mjaft buke, ndofta, për qeveritaret dhe anëtarët e Partisë. Për popullin, përgjithsisht, rezervohen vetëm kothoret e mbetura nga tryeza e hierarkive. Në fakt, regjimi i ri e shkateroi krejt ekonominë e vendit, për arsye të thjeshtë ideologjike, në një shkallë të tillë sa që shumë nga sendet ushqimore që prodhoheshin në vend tani duhet t'importohen nga jashtë.

Në kondita të këtylla, pra, nuk mund të pritët që një popull të çarmatosur, të shtypur dhe të ngordhur për buke t'i ketë mbetur mjaft ambicje ose energji sa që të ngrihet kundër një qeverie që ka në dispozicion të saj një polici të Shtetit dhe një polici (të fshehtë) të Partisë, një ushtri të Shtetit dhe një ushtri të posaçme të Partisë, përveç aeroplanëve, tankeve dhe luftanieve me të cilat e pajosi atërisht Xha-Stalini.

I vetmi mundësi që mbetet është që populli të ndihmohet nga jashtë moralisht së-paku, për t'i dhënë shpresë se po të kuxojë në një ditë të ngrejt krye kundër qeverisë rëk ka për t'i munguar për krahuja nga të jashtëmit.

KËTË kishte ndermend Midhat Frashëri kur formoi (në Gusht 1949) "Komitetin Shqiptar të Lire." Qysh në fillim të tij, komiteti përbëhej nga dy grupe: "Balli Kombëtar" dhe Zogu. Por Midhat Frashëri mbaroi jetën në New York (Tetor 1949) pa filluar mirë nga puna (dhe pa me dhënë rastin që t'a kundërshtonj për shpërdorimin e emrit "Shqiptarët e Lire" me të cilën e



E PRITMJA E SHQIPËRIS

pagezova organizaten q' u-themelua ne Boston qysh ne Nentor 1941. Dhe, incidenterisht, edhe i ashtu-qojturi "Bllok Nacional Independent" i Verlacit me qendre ne Rome, i dha emrin "L' Albanie Libre" (Shqiperia e Lire) organit te tij qysh me 1946).

Pas shdukjes se Midhat Frasherit nga shkena e levizjes se jashtme anti-komuniste, "Balli Kombetar" u-ça me-dysh me rastin e emerimit te Hasan Dosit si kryetar i Komitetit, ne menyre qe Zogu, i fshehur prapa perdes, te mbetet si element kontrollues i veprimeve te Komitetit. E verteta esht qe sa kohe rronte Midhat Frasheri, kundreshtari i papajtuarshem i Zogut dhe trashegimtar i traditave historike te familjes patriotike te Frasherllinjvet (Abdyl, Sami dhe Naim), Zogu ishte i destinuar qe te mbetej prapa perdes per gjithmone. (Dihet se Midhat Frasheri u-kandis te hyje ne bashkepunim te larget me Zogun vetem mbi insitimin e dy agjenteve te mirenjohur inglize qe besojen se Zogu esht 'i domosdoshem').

Perkundrazi, nen kryesin e Hasan Dosit—me te cilin kam bashkejetuar dy vjet e gjysem ne burgun e Zogut—Komiteti nuk mundet veçse te behet vegle e ambicjeve te Beut te Matit. Prova e kesaj esht qe Zogu gjeti shteg per t' ardhur n' Amerike dhe per t' u-vendosur ne Long Island, ku bleu nje çiflig baronial me fondet e grabitura nga arka e Shtetit, qe te jete sa me pranë qendres se Komitetit ne New York. (Ne kohen e shkuar, kur kryesonja organizaten e SHQIPËRIS SE LIRË, Zogu kishte kerkuar leje disa here per t' ardhur n' Amerike. Por, mbi protestimet t' ona, viza amerikane iu refuzua ne çdo rast).

Keshtu, pra, per shkak te qendrimit te tyre te çu-



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPËRIS

diteshem anti-amerikan pro-Komunist, SHQIPËRI E LIRË dhe VATRA ia dorezuan edhe nje here Zogut kyçet e fatit të Shqipëris, persa u perket Aliateve të Perëndimit. Dhe me qe ay e din se ku u dhemb dhemb-i Shqiptarëve t' Amerikes, Maloku i Matit ka peshperitur ne veshet e disave se gjoja kur ishte ne Washington (Gusht 1951) paskesh marre shigurime te plota nga qeveria amerikane se Korça dhe Gjirokastra nuk jane më ne rrezik.

Esht e teperte te theksohet se kejo esht nje nga genjeshtrat e zakonshme te Zogut. Fakti esht qe Toskeris do t' i hiqet rreziku vetem e vetem kur qeveria amerikane te beje nje deklarate publike mbi ate pike.

Ndaj bindjes s' ime, nje deklarate te tille munt t' a shkepute nga qeveria amerikane vetem forca morale e Shqiptarëve t' Amerikes. Tue qene se keta Shqiptare jane, shumerisht, t' ardhur nga krahinat e Korçes dhe Gjirokastres, keta kane interesin më te gjalle dhe te drejten me te pushteteshme qe te flasin me gjuhen e sinqeritetit n' emer te vendit te lindjes se tyre.

Sikunder u-shpiegua ne nje kaptine te shkuar, Shqiptaret e Amerikes paten rastin më te shkelqyer per te vleftesuar te drejtat e tyre kur Senatori Pepper na dha dy muaj afat qe te dilnim perpara Komisionit te Puneve te Jashtme te Senatit per te kundreshtuar rezoluten e tij. Ate rast na e humben te dy organizatat qe thone se perfaqesojen GJITH komunitetin shqiptar t' Amerikes.

Esht kohe, pra, dhe nuk pret më, qe Shqiptaret e Amerikes te ngrihen e te kerkojen nga udheheqesit e tyre te heqin dore nga nje rruge qe shpie vetem ne shkaterim. Sado e madhe dhe e kuptueshme qe te jete



E PRITMJA E SHQIPERIS

simpathia e tyre kundrejt regjimit te tashem te Shqiperis—per aresye se i ka patur rrenjet ne popullin—Shqiptaret e Amerikes duhet te marrin parasysh, vecanerisht nen konditat e sotme, jo vetem fatin e organizatave te tyre por aq me teper fatin e Shqiperis. Fundi i fundit, a ka njeri me ment sa te besojë, qofte edhe per nje minute te vetem, se Imzot Noli, John T. Nasse, Qerim Panariti dhe Dhimitri Trebicka do te mundin te shtrengojen qeverin amerikane te ndryshoje programin e saj anti-komunist sa te njohe qeverin e Tiranës? Nga sa dihet, persa i perket Washington'it, qeshtja e njohjes se qeveris se Tiranës esht nje defter i mbyllur.

NGA ANA TJETER, Shqiptaret e Amerikes duhet te kishin kuptuar prej kohe q' Enver Hoxha me Shoke nuk kane asnje nevoje per perkrahjen e tyre. Ata e kane lidhur fatin e tyre dhe te Shqiperis krejtesisht me politiken e Ruisis. Nese Shqiptaret e Amerikes e pelqejen ose jo rrugen qe kane marre ata, aq u ben atyre. Por perkrahja morale qe kane patur gjer tani nga ana e VATRES dhe SHQIPERIS SE LIRE' u ka hyre ne pune per t' i mbushur mendjen popullit fillo-amerikan te Shqiperis se edhe Shqiptaret e Amerikes pelqejen 100 per 100 politiken pro-sovietike te qeveris s' Enver Hoxhes.

Perkundrazi, Shqiperia, si Shtet dhe Komb, ka nevojen me te madhe dhe me te nguteshme per perkrahjen e Shqiptareve t' Amerikes prane Aliateve te Perendimit dhe, sidomos, t' Amerikes, per rastin e peshimit te ballances nderkombetare kunder Ruisis. Si kollonia me e madhe e Shqiptareve ne mergim, vetem



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

komuniteti shqiptar i Amerikes esht ne pozite te luaje nje roll te tille, veçanerisht sepse influencia morale e Shqiptareve t' Amerikes ner popullin shqiptar esht më e forte se çdo influence tjetër e jashtme.

Per kete arsye, Shqiptareve t' Amerikes u bie barra qe te luajen edhe nje here rollin historik qe iu takon:

- 1) Te nderhyjen prane qeveris amerikane per te shiguruar kufiret e Shtetit Shqiptar, ne menyre qe t' a bejen batall **Planin e Trete te Coptimit te Shqipris:**
- 2) T' u vere kufire ambicjeve dhe dallaverave te Zogut dhe te "Ballit Kombetar" qe perfaqesojen dy grupe te diskredituar ne syt e popullit shqiptar.

Per t' i dale ne krye keti qellimi te dyfishte, Shqiptaret e Amerikes duhet te marrin nisjativen per te mbledhur nje Kongres ne te cilin te marrin pjese **GJITH** Shqiptaret e mergimit me ane t' organizatave te tyre. Thirrja per mbledhjen e Kongresit esht mire qe te vije nga ana e **VATRES** dhe **SHQIPERIS SE LIRE**. Ne rast se keto nuk do te duan te marrin ate nisjative naltesisht patriotike, ahere i bie barra kollo nis se madhe n' Amerike per kete kohe, asaj te New York'ut. Ne fakt, qendra e levizjes shqiptare nuk esht më ne Boston, por ne New York, ku jane vendosur kryeqendrat më te rendesishme te levizjes se ré: te dy pjesat e "Ballit Kombetar" si edhe organizata q' esht tue ngrehur Zogu.

Ne Kongresin duhen ftuar te marrin pjese, paanesisht, gjith shoqerit politike te Shqiptareve ne mergim qe kane 100 ose me teper anetare. Posqerisht duhen te marrin pjese **VATRA**, **SHQIPERIA E LIRE**, te dy copet e "Ballit Kombetarit," Zogu (i cili, po te deshiroje munt te dale vete perpara Kongresit), "Blloku Nacio-



E PRITMJA E SHQIPËRIS

nal Independent" i Romes, nje delegat i te merguarve ne Greqi, nje delegat i te merguarve ne Jugoslavi. Edhe qeveria e Tiranes munt te ftohet te dergoje nje delegacion te saj. Q' do delegat a delegacion do te paguaje shpenzimet e veta, por Komisioni Organizator qe do te marre persiper te threse dhe t' organizoje Kuvendin do t' a kete per detyre qe te lehtesoje ardhjen e delegateve te jashtem me ane te qeveris amerikane.

Esht kohe qe t' i leme menjane merit dhe antipathit t' ona per hir te shpetimit te Shqiperis, tue marre parasysh se te gjith kemi bere plot gabime gjer tani dhe te gjithje jemi fajtores, ne nje mase ose ne nje tjetere, per fatkeqesit e Shqiperis. Pikerish, qellimi kryesor i Kongresit do te jete te sjelle nje afrim midis grupeve qe leftojen sot egersisht njeri-tjetrin q' ashtu munt te shtrohet nje program i perbashket.

Esht e teperte te theksohet se nje mbledhje e tille me elemente kundreshtare nuk esht aq e gelltiteshme. Por s' duhet harruar se po te mos ishte bere e pamundeshme njohja e qeveris se Tiranes nga ana e Amerikes per shkak te gabimeve q' u-numeruan ne faqet e keti libri, nuk do te gjendeshim sot ne hallin qe te therresim ne bashkim ata me te cilet nuk kemi dashur te bashkpunojem ne kohen e kaluar.

Natyrisht, pika kryesore e programit te Kongresit do te jete qe te gjenden miete dhe menyra per shpetimin e Shqiperis dhe shigurimin e kufireve te saj me anen e Aliateve te Perendimit dhe, sidomos, t' Amerikes.

Per t' a nxjerre ne krye ate qellim, Kongresi duhet te kethehet ne burimet e kulluara te Kongresit te Lushnjes. Me fjale te tjera, Kongresi duhet te zgjedhe



PLANI I TRETË I COPTIMIT TË SHQIPERIS

ndaj mbarimit të punëve të tjera, një Këshill Kombëtar (National Council), siç ay që doli nga gjiri i mbledhjes së Lushnjes (Këshill i Naltë) që mundi të bashkojë gjithë elementat e shëndoshe të Shqipërisë dhe me atë mënyrë të shigurojë independencën e saj.

Këshilli Kombëtar duhet të veprojë, në masën që lejojnë rastet, si qeveri-në-mergim e akredituar pranë Aliatëve të Perëndimit. Kejo nuk është aq e zorshme saç duket, mbasi dy nga Fuqit kryesore të botës, Amerika dhe Anglia, nuk e kanë njohur qeverinë e Hoxhës dhe janë, prandaj, krejt të lira që të njohin një qeveri shqiptare në mergim të dale nga gjiri i një Kongresi të gjithë Shqiptarëve të mergimit. Pikerisht, Zogu është tue u-munduar të perfitojë nga kejo situatë krejt e posaçme. Argumenti i tij, dhe argument mjaft i fortë, është që, mbasi Amerika dhe Anglia nuk e kanë njohur dhe s' kanë ndermend t' a njohin qeverinë e Enver Hoxhës, ay gëzon të drejtën që të njihet perseri si "mbret i Shqipërisë në mergim" me një qeveri që do t' a formojë simbas qefit të tij, me gjithë që Komiteti "Shqipëria e Lire," në të cilën është pjesëtar ay dhe një cope e vetem e "Ballit Kombëtar," përfaqëson një pakicë fare të vogël të Shqiptarëve të mergimit.

Ky është problemi më i math që ka për të përballur Kongresi.

Po të jete, pra, se të dy organizatat e Boston'it nuk do të bëjnë gjë mbi këtë pikë, ose në mungesë të tyre, kollonia e New York'ut nuk do të marrë përgjigjesin për t' i dale zot deryres historike që i është lenë në prag të derës, ahërë Shqiptarët e Amerikës përgjithë-



E PRITMJA E SHQIPERIS

sisht do te bejen mire te heqin dore krejt nga levizja kombetare per t' u lene fushe te lire organizatave me te reja te formuara tash-se-fundi nga emigrantet politike t' ikur nga tirania komuniste e Shqiperis, me Zogun dhe "Ballin Kombetar" ne krye.

FINIS

